

2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

2.1. POLITIKA MONETARE

Në përputhje me Ligjin për Bankën e Shqipërisë, politika monetare formulohet dhe zbatohet në funksion të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i çmimeve përkufizohet si një rritje vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit prej 3% në afatin e mesëm. Nëpërmjet përbushjes së këtij objekti, Banka e Shqipërisë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, në promovimin e stabilitetit financiar, dhe në rritjen e mirëqenies së shoqërisë shqiptare.

Vendimet e politikës monetare merren nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, bazuar në një kuadër modern analize dhe parashikimi. Ky kuadër shfrytëzon të gjithë spektrin e informacionit të disponueshëm, mbështetet në modele bashkëkohore ekonometrike dhe reflekton praktikën më të mira të bankave qendrore. Për më shumë informacion mbi objektivat, parimet dhe strategjinë e politikës monetare, mund të konsultoni Dokumentin e Politikës Monetare. Ndërkohë, Raportet e Politikës Monetare ofrojnë një analizë të plotë të situatës ekonomike dhe financiare në vend, parashikimet për të ardhmen, qëndrimin e politikës monetare, si dhe kontributin e saj në zhvillimin ekonomik.

Banka e Shqipërisë arriti të vendosë nën kontroll inflacionin gjatë vitit 2024, pas niveleve të larta të dy viteve të mëparshme. Ulja e inflacionit solli përfitime të ndjeshme për familjet dhe bizneset shqiptare, duke rritur fuqinë blerëse të të ardhurave të tyre, ulur pasigurinë dhe nxitur konsumin dhe investimet. Paralelisht me to, ekonomia ruajti një kah pozitiv zhvillimi, të shfaqur në rritjen e aktivitetit ekonomik, të punësimit dhe të pagave, si dhe në përmirësimin e treguesve të tjerë të shëndetit ekonomik e financiar të vendit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të rëndësishëm pozitiv në këtë ecuri. Qasja e saj e kujdesshme, konsistente dhe proaktive ndaj goditjeve të vazhdueshme të viteve të fundit, ka mundësuar ruajtjen e stabilitetit monetar të vendit, duke nxitur rritjen e qëndrueshme të ekonomisë shqiptare dhe zgjerimin e mirëqenies së shoqërisë së saj.

2.1.1 POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2024

Ekonomia shqiptare e mbylli vitin 2024 me një bilanc zhvillimi pozitiv.

Përballë një ambienti të huaj sfidues, aktiviteti ekonomik vijoi të rritet me ritme të qëndrueshme, duke tejkalar pritjet tona fillestare. Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, pas një rritjeje prej 3.9% gjatë vitit 2023. Rritja ekonomike pasqyroi – në masën më të madhe – zgjerimin e konsumit familjar, të investimeve të bizneseve, si dhe të eksportit të shërbimeve të turizmit. Nga ana tjetër, eksportet e mallrave shënuan rënie,



ndërkohë që politika fiskale vijoi të ruajë një kah konsolidues. Ky profil kërkesë për mallra e shërbime solli zgjerimin e aktivitetit në sektorin e shërbimeve e të ndërtimit, ndërkohë që sektori industrial dhe ai bujqësor shënuan rënie.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik mundësoi një përmirësim të treguesve kryesorë të tregut të punës: punësimin dhe pagave. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, numri i të punësuarve në sektorin privat, sipas të dhënave administrative, u rrit me 1.8%, ndërsa paga mesatare u rrit me 8.3%.

Inflacioni i çmimeve të konsumit zbriti në nivelin mesatar 2.2% gjatë vitit 2024, nga 4.8% në vitin 2023 dhe 6.7% në vitin 2022, duke shënuar një rikuperim të plotë nga goditja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Kjo tendencë u mbështet nga normalizimi i kujdesshëm i qëndrimit të politikës monetare gjatë viteve 2022 – 2023, nga rënia e inflacionit në partnerët tanë tregtarë dhe forcimi i kursit të këmbimit të Lekut, si dhe nga pritjet e ankoruara të inflacionit.

Rënia e inflacionit gjatë vitit 2024 rezultoi më e shpejtë se pritjet tona, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të ushqimeve dhe të naftës në tregjet globale. Këto zhvillime, të kombinuara me forcimin e kursit të këmbimit, reduktuan ndjeshëm inflacionin e importuar, ndërsa presionet e brendshme inflacioniste u zbutën më gradualisht. Megjithatë, këto të fundit po afrohen me mesataret e tyre historike, duke përbërë një premisë për stabilizimin e inflacionit pranë objektivit tonë prej 3% në afatin e mesëm.

Treguesit e tjerë të shëndetit ekonomik dhe financiar të vendit shënuan, gjithashtu, përmirësime të dukshme. Në veçanti, borxhi i jashtëm dhe ai publik ranë përkatësisht në 40.8% dhe 53.8% të PBB-së, ndërsa rezervat valutore të Shqipërisë arritën pranë nivelit të 6.3 miliardë eurove. Gjithashtu, treguesit e qëndrueshmërisë dhe të ndërmjetësimit të sektorit bankar u konsoliduan, ndërsa cilësia e portofolit të kredisë vijoi të përmirësohet. Në reflektim të këtyre zhvillimeve pozitive, Shqipëria njohu një përmirësim të renditjes së borxhit publik të vendit nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, çka kontribuoi në uljen e kostove të financimit të sektorit publik dhe privat në tregjet e huaja.

Përmirësimi i treguesve makroekonomikë është rezultat i një sërë faktorësh, ku politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të veçantë. Ajo ka mundësuar vënien e inflacionit nën kontroll, pa dëmtuar trendet pozitive të rritjes ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit.

Pas një periudhe normalizimi gjatë viteve 2022 – 2023, politika monetare mori trajta më akomoduese gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024. Kjo qasje u motivua nga nevoja për të ruajtur kontrollin mbi pritjet për inflacionin në të ardhmen, në prani të rënies së shpejtë të këtij treguesi gjatë gjysmës së parë të vitit. Lehtësimi i kushteve monetare u realizua nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit, e cila u reduktua në nivelin 2.75%, nga 3.25% në fillim të vitit, si dhe nëpërmjet rritjes së blerjeve të valutës në tregun e brendshëm, në interes të një qëndrueshmërie më të madhe të kursit të këmbimit.



Në reflektim të lehtësimit të qëndrimit të politikës monetare, kushtet e financimit për familjet dhe bizneset janë përmirësuar. Normat e interesit të instrumenteve financiare në Lekë janë reduktuar, ndërkohë që normat e interesit për kreditë kanë përfituar dhe nga ulja e primeve të rrezikut dhe nga qasja pozitive e bankave ndaj kreditimit të ekonomisë. Po ashtu, forcimi i Lekut është ngadalësuar, duke lehtësuar më tej kushtet financiare në ekonomi.


Kredia për sektorit privat u përshejtua gjatë vitit 2024, e nxitur nga përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe kërkesa e lartë. Rritja vjetore e saj arriti në 15.7%, nga 9.7% një vit më parë. Rritja e kredisë ka financuar nevojat për konsum dhe për investime të familjeve dhe bizneseve, duke ruajtur një kompozim të balancuar valutor dhe një cilësi të mirë të portofolit.

Në tërësi, politika monetare e Bankës së Shqipërisë i ka shërbyer ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Procesi i normalizimit gjatë viteve 2022–2023, i ndjekur nga një lehtësim i kushteve monetare gjatë vitit 2024, ka balancuar me kujdes adresimin e rreziqeve ndaj inflacionit në afatin e shkurtër me krijimin e premisave për kthimin e qëndrueshëm të tij në objektiv në afatin e mesëm. Kjo politikë ka kontribuar në funksionimin e rregullt të tregjeve financiare, në menaxhimin e pritjeve për inflacionin, dhe në reduktimin e presioneve të brendshme inflacioniste.

Perspektiva ekonomike mbetet pozitive, si në horizontin afatshkurtër dhe në atë afatmesëm. Aktiviteti ekonomik pritet të rritet në përputhje me potencialin e tij në afatin e mesëm, ndërsa inflacioni parashikohet të kthehet në objektivin 3% gjatë vitit 2025.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet e përkushtuar ndaj respektimit të objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve, duke zbatuar një politikë monetare të përshtatshme dhe të kujdeshme.

Grafik 1. Ecuria e inflacionit, atij bazë e pritjeve afatmesme (majtas) dhe norma bazë (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe BSH.



HAPËSIRË INFORMUESE 1

POLITIKA MONETARE E NDJEKUR GJATË VITIT 2024 DHE REZULTATET E SAJ

Gjatë vitit 2024, ambienti i përgjithshëm makroekonomik u karakterizua nga tendenca rënëse e presioneve të huaja inflacioniste, stabilizimi gradual i raportit të kërkesës dhe ofertës në ekonomi, si dhe tregje të qeta financiare, të karakterizuara nga norma të ulëta interesi dhe vijimi i tendencës forcuese të kursit të këmbimit. Norma e mesatare e inflacionit ra në 2.2%, nga 4.8% në vitin 2023, ndërsa rritja ekonomike mbeti e qëndrueshme, rreth nivelit 4.0%.


Banka e Shqipërisë reagoi ndaj këtyre zhvillimeve, duke lehtësuar kushtet monetare në ekonomi. Ky lehtësim mori formën e: (i) uljes së normës bazë të interesit, nga niveli 3.25% në fillim të vitit në 2.75% në fund të tij; (ii) rritjes së prezencës në kahun e blerjes së valutës në tregun e brendshëm, duke frenuar shpejtësinë e forcimit të kursit të këmbimit, si dhe, (iii) orientimit konsistent të kahut të ardhshëm të politikës monetare. Këto zhvillime ishin të ngjashme me – dhe pjesërisht të diktura nga – ato në partnerët tanë tregtarë.

Ambienti makroekonomik i jashtëm dhe politika monetare në Eurozonë e rajon Ecuria e dobët e ekonomisë së Eurozonës ka mbetur shqetësim në rritje për Bankën Qendrore Evropiane (BQE) dhe për ekonomitë e rajonit. Norma e inflacionit në Eurozonë arriti minimumin 1.7% në muajin shtator, ndërsa rritja ekonomike rezultoi 0.7% për vitin 2024. Rritja ekonomike dhe inflacioni kanë rezultuar vazhdimisht më të ulëta se parashikimet e tregjeve financiare. Pavarësisht rritjes së inflacionit në nivelin 2.4% në fund të vitit 2024, BQE-ja vijon të mbetet e shqetësuar për kërkesën e dobët dhe pritet për rritjen anemike të ekonomisë edhe gjatë vitit 2025.

Në ekonomitë e Bashkimit Evropian joanëtare të Eurozonës, norma mesatare e inflacionit është luhatur në intervale disi më të larta, në disa raste si rezultat i problemeve të brendshme ose deficiteve të larta fiskale. Trajektorja rënëse e presioneve inflacioniste ka rezultuar më e fortë në ekonomitë e rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP). Norma mesatare e inflacionit në BP ra në minimumin prej 1.8% në muajin shtator, e ndjekur nga një rritje e lehtë në fund të vitit.

Kursi i politikës monetare, si në Eurozonë edhe në ekonomitë e rajonit, ka qenë i orientuar drejt lehtësimit të mëtejshëm të kushteve monetare. Bankat qendrore

Grafik 2. Ecuria e inflacionit dhe politika monetare ekonomitë partnere.



Burimi: Bankat qendrore përkatëse, llogaritje të stafit.

Burimi: Institutet statistikore, llogaritje të stafit.



të Eurozonës dhe ato të vendeve të rajonit kanë ulur normën bazë të interesit, me të paktën 0.5 pikë përqindje, gjatë vitit 2024.


Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2024

Ulja e presioneve inflacioniste të huaja rezultoi më e fortë nga sa pritej në fillim të vitit. Paralelisht me vijimin e trendit forcues të kursit të këmbimit, kjo ecuri ndikoi në rënien e shpejtë të inflacionit të importuar dhe atij total në ekonominë shqiptare. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste kanë vijuar të shënojnë rënie, por kjo rënie ishte mjaft më graduale dhe niveli i tyre mbetet konsistent me objektivin e Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve. Në reflektim të këtyre zhvillimeve, Banka e Shqipërisë reagoi duke ulur dy herë normën bazë të interesit: në muajin korrik, nga 3.25% në 3.0%, dhe në muajin nëntor, nga 3.0% në 2.75%.

Ndikimi i kursit lehtësues të politikës monetare në tregjet financiare dhe në ekonomi

Efektet e uljes së normës bazë në gjysmën e dytë të vitit 2024 do të materializohen në ekonominë reale kryesisht në periudhën 2025-2026, në përputhje me kohëvonesat e reagimit të politikës monetare. Megjithatë, ndikimi i uljes së normës bazë në kushtet monetare është pasqyruar që në gjysmën e dytë të vitit 2024. Vlerësimi i ndikimit të pritur të politikës monetare është kryer duke krahasuar diferencat e projeksioneve të treguesve kryesorë ekonomikë në skenarin aktual të reagimit të politikës monetare me skenarin hipotetik të mbajtjes së pandryshuar të normës bazë të interesit.¹

Grafik 3. Ndikimi i lehtësimit të qëndrimit të politikës monetare në tregjet financiare



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të stafit.

Krahasimi i projeksioneve tregon se ndikimi i kursit lehtësues të politikës monetare nëpërmjet uljes së normës bazë është materializuar në tregun e brendshëm financiar që në gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Norma e interesit të kredive për vitin 2024 është rreth 0.4 pp më e ulët nga sa do të ishte në mungesë të uljes së normës bazë. Ndikimi i normës bazë në uljen e interesi të kredive në vitin 2025 vlerësohet në përkatësisht 0.6pp dhe 0.5 pp.

Kohëvonesat në transmetimin e politikës monetare sugjerojnë një ndikim më të fortë të uljes së normës bazë në ekonominë reale gjatë vitit 2025². Rezultatet e simulimit sugjerojnë se në mungesë të reagimit të politikës monetare:


- norma e inflacionit do të ishte rreth 0.4 pp më e ulët se projeksionet e skenarit bazë për vitin 2025, dhe
- rritja ekonomike do të ishte rreth 0.3 pp më e ulët se projeksionet e skenarit bazë për vitin 2025.

¹ Projeksionet alternative janë simulime empirike të Modelit të Parashikimit Afatmesëm (MPM), modelit bazë për realizimin e projeksioneve makroekonomike që informojnë vendimmarrjen e politikës monetare në Bankën e Shqipërisë. (shih Hledik, T.; Kika, E. & Mitre, O. (2021), The Albanian medium term projection model, Bank of Albania Working Paper, 45(84)

² Efektet e uljes së normës bazë në inflacion dhe rritje ekonomike në vitin 2024 janë përkatësisht 0.05 p.p dhe 0.06p.p.




Grafik 4. Ndikimi i pritur lehtësimit të politikës monetare në inflacion dhe rritjen ekonomike



2.1.2 ECURIA E AKTIVITETIT EKONOMIK

Aktiviteti ekonomik ka shfaqur një rritje të qëndrueshme gjatë vitit 2024, i mbështetur nga bilancet solide të sektorit privat, klima pozitive e besimit dhe kushtet financiare akomoduese. Këta faktorë kanë nxitur rritjen e konsumit dhe të investimeve private, të cilët dhanë dhe kontributin kryesor në rritjen ekonomike të vitit. Paralelisht me to, edhe rritja e eksportit të shërbimeve ka pasur një kontribut pozitiv, ndërsa rënia e eksportit të mallrave, rritja e importeve dhe konsolidimi fiskal kanë pasur një ndikim frenues.

Grafik 5. Ecuria e PBB-së dhe kontributi i aktiviteteve ekonomike sipas sektorëve në rritje



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.



Prodhimi i brendshëm bruto u zgjerua me 4.0% në terma vjetorë gjatë nëntë muajve të parë të vitit, pas rritjes me 3.9% në vitin 2023³. Rritja ekonomike ka qenë e qëndrueshme gjatë tremujorëve, si në terma të nivelit ashtu edhe të strukturës sektoriale.


Rritja ekonomike është nxitur kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve, i cili ka pasur një kontribut mesatar rreth 3.0 pikë përqindje në rritjen ekonomike të nëntëmujorit të parë. Në mënyrë të veçantë, zgjerimi i aktivitetit ka qenë i pranishëm në degët e “Tregtisë, transportit dhe akomodimit”, në përgjigje të zgjerimit të të ardhurave nga turizmi, si dhe në degët e “Administratës publike, mbrojtjes, arsimit, shëndetësisë” dhe “Aktivitetet administrative dhe mbështetëse”. Nga ana tjetër, sektori prodhues nuk ka dhënë kontribut në rritje, pasi ndikimet pozitive nga zgjerimi i aktivitetit ndërtues janë kompensuar nga tkurrja e aktivitetit në sektorët e industrisë dhe të bujqësisë.

Tabelë 1. Kontributet sektoriale në rritjen ekonomike (në pikë përqindje)

| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024T1 | 2024T2 | 2024T3 |
|--------------------------|------|------|------|------|------|--------|--------|--------|
| Bujqësi | 0.4 | 0.3 | -0.3 | -0.8 | -0.3 | 0.0 | 0.0 | -0.4 |
| Industria, energjia, uji | 0.3 | -0.9 | 0.9 | 0.5 | -0.3 | -0.9 | -0.9 | -0.4 |
| Ndërtimi | -0.2 | 0.2 | 1.2 | 1.6 | 1.1 | 0.9 | 1.2 | 0.6 |
| Shërbimet | 1.8 | -1.8 | 4.2 | 3.3 | 3.8 | 3.0 | 2.8 | 3.3 |
| Taksat neto | -0.2 | -1.2 | 3.0 | 0.4 | -0.3 | 1.0 | 0.9 | 1.1 |
| Rritja reale | 2.1 | -3.3 | 9.0 | 4.8 | 3.9 | 4.0 | 4.0 | 4.1 |

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 6. Ndryshimi vjetor i kërkesës së brendshme sipas komponentëve



Burimi: INSTAT dhe BSH.

Kërkesa e brendshme u rrit me 4.1% në terma vjetorë gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2024, kundrejt rritjes me 2.8% një vit më parë. Zgjerimi i kërkesës së brendshme reflektoi si rritjen e konsumit privat, i cili është dhe komponenti kryesor i kërkesës së brendshme dhe asaj agregate, ashtu edhe përsheptimin e normave të rritjes së investimeve dhe të konsumit publik.


Konsumi privat u rrit me 3.7% gjatë tre tremujorëve të parë, i mbështetur nga rritja e të ardhurave të disponueshme, kushtet e favorshme të financimit dhe besimi konsumator. Rritja e të ardhurave pasqyroi rritjen e punësimit dhe të pagave, ndërsa ulja graduale e inflacionit rriti fuqinë blerëse të tyre. Gjithashtu, kredia bankare ka mbështetur zgjerimin e konsumit, duke financuar si konsumin ashtu edhe

investimet e familjeve. Paralelisht me to, treguesi i pasigurisë konsumatore ka ardhur në rënie dhe ka mbështetur vendimet e familjarëve për të rritur shpenzimet. Zgjerimi i konsumit reflektoi shpenzime të rritura në të gjitha kategoritë përbërëse.


³ Informacioni i publikuar nga INSTAT për produktin e brendshëm bruto sipas metodës së prodhimit dhe të shpenzimeve mbulon zhvillimet deri në tremujorin e tretë të vitit 2024, të publikuar në datën 24 dhjetor 2024.



Investimet u rritën me 4.4% gjatë tre tremujorëve të parë, të mbështetura kryesisht nga investimet private të bizneseve. Faktorët që kanë ndikuar në këtë ecuri janë rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime, shfrytëzimi në nivele të larta i kapaciteteve prodhuese, pritjet pozitive për të ardhmen, si dhe kushtet e favorshme të financimit dhe zgjerimi i kredisë për qëllime investimi.




Bilanci i shkëmbimeve tregtare me jashtë ka vijuar të rezultojë negativ dhe nuk ka pasur kontribut në rritjen ekonomike. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, eksportet totale të mallrave e shërbimeve – në terma nominalë dhe të shprehura në Euro – u zgjeruan me 9.9% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Kjo ecuri pasqyroi zgjerimin me 13.5% të eksportit të shërbimeve dhe rënien me 3.5% të eksportit të mallrave. Megjithatë, ndikimi pozitiv i rritjes së eksporteve u kompensua nga zgjerimi më i shpejtë i importeve, në përgjigje të rritjes së kërkesës së brendshme për mallra e shërbime. Importet totale të shprehura në Euro u zgjeruan me 13.5% gjatë të njëjtës periudhe, duke sjellë dhe një zgjerim të deficitit tregtar. Ky i fundit shënoi rritje, si në terma nominalë ashtu edhe në terma realë, duke dhënë një kontribut negativ në rritjen ekonomike.




Të dhënat e INSTAT-it për tregtinë në mallra për vitin 2024 tregojnë zgjerimin e deficitit tregtar me 20.7% në terma nominalë. Eksportet e mallrave u pakësuan me 15.4%, kryesisht të ndikuar nga rënia e eksporteve të kategorive “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike”, “Tekstile dhe këpucë”, dhe “Materiale ndërtimi dhe metale”. Rënia e tyre gjatë vitit 2024 ka qenë e lidhur ngushtë me rënien e çmimeve të produkteve energjetike dhe ushqimeve në



tregjet e huaja (përfshirë efektin e kursit të këmbimit), por edhe me faktorë të tjerë strukturorë. Nga ana tjetër, importet e mallrave të shprehura në Lekë u rritën me 2.5% gjatë së njëjtës periudhe, kryesisht si pasojë e importeve të rritura për “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi”.




Politika fiskale ruajti karakterin e saj konsolidues edhe gjatë vitit 2024, për të katërtin vit radhazi. Impulsi fiskal rezultoi negativ, në -0.7 pikë përqindje të PBB-së, si pasojë e një balance primare pozitive, të vlerësuar rreth nivelit 36 miliardë lekë, ose 1.4% të PBB-së. Ky konsolidim pati një natyrë kundërciklike, me kontribut pozitiv në reduktimin e borxhit publik dhe në rritjen e hapësirave për reagim në të ardhmen, duke rritur fleksibilitetin e politikës monetare në adresimin e presioneve inflacioniste.



Natyrë konsoliduese e politikës fiskale u reflektua në rënie të deficitit buxhetor dhe ulje të mëtejshme të borxhit publik. Deficiti buxhetor në fund të vitit 2024 ishte rreth 18.3 miliardë lekë, nga 57 miliardë lekë të planifikuar, ose rreth nivelit 0.7% të PBB-së, nga 1.3% një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore të vitit 2024 rezultuan rreth nivelit 728.6 miliardë lekë, ose afërsisht 28.7% të PBB-së. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet u zgjeruan me rreth 8%. Ndikimin kryesor në rritjen e shpenzimeve e dhanë shpenzimet për fondin e sigurimeve sociale (3.7 pikë përqindje) dhe shpenzimet për personelin (1.8 pikë përqindje), si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik. Investimet publike, ndryshe nga një vit më parë, ndikuan negativisht në ecurinë e shpenzimeve, me rreth 0.5 pikë përqindje.

Të ardhurat fiskale arritën një nivel prej 710.3 miliardë lekësh, ose rreth 28% e PBB-së, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.4%. Zërat me kontributin më të lartë në rritjen e totalit ishin të ardhurat nga TVSH-ja (3.3 pikë përqindje)⁴, të ardhurat jotatimore (3.3 pikë përqindje) dhe të ardhurat nga sigurimet sociale (2.7 pikë përqindje) e ato mbi të ardhurat personale (1.3 pikë përqindje). Nga ana tjetër, ndryshimi vjetor i të ardhurave mbart edhe një kontribut negativ prej rreth 3.5 pikësh përqindje, si pasojë e efektit bazë të rritjes së tatimit mbi fitimin⁵ për kompanitë e sektorit energjetik gjatë vitit 2023, dhe të ardhurat nga grantet.



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe llogaritje të stafit të BSH-së.


⁴ Të ardhurat mbi TVSH-në formuan rreth 1/3 e rritjes së totalit të të ardhurave, duke u mbështetur si nga të ardhurat e vjela mbi vlerën e shtuar të prodhimit të mallrave e shërbimeve në vend (2.1 p.p.), ashtu edhe të importit të mallrave (1.2 p.p.).

⁵ Gjatë vitit 2023, kompanitë e përfshira në tregtimin e energjisë elektrike paguan tatim të veçantë mbi fitimet, si pasojë e të ardhurave relativisht të larta të vjela një vit më parë nga efekti i rritjes së çmimit të energjisë elektrike.



Deficiti buxhetor u financua vetëm nga burimet e brendshme. Rolin parësor në financimin e deficitit e mbarti shtesa me rreth 50 miliardë lekë e huamarrjes në tregun e titujve qeveritarë. Kjo shtesë konsistoi vetëm në tituj borxhi afatgjatë, të cilët kompensuan zvogëlimin e huamarrjes në tituj afatshkurtër, në përputhje dhe me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik. Mbajtësit kryesorë të borxhit të brendshëm mbeten bankat tregtare, me rreth 60%. Gjatë vitit 2024, bazës së investitorëve të titujve qeveritarë iu shtuan dhe jorezidentët, të cilët financuan rreth 28% të huamarrjes në tregun e brendshëm, në formën e bonove dhe obligacioneve të thesarit të denominuara në Lekë. Nga ana tjetër, huamarrja në tregun e huaj u pakësua me rreth 15.2 miliardë lekë, si pasojë e shlyerjes së borxhit të huaj në masë më të madhe sesa rritja e tij.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së⁶ ra në 53.8% në fund të vitit 2024, nga 57.5% e vlerësuar për vitin 2023. Konsolidimi fiskal kontribuoi me rreth 1.4 pikë përqindje në rënien e borxhit publik. Pjesa tjetër e kontributit erdhi nga rritja reale ekonomike dhe mbiçmimi i monedhës vendase kundrejt Euros, përkatësisht me 2.2 dhe 1.4 pikë përqindje. Stoku i borxhit të brendshëm u vlerësua në 31.1 % të PBB-së, me një rënie të lehtë prej 0.2 pikësh përqindjeje nga një vit më parë. Borxhi i huaj në terma të PBB-së u vlerësua në 22.7%, nga 26.2% i vlerësuar në fund të vitit 2023.




⁶ Raportet ndaj PBB-së për vitin 2024 janë ndërtuar duke marrë në konsideratë publikimin e INSTAT për 3 tremujorët e parë dhe parashikimet e BSH-së për tremujorin e fundit të vitit.



1.2.3 TREGU I PUNËS

Rritja ekonomike e vitit 2024 u shoqërua me rritje të punësimit dhe të pagave. Megjithatë, dinamika rritëse e këtyre treguesve paraqitet në ngadalësim krahasuar me një vit më parë. Kushtet në tregun e punës mbeten të shtrënguara dhe bizneset vijojnë të hasin vështirësi në plotësimin e vendeve vakante.

Tregu i punës ka vijuar të karakterizohet nga rritje e punësimit dhe e pagave, ndonëse me ritme më të ngadalta se një vit më parë. Të dhënat e tregut të punës sipas Anketës së Forcave të Punës janë të padisponueshme për vitin 2024. Në mungesë të tyre, treguesit alternativë nga të dhënat administrative sugjerojnë rritje të punësimit me 1.8% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, nga 3.3% në vitin e shkuar. Gjithashtu, treguesit e vrojttimeve sugjerojnë për kushte përgjithësisht të shtrënguara në tregun e punës, sikurse dëshmohet nga nivelet e larta historike të rëndësisë së faktorit “Mungesa në fuqinë punëtore”⁷ për zgjerimin e aktivitetit ekonomik në të gjithë sektorët.



Pagat në ekonomi vijuan të rriten gjatë vitit 2024, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, ndonëse ritmi i rritjes së tyre erdhi në ngadalësim. Kështu, paga në sektorin privat u zgjerua me 8.3% gjatë 9-mujorit të parë, nga 12.6% në vitin 2023. Megjithatë, të korrigjuara për inflacionin, pagat në ekonomi u rritën me 6.1% gjatë periudhës në fjalë, duke mbështetur fuqinë blerëse të familjeve dhe duke kontribuar në rritjen e konsumit privat. Ngadalësimi i pagës në sektorin privat lidhet kryesisht me efektet bazë të gjeneruara nga rritja

⁷ Tregues i vlerësuar nga Banka e Shqipërisë bazuar në rezultatet e Vrojtimit të Besimit të Bizneseve në industri, ndërtim dhe shërbime. Një nga faktorët kufizues në aktivitetin e firmave është edhe “Mungesa në forcën e punës”, faktor i listuar krahas faktorëve të tjerë. Llogaritja e agreguar e tij përfaqëson nivelin e përafërt të rëndësisë së faktorit “mungesë e forcës së punës” për sektorin privat jobujqësor, duke përdorur peshat respektive në PBB. Si vit bazë shërben viti 2019. Së fundi, është zbatuar mesatarja lëvizëse me 4 terma për të evidentuar prirjen e tij.



e pagës minimale gjatë vitit 2023 dhe – si i tillë – ka qenë i pranishëm më së shumti në kategorinë e pagave të ulëta.

HAPËSIRË INFORMUESE 2


PRIRJET DEMOGRAFIKE NË SHQIPËRI DHE NDIKIMET NË EKONOMI

Zhvillimet demografike të Shqipërisë gjatë tre dekadave të fundit janë karakterizuar nga dy trende të rëndësishme dhe të ndërlidhura: popullsia në vend ka ardhur në rënie dhe në plakje të vazhdueshme. Kjo ecuri është diktuar nga dy grupe faktorësh. Në ngjashmëri me vendet e tjera në zhvillim të rajonit dhe të Evropës Lindore, ato kanë pasqyruar fenomenin e emigrimit, fenomen i cili ka prekur sidomos shtresat e popullsisë në moshë të re. Paralelisht me të, në ngjashmëri me vendet e zhvilluara, ajo është diktuar edhe nga ngadalësimi i shtesës natyrore të popullsisë, si pasojë e tendencës së uljes së numrit të lindjeve.

Këto trende demografike u konfirmuan edhe nga Censi i Popullsisë dhe Banesave⁸. Ky cens, i tretë në radhë për periudhën post-tranzicion, sugjeron se numri i popullsisë në vend ka vijuar të bjerë, madje me ritme të përshpejtuara gjatë dekadës së fundit. Popullsia e vendit rezultoi 2.402.113 banorë në vitin 2023, e pakësuar me 420 mijë, banorë krahasuar me atë vitin 2011, dhe me 780 mijë banorë, krahasuar me vitin 1989 (Grafiku 14, majtas).

Shkaktari primar i rënies së numrit të popullsisë është fenomeni i emigracionit. Sipas vlerësimeve të INSTAT-it, Shqipëria ka humbur mesatarisht 50 000 banorë në vit për arsye emigrimi gjatë periudhës 2001 – 2023.⁹ Përtej këtij fenomeni, dhe pjesërisht e lidhur me të, tkurrja e numrit të popullsisë është diktuar edhe nga rënia e shtesës natyrore, më së shumti si pasojë e pakësimit të numrit të lindjeve (Grafiku 14, djathtas).

Grafik 14. Popullsia sipas Censeve dhe ritmet e ndryshimit (majtas); shtesa natyrore e popullsisë (djathtas)



Burimi: INSTAT, Ilogaritje të Bankës së Shqipërisë.

⁸ INSTAT, 2024.

⁹ "Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023", faqe 7, 16 dhe 17. INSTAT, 28 qershor 2024


<https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2024/censi-i-popullsis%C3%AB-dhe-banesave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2023/>



Trendet demografike kanë prekur në mënyrë transversale grup-moshat dhe janë pasqyruar në rritjen e moshës mesatare dhe ndryshimin e piramidës së moshës. Rritja graduale e moshës mesatare, nga 30.6 vjeç në vitin 2001 në 35.3 vjeç në vitin 2011 dhe 42.5 vjeç në vitin 2023, është një tregues sintetik i fenomenit të plakjes së popullsisë gjatë dy dekadave të fundit. Po ashtu, kjo plakje reflektohet në rënien e popullsisë në të gjitha grup-moshat nën 55 vjeç dhe në rritjen e popullsisë për grup-moshat mbi 55 vjeç (Grafik 15, majtas). Ky fenomen është shoqëruar me ngushtim të bazës së piramidës së popullsisë dhe zgjerim të raportit të varësisë së të moshuarve, nga 11.9% në vitin 2001 në 30.4% në vitin 2023 (Grafik 15, djathtas).

Përtej trendeve të mësipërme, rezultatet e dy censeve të fundit evidentojnë dhe migrimin e brendshëm të popullsisë, nga zonat rurale në ato urbane dhe nga zonat më pak të zhvilluara drejt atyre më të zhvilluara. Për ilustrim, në vitin 2023, në qarkun e Tiranës banonte rreth 31.6% e popullsisë ose 4.8 pikë përqindjeje më shumë se në vitin 2011. Nga njëra anë, kjo zhvendosje ka pakësuar popullsinë në zonat më pak të zhvilluara të vendit, por nga ana tjetër ajo ka ndihmuar në rritjen e produktivitetit të punës, në qarqet më të mëdha dhe në ekonominë shqiptare në përgjithësi.

Grafik 15. Ndryshimi i popullsisë sipas grup-moshave 2023 kundrejt 2001 (majtas) dhe raportet e varësisë (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Këto zhvillime demografike, në forma dhe intensitete të ndryshme, janë të pranishme në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Lindore. Rënia e numrit të popullsisë dhe plakja e saj kanë implikime të rëndësishme për zhvillimin ekonomik e shoqëror. Një studim i FMN-së¹⁰ evidenton tre kanale kryesore veprimi. Së pari, rënia e numrit të popullsisë shoqërohet me tkurrje të forcës së punës. Së dyti, plakja e popullsisë ka implikime fiskale, në formën e rritjes së shpenzimeve relative për sektorin e shëndetësisë dhe – potencialisht – për skemën e pensioneve. Së treti, plakja e popullsisë shoqërohet – si rregull – me një rritje më të ngadaltë të produktivitetit të punës dhe të produktivitetit të përgjithshëm. Të tre këta faktorë, në vetvete dhe në ndërveprim me njëri-tjetrin, tentojnë të ngadalësojnë ritmin e rritjes ekonomike dhe ritmin e konvergencës së të ardhurave mesatare për frymë me atë të Bashkimit Evropian.


¹⁰ Demographic Headwinds in Central and Eastern Europe, IMF Departmental Paper Series, No. 19/12.



Në nivele të diferencuara, këto fenomene janë të pranishme edhe në Shqipëri, ndonëse me një intensitet relativisht të ulët. Kështu:

- sipas të dhënave të censit, rënia e numrit të popullsisë është shoqëruar me rënien e popullsisë në moshë pune (15 – 64 vjeç). Kjo kategori është pakësuar nga 1.93 milionë në vitin 2001, në 1.9 milionë në vitin 2011 dhe 1.55 milionë në vitin 2023. Rënia e numrit të popullsisë së aftë për punë nuk ka ndikuar – deri tani – në aftësinë e ekonomisë shqiptare për të gjeneruar vende të reja pune. Përkundrazi, sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i të punësuarve është rritur nga 1.14 milionë persona në vitin 2012 në 1.33 milionë persona në vitin 2023. Megjithatë, ndikimi i tkurrjes së numrit dhe i plakjes së popullsisë do të jetë një faktor gjithnjë e më kufizues në tregun e punës në horizontin afatgjatë;
- në të njëjtën kohë, shpenzimet publike për shëndetësi kanë qenë relativisht konstante gjatë kësaj periudhe, duke u luhatur në intervalin 9-10% të shpenzimeve totale. Ndërkohë, deficitet e skemave të sigurimeve shoqërore, ku sistemi i pensioneve përbën shtyllën kryesore, qëndron pranë nivelit 2% të PBB-së për vitin 2024-2025, duke shfaqur një tendencë të lehtë rënëse gjatë tre viteve të fundit. Megjithatë, ashtu si dhe me treguesit e punësimit, trendet e pafavorshme demografike sugjerojnë një rritje të mundshme të këtij deficiti, në mungesë të ndërhyrjeve.
- së fundi, ekonomia shqiptare ka shfaqur rritje të produktivitetit – kryesisht në përgjigje të zhvendosjes së fuqisë punëtore nga sektorë me vlerë të ulët të shtuar në sektorë me vlerë më të lartë – dhe ka bërë progres në konvergjencën për frymë me vendet e Bashkimit Evropian (shih Grafikon 16). Gjithsesi, të dy këta tregues mbeten ende larg mesatares së Bashkimit Evropian dhe trendet e pafavorshme demografike dhe e bëjnë më të vështirë rrugën e përmirësimit të tyre.

Grafik 16. Të ardhurat mesatare për frymë si raport ndaj mesatares së Bashkimit Evropian, në terma të paritetit të fuqisë blerëse (në përqindje)



Burimi: Eurostat dhe llogaritjet e Bankës së Shqipërisë (për Shqipërinë, të dhënat janë korrigjuar me rezultatet e marra nga censi i fundit)

Kjo analizë paraprake sugjeron se autoritetet publike dhe sektori privat duhet të monitorojnë me kujdes zhvillimet demografike, të identifikojnë në kohë pasojat e mundshme të tyre, dhe t'i adresojnë këto pasoja me reforma strukturore dhe politika të përshtatshme zhvillimi. Ndër të tjera, këto reforma duhet të synojnë: (i) frenimin e rënies së forcës së punës, nëpërmjet dekurajimit të emigrimit, rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në forcën e punës dhe – aty ku është e nevojshme – tërheqjen e punëtorëve të huaj; (ii) rritjen e produktivitetit, nëpërmjet përmirësimit të edukimit e trajnimit, nxitjes së investimeve në makineri, pajisje dhe procese teknologjike më eficiente; si dhe (iii) zbatimin me përparësi të reformës së sistemit të pensioneve, në interes të rritjes së qëndrueshmërisë fiskale.




2.1.4 INFLACIONI DHE FAKTORËT PËRCAKTUES TË TIJ

Inflacioni i çmimeve të konsumit zbriti në nivelin mesatar prej 2.2% në vitin 2024. Rënia e inflacionit reflektoi reduktimin e inflacionit në mjedisin e huaj, mbiçmimin e kursit të këmbimit dhe reduktimin e presioneve nga ekonomia e brendshme. Megjithatë, këto të fundit shfaqën një qëndrueshmëri më të lartë dhe mbeten konsistente me objektivin tonë të stabilitetit të çmimeve.

Kthimi i inflacionit në objektiv pritet të mbështetet nga qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste, duke pasqyruar një ecuri më të balancuar të kërkesës dhe ofertës në tregun e mallrave, të shërbimeve dhe të punës, ancorimin e pritjeve për inflacionin, dhe rritjen e inflacionit të importuar drejt mesatares historike.


Inflacioni i çmimeve të konsumit rezultoi në nivelin mesatar prej 2.2% gjatë vitit 2024, në rënie të ndjeshme kundrejt nivelit 4.8% të shënuar një vit më parë. Inflacioni shënoi një rënie të shpejtë në gjysmën e parë të vitit, në pasqyrim të uljes së çmimeve të mallrave ushqimore në tregjet e huaja dhe në vend, efekteve reduktuese nga forcimi i kursit të këmbimit dhe ndikimeve të bazës së lartë krahasuese të një viti më parë. Presionet e brendshme erdhën gjithashtu në rënie, por kjo rënie ishte graduale dhe këto presione mbeten mbizotëruese, të ndikuara nga kërkesa e lartë për mallra e shërbime dhe presionet nga kostot dhe tregu i punës. Për pasojë, inflacioni i shërbimeve shënoi vlera më të qëndrueshme, tendencë që u përforcua në pjesën e dytë të vitit. Paralelisht me reduktimin më të përmbajtur të inflacionit të importuar, të ndikuar edhe nga ngadalësimi i ritmit mbiçmues të kursit të këmbimit, kjo ecuri u pasqyrua në një stabilizim të inflacionit total në gjysmën e dytë të vitit.

Profili i inflacionit në vend paraqitet i ngjashëm me atë të ekonomive të rajonit dhe të BE-së, i përcaktuar nga ngadalësimi me ritme më të larta i çmimeve të ushqimeve në pjesën e parë të vitit.



Rënia e inflacionit gjatë vitit 2024 ka pasqyruar pakësimin e ndjeshëm të peshës së artikujve të shportës me inflacion të lartë (mbi 4%). Peshja e tyre zbriti në 19% në vitin 2024, kundrejt 48% një vit më parë. Ndërkohë, artikujt me një normë inflacioni 2 – 4%, të cilat janë pranë objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve, përbënë rreth 37% të shportës së konsumit, dhe ata me normë inflacioni të ulët (më pak se 2%) përbënë rreth 44% të shportës.

Grafik 18. Struktura e artikujve të shportës së IÇK-së sipas intervaleve të inflacionit




Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Trajektorja rënëse e inflacionit u diktua në masën 95% nga ngadalësimi i inflacionit të çmimeve të produkteve ushqimore. Inflacioni i kategorisë së "Ushqimeve të papërpunuara" shënoi një nga vlerat më të ulëta historike gjatë gjysmës së parë të vitit, duke dhënë një efekt të fortë rënës tek inflacioni total. Kontributi i kësaj kategorie u reduktua me rreth 1.6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë¹¹. Paralelisht me të, kontributi i kategorisë "Ushqime të përpunuara" u ul me rreth 0.9 pikë përqindjeje gjatë vitit, në pasqyrim të ngadalësimit të çmimeve të ushqimeve në tregjet e huaja.

Çmimet e kategorive të tjera kanë shfaqur luhatje të vogla dhe të balancuara gjatë vitit. Në veçanti, kategoria "Mallra joushqimore" shënoi një rritje mesatare të kontributit me 0.3 pikë përqindje, në pasqyrim të çmimeve të lëndëve të para energjetike në tregjet e huaja dhe në atë vendas. Në krahun rritës ndikoi edhe kategoria e mallrave me çmime të rregulluara, për shkak të rritjes së çmimit të furnizimit me ujë në disa qytete dhe të çmimit të barnave. Nga ana tjetër, çmimet e përbërësve të tjerë më të qëndrueshëm të inflacionit, ku përfshihen shërbimet, strehimi dhe mallrat e konsumit afatgjatë, kontribuan më pak se në vitin paraardhës në formimin e inflacionit.

Grafik 19. Ecuria e inflacionit të kategorisë "Ushqime të Papërpunuara"



Shënim: Norma e inflacionit është ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (publikuar nga INSTAT).
Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

¹¹ Kjo ndikoi në rënie të kontributit të kësaj kategorie në inflacionin total, nga 46% në 26%.



Tabelë 2. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)


| | Kontribute mesatare sipas viteve | | | | | Kontribute mesatare sipas tremujorëve - viti 2024 | | | | Inflacioni vjetor 2024 (në %) |
|--------------------------------|----------------------------------|------|------|------|------|---|-----|-----|------|-------------------------------|
| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | T1 | T2 | T3 | T4 | |
| Ushqime të përpunuara | 0.5 | 0.6 | 0.6 | 2.8 | 1.4 | 0.5 | 0.4 | 0.5 | 0.6 | 1.8 |
| Ushqime të papërpunuara | 0.9 | 0.8 | 0.8 | 1.6 | 2.2 | 0.9 | 0.3 | 0.4 | 0.7 | 4.0 |
| Shërbime | 0.1 | 0.2 | 0.2 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.4 | 0.3 | 0.3 | 2.1 |
| Mallra me çmime të rregulluara | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 1.6 |
| Strehim (qira) | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.3 | 0.4 | 0.4 | 0.4 | 0.3 | 0.2 | 2.6 |
| Mallra konsumi joushqimor | -0.2 | 0.2 | 0.2 | 1.3 | -0.2 | 0.1 | 0.2 | 0.1 | -0.1 | 1.2 |
| Mallra konsumi afatgjatë | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.2 | 0.5 | 0.3 | 0.3 | 0.3 | 0.2 | 3.5 |
| Inflacioni (%) | 1.6 | 2.0 | 2.0 | 6.7 | 4.8 | 2.7 | 2.1 | 2.0 | 2.0 | 2.2 |

Burimi: INSTAT dhe BSH.

Në aspektin makroekonomik, rënia e inflacionit pasqyroi rënien e inflacionit në partnerët tregtarë, forcimin e kursit të këmbimit dhe zbutjen e presioneve inflacioniste nga ekonomia vendase.


Inflacioni i importuar zbriti në nivele të ulëta historike gjatë vitit 2024. Vlerat e ulëta të tij u ndikuan nga prirja rënëse e çmimeve të lëndëve të para dhe energjetike në tregjet e huaja, të përforcuara nga efekti reduktues i mbiçmimit të monedhës vendase. Për pasojë, inflacioni i importuar rezultoi mesatarisht 2.1% nga 6% një vit më parë, duke kontribuar me rreth 18% në formimin e inflacionit total të vitit 2024. Në një këndvështrim afatgjatë, kontributi i këtij komponenti në inflacion është rreth 45%.

Presionet e brendshme inflacioniste vijuan gjithashtu të zbuten, por pa humbur rolin mbizotërues në formimin e inflacionit total. Inflacioni bazë, inflacioni bazë neto dhe inflacioni i brendshëm, regjistruan vlerat mesatare përkatëse 2.5%, 2.6% dhe 2.2%, duke rezultuar më të larta se inflacioni total dhe pranë mesatareve të tyre afatgjata historike. Për pasojë, kontributet e inflacionit bazë



dhe të brendshëm rezultuan të larta, përkatësisht 77% dhe 82%, dhe u luhatën më pak se një vit më parë (Grafikun 14).¹²

Grafik 21. Tregues të gjendjes ciklike




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Kjo ecuri është nxitur nga rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime, si dhe nga zgjerimi i pagave dhe kostove të punës. Ekonomia shqiptare mbeti në një fazë pozitive të ciklit të biznesit edhe gjatë vitit 2024. Vëllimi i aktivitetit ekonomik mbetet mbi nivelin potencial, ndonëse diferenca midis kërkesës dhe ofertës agregate ka pasur tendenca ngushtimi gjatë vitit. Kështu, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve qëndroi mbi mesataren afatgjatë, ndërsa mungesat në fuqinë punëtore mbeten një faktor i rëndësishëm kufizues në zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik. Ndonëse të dhënat nga Anketa e Forcës së Punës mungojnë për vitin 2024, të dhënat e disponuara tregojnë vazhdimin e rritjes së pagave dhe të kostove të punës për njësi, ndonëse me ritme më të ngadalta. Këto zhvillime janë reflektuar në normat e inflacionit bazë, i cili qëndron mbi nivelin e

inflacionit të përgjithshëm të vitit 2024.

Qëndrimi akomodues i politikës monetare gjatë vitit 2024, ka ndihmuar në ankorimin më të mirë të pritjeve afatmesme për inflacionin drejt objektivit 3%. Pritjet për inflacionin¹³ - të bizneseve, të konsumatorëve dhe të agjentëve financiarë - janë ulur gjatë vitit, megjithëse niveli i tyre mbetet mbi objektiv dhe

Grafik 22. Ecuria e pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin



Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹² Inflacioni bazë neto përjashton nëngrupet e ushqimeve të përpunuara (përfshirë bukën dhe drithërat) nga matja e inflacionit bazë. Inflacioni bazë neto merr në konsideratë 46% të shportës të IÇK-së të vitit 2024.

¹³ Pritjet për inflacionin maten nëpërmjet vrojtimeve të drejtpërdrejta të drejtvara bizneseve, konsumatorëve dhe agjentëve financiarë.



mbi nivelin e inflacionit zyrtar. Në terma krahasues, pritjet e bizneseve dhe të agjentëve financiarë janë më afër objektivit kundrejt pritjeve të konsumatorëve. Në fund të vitit 2024, bizneset dhe agjentët financiarë presin që inflacioni pas një viti të jetë përkatësisht 3.7% dhe 2.5%. Pritjet afatmesme të agjentëve financiarë shënojnë vlerën 2.7% në fund të vitit. Nga ana tjetër, pritjet afatshkurtra të konsumatorëve kanë mbetur në nivele të larta, rreth 9.0% gjatë vitit 2024, rreth 1.0 pikë përqindje më pak se një vit më parë.

2.1.5 BILANCI I PAGESAVE DHE POZICIONI I JASHTËM I EKONOMISË

Ekonomia shqiptare ka njohur një përmirësim strukturor të bilancit të shkëmbimeve tregtare dhe financiare me botën gjatë viteve të fundit. Rritja dinamike e eksporteve të turizmit dhe të remitançave kanë zvogëluar deficitin e llogarisë korrente. Në të njëjtën kohë, rritja e qëndrueshme e investimeve të huaja direkte ka luajtur një rol kyç në financimin e plotë të këtij deficiti, duke forcuar kështu stabilitetin makroekonomik të vendit. Përmirësimi i pozicionit të jashtëm ka kontribuar në trendin forcues të kursit të këmbimit.

Deficiti i llogarisë korrente vijoi të qëndrojë në nivele historikisht të ulëta gjatë vitit 2024. Në terma të PBB-së, ky deficit shënoi nivelin 1.3% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, kundrejt nivelit 1.2% të shënuar gjatë vitit paraardhës.

Eksportet totale shënuan një rritje prej 9.9% gjatë tre tremujorëve të parë. Zgjerimi i tyre u bazua në rritjen e shpejtë të eksporteve të shërbimeve të turizmit, të cilat arritën në 3.9 miliardë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 20%. Paralelisht me to, rritja me 17.3% e të ardhurave nga puna sezonale dhe rritja me 14.3% e remitançave kontribuan pozitivisht në zvogëlimin e deficitit të llogarisë korrente. Nga ana tjetër, eksportet e mallrave ranë me 3.5%, të ndikuar kryesisht nga mjedisi i jashtëm i pafavorshëm në terma të kërkesës dhe të çmimeve të eksporteve.¹⁴ Përveç tij, faktorë specifikë brenda sektorëve të caktuar, si dhe mbiçmimi i kursit të këmbimit, kanë frenuar zgjerimin e eksportit për disa kategori mallrash.

Nga ana tjetër, importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 13.9%, të nxitura nga zgjerimi i shpejtë i kërkesës së brendshme. Kështu, importet e mallrave u rritën me 14.6% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, ndërkohë që importet e shërbimeve u rritën me 12.6%.

Rritja e shpejtë e importeve solli dhe rritjen e lehtë të deficitit të llogarisë korrente gjatë vitit 2024. Megjithatë, ky tregues mbetet në nivele të ulëta historike dhe zgjerimi i tij gjatë vitit 2024 pasqyron një ecuri më të mirë të kërkesës së brendshme, në formën e rritjes së konsumit dhe të investimeve. Në

¹⁴ Statistikat e tregtisë së mallrave sipas të dhënave të bilancit të pagesave (raportuar nga Banka e Shqipërisë) kanë ndryshime metodologjike nga të dhënat e tregtisë së mallrave të raportuar nga INSTAT-i. Këto ndryshime lidhen si me klasifikimin e eksporteve, ku disa kategori që klasifikohen si mallra nga INSTAT-i klasifikohen si shërbime nga Bilanci i Pagesave, ashtu edhe me monedhën e raportimit, ku INSTAT-i i raporton shifrat në monedhë vendase, ndërkohë që Bilanci i Pagesave i raporton në Euro.



këtë prizëm, rritja e deficitit të llogarisë korrente në 2024 reflekton jo vetëm zgjerimin e kërkesës për mallra dhe shërbime të importuara, por edhe nevojat strukturore të ekonomisë shqiptare për investime në infrastrukturë dhe sektorë kyç.

Investimet e huaja direkte kanë financuar plotësisht deficitin e llogarisë korrente, duke forcuar stabilitetin makroekonomik të vendit. Këto flukse hyrëse u rritën me 5.1% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2024 dhe ishin një burim i rëndësishëm financimi për sektorë të rëndësishëm, si industria përpunuese, pasuritë e paluajtshme dhe shërbimet financiare e të sigurimit. Megjithatë, raporti i IHD-ve ndaj PBB-së ka shënuar një rënie në 6.3%, nga 6.8% një vit më parë, çka reflekton një rritje më të shpejtë të ekonomisë në raport me flukset hyrëse të investimeve.

Shqipëria ka forcuar qëndrueshmërinë e saj ndaj goditjeve të mundshme të jashtme. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së ka rënë në 40.8% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, duke shënuar një reduktim me 5.3 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2023. Struktura e borxhit mbetet e qëndrueshme, me 90.2% të tij të përqendruar në borxhin afatgjatë.

Ndërkohë, aftësia ripaguese e vendit ka shënuar përmirësim të mëtijshëm dhe rezervat valutore kanë ardhur në rritje. Ndër treguesit e aftësisë ripaguese, raporti i stokut të borxhit ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve zbriti në 96% në fund të tremujorit të tretë të vitit, nga 102.3% në fund të vitit paraardhës, ndërsa raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave fiskale ra në 143.9%, nga 163.0% në fund të vitit 2023. Në të njëjtën kohë, mjetet e rezervës mbulonin 7.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh ose 363% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto në fund të vitit, duke garantuar stabilitet financiar dhe aftësi paguese të lartë.

Tabelë 3. Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit të pagesave dhe të borxhit të huaj (në % ndaj PBB-së)

| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024:T1-T3 |
|------------------------------|-------|-------|-------|-------|------|------------|
| Llogaria korrente | -7.8 | -8.6 | -7.6 | -5.9 | -1.2 | -1.3 |
| Tregtia në mallra e shërbime | -13.5 | -14.4 | -13.3 | -10.3 | -5.4 | -5.7 |
| Eksporte | 31.0 | 22.6 | 31.2 | 37.2 | 38.4 | 37.9 |
| Importe | 44.5 | 37.0 | 44.5 | 47.5 | 43.8 | 43.7 |
| Remitanca hyrëse | 5.0 | 5.0 | 5.0 | 4.6 | 4.2 | 4.2 |
| IHD hyrëse | 7.7 | 7.0 | 6.8 | 7.6 | 6.8 | 6.3 |
| Borxhi i huaj | 59.9 | 64.2 | 64.3 | 54.0 | 46.1 | 40.8 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.


2.1.6 TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË

Tregu financiar gjatë vitit 2024 është karakterizuar nga një situatë e qëndrueshme likuiditeti, prime të ulëta rreziku dhe forcim i kursit të këmbimit. Kushtet akomoduese monetare, përfaqja pozitive e bankave ndaj kreditimit, si dhe zgjerimi i kërkesës, janë pasqyruar në rritje relativisht të shpejtë dhe të





qëndrueshme të kreditimit. Rritja e kredisë ka pasur fokus të veçantë financimin e investimeve, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Paralelisht, edhe kursimet e individëve në formën e depozitave bankare janë zgjeruar.

Normat e interesit në tregun financiar kanë ardhur në rënie, në ndjekje të sinjaleve të politikës monetare, por edhe të ngushtimit të primeve të rrezikut. Dy uljet e normës bazë, të ndërmarra në muajt korrik dhe nëntor, u përcollën të gjitha segmentet e tregut financiar. Nivelet e ulëta të rreziqeve të likuiditetit, të inflacionit dhe të kreditit, janë pasqyruar në diferenca të vogla historike të normave të interesit të produkteve financiare të ekonomisë kundrejt normës bazë të interesit dhe. Në reflektim të kësaj tabloje, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë rënë përtej uljeve të normës bazë.




Interesat në tregun ndërbankar shfaqën përcjellje të shpejtë dhe të plotë të lëvizjeve të politikës monetare dhe mbetën të ankoruar pranë normës bazë. Reduktimet e saj u përcollën menjëherë tek interesat e aplikuara nga bankat në tregun e parësë. Banka e Shqipërisë vijoi të kryejë operacione injektuese të likuiditetit në sistem me anë të instrumentit të saj kryesor, repos një-javore. Krahas repove javore, janë kryer edhe injektime likuiditeti nëpërmjet repove me maturitet 3-mujor. Shuma totale e likuiditetit të injektuar gjatë këtij viti ishte lehtësisht më e vogël nga viti i kaluar, ndërsa zgjerimi i ndjeshëm i kredisë për sektorin privat dhe rritja e portofolit të letrave me vlerë të qeverisë në bilancin e bankave u financuan nga rritja më e lartë e depozitave në Lek.






Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë u luhatën në nivele më të ulëta krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar, përtej kahut të politikës monetare, edhe prime rreziku në rënie në një kontekst të qetë dhe me mungesë presionesh në financimin e borxhit. *Yield-i* 12-mujor rezultoi në nivelin mesatar prej 3.3%, nga 3.7% që ishte në vitin 2023, ndërkohë që në muajt e fundit të vitit *yield-et* e obligacioneve afatgjata zbritën në vlera të afërta me ato të 2-3 viteve më parë, kur norma bazë ishte shumë më poshtë se nivelet aktuale. Diferencat e *yield-eve* ndaj normës bazë u zvogëluan më tej gjatë këtij viti, duke konfirmuar klimën pozitive dhe primet e përmbajtura të rrezikut në tregun vendas. Faktor mbështetës për prirjen rënëse të *yield-eve* ishte pjesëmarrja e lartë e bankave në tregun primar, në një kohë që qeveria nuk pati presion të shtuar për fonde. Këto zhvillime u pasqyruan në presione rënëse tek *yield-et* e obligacioneve afatgjata dhe në zbutje të pjerrësisë së kurbës së *yield-eve*.



Forcimi i kursit të këmbimit erdhi duke u ngadalësuar gjatë vitit 2024, teksa presionet mbiçmuese mbi Lekun vijuan të ishin të pranishme, por në nivele më të moderuara. Gjatë vitit 2024, një Euro u kuotua mesatarisht me 100.7 lekë, nga 108.7 lekë një vit më parë. Mbiçmimi vjetor i Lekut kundrejt Euros për këtë vit rezultoi mesatarisht 7.4%, por me një frenim të ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit, në 5.3%. Në mënyrë të ngjashme, kursi i këmbimit të Lekut ndaj Dollarit amerikan ra në mesatarisht 93.0 lekë/usd, me një forcim vjetor të Lekut prej 7.5% gjatë vitit. Ndonëse jo me të njëjtin intensitet si në vitin paraardhës, bilanci pozitiv i shkëmbimeve tregtare e financiare me partnerët tanë tregtarë prodhoi tepriçë të ofertës valutore në tregun vendas edhe gjatë vitit 2024. Deficiti i llogarisë korrente shënoi vlera të ulëta, ndjeshëm nën ato historike, ndërsa raporti i mbulimit të tij nga flukset e investimeve të huaja direkte vijoi të jetë i lartë. Një shtjellim më të gjerë të faktorëve që kanë ndikuar ecurinë e kursit të këmbimit dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë e gjeni në Hapësirën Informative 3.

Interesat e kredive në Lek janë ulur gjatë vitit 2024, veçanërisht për individët.

Ky segment ka qenë përfitues i një përqasjeje proaktive të bankave në kreditim dhe i rritjes së konkurrencës mes tyre, çka është shprehur në norma më të ulëta interesi dhe lehtësim të kushteve të kreditimit. Ulja e normave të interesit për kreditë për individë ka filluar që në tremujorin e dytë të vitit. Kjo tendencë ka qenë më e dukshme te kreditë konsumatore, ku interesi mesatar zbriti në 8.5% në tremujorin e katërt, ose rreth 1.0 pikë përqindjeje më poshtë se mesatarja e qëndrueshme e vitit 2023. Në mënyrë të ngjashme, interesi mesatar për kreditë hipotekare zbriti në 3.7% në tremujorin e fundit, nga 4.2% një vit më parë. Ndërkohë, interesat për kreditë për biznese janë shfaqur më të luhatshëm gjatë vitit 2024, duke shfaqur një rënie minimale. Në terma mesatarë, ato rezultuan 6.6%, nga 6.5% një vit më parë, duke shfaqur një prirje rënëse në gjysmën e dytë të tij.



Ecuria e normave të interesit të kredisë në Lek dëshmon për prime të ulëta të rrezikut të kredisë dhe marzhe të ulëta ndërmjetësimi. Sikurse gjatë vitit 2023, diferenca mes interesit të kredisë dhe *yield*-it 12-mujor shënoi vlera të ulëta historike, prej 3.3 pikësh përqindje, duke reflektuar perceptimin e bankave për nivele të ulëta të rrezikut të kredisë. Ngushtimi i marzhit të interesit mesatar të kredisë kundrejt normës bazë të interesit është ndihmuar më tej nga reduktimi i *yield*-eve përtej sinjaleve të politikës monetare gjatë këtij viti. Nga ana tjetër, normat e interesit në tregun e depozitave janë luhatur në nivele minimale, duke mbajtur të ulëta kostot e financimit për bankat. Interesi mesatar i depozitave me afat në Lek rezultoi 2.0%, lehtësisht më lart nga viti 2023, por duke ndjekur uljen e normës bazë në gjysmën e dytë të vitit. Diferenca mes interesit mesatar të kredisë dhe të depozitave, e cila përfaqëson marzhin e ndërmjetësimit të sektorit bankar, u ngushtua në 4.5%, me një rënie prej 1.0 pikë përqindjeje kundrejt mesatares së 5 viteve paraardhëse.

Normat e interesit të kredisë në Euro kanë rezultuar në rritje gjatë vitit 2024. Ato shënuan 6.6% për bizneset dhe 5.5% për kreditë hipotekare të individëve, ose rreth 0.4 – 0.5 pikë përqindje më lart se në vitin e mëparshëm. Pasi vijuan rritjen e nisur që në vitin 2023 edhe në gjysmën e parë të vitit, ato filluan të bien në gjysmën e dytë të tij, në ndjekje të lehtësimit të politikës monetare në Eurozonë. Diferenca mes interesit të kredisë në Lek dhe atij të kredisë në Euro është pozitive, por e vogël, për bizneset, ndërsa mbetet negative për kreditë hipotekare të individëve.

Kredia për sektorin privat¹⁵ u rrit me 15.7% gjatë vitit 2024, e nxitur nga besimi pozitiv për zhvillimet aktuale dhe të pritshme, normat e ulëta të interesit të kredisë, rritja e kërkesës për financim dhe përfaqësja pozitive e bankave ndaj financimit të sektorit privat. Një vit më parë, norma e rritjes së kredisë ishte 9.7%.

Zgjerimi i shpejtë i kredisë ka qenë i balancuar, me rritje të portofolit të kredisë si për bizneset ashtu dhe për individët. Megjithatë, vërehet një rritje e shpejtë e kredisë për bizneset – me një normë vjetore prej 15.5% ose gati dyfish më e lartë se një vit më parë – dhe në veçanti te kredia për bizneset në valutë. Kjo e fundit u rrit me 20% gjatë vitit 2024, nga 3% një vit më parë, duke u nxitur nga rënia e shpejtë e diferencialit të normave të interesit mes dy monedhave, por edhe nga profili i kredisë – sipas madhësisë së biznesit ashtu edhe qëllimit të përdorimit¹⁶ - ku dominoi kredia për biznesin e madh dhe për qëllime investimi.

Ndërkohë, zgjerimi i kredisë për individë ka qenë i qëndrueshëm gjatë vitit dhe është dominuar nga rritja e portofolit në Lek. Kredia për këtë segment


¹⁵ Të dhënat e kredisë bazohen në të dhënat monetare, të cilat merren nga bilanci i bankave dhe i referohen financimit për sektorin privat rezident. Prej vitit 2022, në linjë me metodologjinë e BQE-së, analiza e portofolit të kredisë bazohet në flukset "reale" të kredisë, të rregulluara si nga lëvizjet e kursit të këmbimit ashtu edhe nga kreditë e nxjerra nga bilanci.

¹⁶ Gjatë vitit 2024, kredia dhënë për biznese ka qenë kryesisht kredi dhënë për biznesin e madh, me një rritje vjetore të lartë dyshifrore rreth 29%, dhe për qëllime investimi, me një rritje prej 20%. Ajo kanë qenë të përqendruara në disa kredi të mëdha specifike që lidhet me projekte të veçanta infrastrukturore ose energjetike.




është rritur me 16%, e mbështetur nga zgjerimi i kredisë për konsum dhe kredisë hipotekare. Gjatë vitit 2024 u vu re një rritje më e shpejtë e kredisë hipotekare në Lek kundrejt asaj në valutë, e ndikuar si nga diferenca ende negative midis normave të interesit Lek - Euro, ashtu edhe nga politikat e bankave për kredinë hipotekare, në përputhje me kërkesat rregullatore që synojnë të reduktojnë rrezikun e kursit të këmbimit në kreditim.

Në vija të përgjithshme, rritja e kredisë ka qenë afërsisht e balancuar midis monedhave. Kredia në Lek u rrit me rreth 19%, ndërsa ajo në valutë me rreth 15% gjatë vitit 2024. Pesha e kredisë në Lek ndaj totalit ka arritur në 57%, duke shënuar një përmirësim prej 2 pikësh përqindjeje në krahasim me një vit më parë. Zgjerimi i kreditimit në monedhën vendase rrit efikasitetin e politikës monetare dhe, njëkohësisht, zvogëlon ekspozimin e agjentëve ekonomikë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.



Depozitat bankare u rritën me 8% gjatë vitit 2024, nga 11.4% një vit më parë. Kjo ecuri u ndikua nga ngadalësimi në 3% i ritmit të rritjes së depozitave në valutë të bizneseve, si pasojë e përdorimit të fondeve të akumuluarra në vite për mbulimin e nevojave për likuiditet. Në ngadalësim është shfaqur edhe rritja e depozitave të individë në valutë – në rreth 10% - por ky ngadalësim ka qenë më i përmbajtur. Në tërësi, depozitat në valutë u rritën me 8.3% gjatë vitit, nga 15.3% gjatë vitit 2023.

Nga ana tjetër, depozitat në Lek u rritën me 7.7%, një rritje lehtësisht më e lartë se ajo e një viti më parë. Një rol të rëndësishëm në këtë ecuri ka luajtur preferenca e individëve për të depozituar kursimet në Lek pranë bankave, e ndikuar nga normat e ulëta të kthimeve nga letrat me vlerë të qeverisë – veçanërisht për instrumentin 12-mujor – dhe nga zhvendosja e financimit të qeverisë me instrumente afatgjata, të cilët janë më pak të preferuar nga individët. Këto zhvillime u pasqyruan në përshejtimin e rritjes së depozitave



në Lek të individëve në 7.8%, ose 2 pikë përqindje më lart se ajo e vitit 2023. Ndërkohë, normat e rritjes së depozitave të bizneseve u ngadalësuan, duke reflektuar nevojat e tyre për likuiditet përtej kredisë bankare.

Ecuria e depozitave sipas maturitetit tregon për ngadalësim të ritmit të rritjes, **si për depozitat pa afat, ashtu edhe për ato me afat, duke reflektuar nevojat e shtuara për likuiditet, ecurinë e normave të interesit dhe preferencën për ruajtjen e një kthimi të lartë** – sikurse vihet re në tendencën për vendosjen e kursimeve në depozita me afat me maturitet mbi dy vjet. Kështu, depozitat pa afat u rritën me 7.3% në nivel vjetor, ndërsa depozitat me afat janë rritur me 8.9%, gjatë vitit 2024. Ndërkohë, depozitat mbi dy vjet vijojnë të shfaqin rritje të lartë dyshifrore (rreth 14%), dhe pesha e tyre ndaj totalit arriti në 18.4%, ose 1.1 pikë përqindjeje më shumë nga një vit më parë.

HAPËSIRË INFORMUESE 3


FORCIMI I KURSIT TË KËMBIMIT: ARSYET, PASOJAT DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Trendi forcues i kursit të këmbimit të Lekut ndaj monedhave kryesore vijoi të ishte i pranishëm edhe gjatë vitit 2024, ndonëse ritmi i forcimit ishte më i moderuar se ai i vitit paraardhës. Pasi kulmoi në 10.4% në tremujorin e katërt të vitit 2023, mbiçmimi vjetor i kursit të Lekut ndaj Euros u zbeh gradualisht gjatë vitit 2024, duke zbritur në 5.3% në gjysmën e dytë të tij (Grafiku 28, paneli A). Tregu valutor u shfaq më i qetë gjatë vitit 2024. Lulahshmëria e kursit Eur/Lek u reduktua ndjeshëm, ndërsa diferenca mes kuotimeve në shitje dhe në blerje iu rikthye vlerave normale (Grafiku 28, paneli B). Po ashtu, vëllimet e tregtimit kanë vijuar të rriten në linjë me rritjen e vëllimeve të tregtisë së jashtme në mallra e shërbime (Grafiku 28, paneli D).

Sikundër kemi argumentuar në analizat e mëparshme, trendi forcues i kursit të këmbimit është rezultat i tepricës së ofertës valutore në ekonomi. Kjo tepricë oferte buron – në masën më të madhe – nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve ekonomike e financiare me partnerët tanë tregtarë. Në veçanti, ajo pasqyron rritjen e eksportit të shërbimeve të turizmit, rritje e cila ka sjellë dhe reduktimin e ndjeshëm të deficitit të llogarisë korrente në dy vitet e fundit. Paralelisht me to, investimet e huaja direkte, të cilat përbëjnë burimin e kryesor të financimit të deficitit korrent, kanë vazhduar të rriten, e madje në dy vitet e fundit e kanë tejkaluar ndjeshëm këtë të fundit (Grafiku 28, paneli C). Raporti i hyrjeve valutore nga investimet e huaja direkte ndaj deficitit të llogarisë korrente ka qenë mbi katër gjatë dy viteve të fundit, duke gjeneruar një tepricë të vazhdueshme valute në tregun e brendshëm.



Grafik 28. Ecuria e kursit Eur/Lek (paneli A), e kushteve të tregimit në tregun valutor (paneli B), e deficitit korrent (paneli C), dhe e vëllimeve të këmbimit në tregun valutor (paneli D)



Në një këndvështrim makroekonomik, mbiçmimi i kursit nominal të këmbimit të Lekut ka pasqyruar tendencën e konvergimit të të ardhurave dhe të çmimeve midis Shqipërisë dhe partnerëve tanë tregtarë të Eurozonës. Kjo tendencë merr formën e forcimit të kursit real të këmbimit, dinamika e të cilit llogaritet si produkt i diferencës në inflacion midis Shqipërisë dhe Eurozonës me ndryshimet në kursin nominal të këmbimit. Forcimi i kursit real të këmbimit, i shpjeguar në teori nga efekti Balassa-Samuelson, është një fenomen tipik për ekonomitë e vendeve në zhvillim, të cilat ndodhen në proces konvergjence drejt ekonomive më të zhvilluara, si dhe dëshmi e suksesit të këtij procesi.¹⁷ Në vija të përgjithshme, tendenca e konvergjencës së të ardhurave për frymë të vendeve në zhvillim shoqërohet edhe me një tendencë të konvergjencës së nivelit të çmimeve midis vendeve në zhvillim dhe partnerëve të tyre tregtarë. Në terma më teknikë, efekti Balassa-Samuelson pasqyron një rritje më të shpejtë të produktivitetit në sektorin e mallrave e shërbimeve të tregtueshme ndaj atyre të patregtueshme, rritje e cila (i) pasqyrohet në zgjerimin e eksporteve dhe përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare dhe sjell (ii) një rritje të çmimeve relative të mallrave e shërbimeve të patregtueshme ndaj atyre të tregtueshme.

Për këtë arsye, forcimi i kursit real të këmbimit është një dukuri e vënë re në thuajse të gjitha vendet e Evropës Qendrore e Juglindore, me hapjen e ekonomive të tyre pas viteve '90 (Grafiku 29, paneli B).¹⁸ Procesi i ringritjes ekonomike në


¹⁷ Një trajtim të hollësishëm të efektit Balassa-Samuelson e gjeni në: 1) Balassa, Bela, 1964, "The purchasing-power parity doctrine: a reappraisal", *Journal of Political Economy* 72.6: 584-596; dhe 2) Samuelson, Paul A., 1964, "Theoretical notes on trade problems", *The Review of Economics and Statistics*: 145-154.

¹⁸ Shih Meshulam, Dan dhe Peter Sanfey, 2019, "The determinants of real exchange rates in transition economies", EBRD WP228.



këto vende u shoqërua me rritje të shpejtë të investimeve, të produktivitetit dhe të të ardhurave për frymë (Grafiku 29, paneli A).


Grafik 29. Ecuria e konvergencës së të ardhurave mesatare për frymë në Shqipëri dhe vendet e rajonit ndaj Eurozonës



Shënim: Të ardhurat për frymë të vendeve të rajonit (paneli A) janë ndërtuar si raport i mesatares të vendeve të Eurozonës dhe mbajnë parasysh fuqinë reale blerëse. Në panelin B, vlerat negative të ndryshimit të kursit real të këmbimit pasqyrojnë forcim të tij. Burimi: Eurostat dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë (për Shqipërinë, të dhënat janë korrektuar me rezultatet e marra nga censi i fundit).

Trendi i forcimit të kursit real të këmbimit, në përgjigje të konvergencës së çmimeve, ka implikime të rëndësishme për treguesit kryesorë monetarë në vendet në zhvillim: nivelin e çmimeve, kursin e këmbimit dhe nivelin e normave të interesit. Në praktikë, ky trend mund të akomodohet në tre mënyra: (i) një rritje më e shpejtë e çmimeve në raport me ekonominë e zhvilluara (ose, me fjalë të tjera, një nivel më i lartë inflacioni kundrejt tyre); (ii) një forcim i kursit nominal të këmbimit të vendeve në zhvillim; ose, (iii) një kombinim i dy mekanizmave të mësipërm. Ky fakt është gjerësisht i ilustruar nga ecuria e inflacionit dhe e kursit të këmbimit në vendet Evropës Lindore, disa prej të cilave - si Serbia, Rumania dhe Hungaria - e kanë absorbuar forcimin e kursit real të këmbimit në formën e një inflacioni dukshëm më të lartë se ai i Eurozonës (shih Grafikon 30, panelin A); disa vende, si Shqipëria dhe Republika Çeke, e kanë absorbuar kryesisht nëpërmjet forcimit të kursit nominal të këmbimit (shih Grafikon 30, paneli B); dhe vende të tjera, si Polonia, e kanë absorbuar si një kombinim të këtyre dy variablave.

Grafik 30. Ecuria e inflacionit dhe e kursit nominal në Shqipëri dhe në vendet e rajonit



Burimi: Eurostat dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.




Kjo zgjedhje ka implikime edhe për politikën monetare të ndjekur nga bankat qendrore, të cilat kanë si mandat kryesor të tyrin ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Normat më të larta të inflacionit kërkojnë edhe një politikë më agresive në drejtim të normave të interesit, duke rritur kostot e financimit të ekonomisë. Në këtë drejtim, zgjedhja e regjimit të lirë të kursit të këmbimit i ka mundësuar Bankës së Shqipërisë arritjen e normave të ulëta e të qëndrueshme të inflacionit me nivele më të ulëta të normës bazë krahasuar me shumë vende të ngjashme me ne, teksa kursi i lirë i këmbimit ka shërbyer njëkohësisht edhe si amortizator i goditjeve të jashtme në ekonomi dhe i procesit të konvergencës së çmimeve (Grafiku 31).

Kjo filozofi administrimi udhëhoqi vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë edhe gjatë vitit 2024. Gjatë këtij viti u evidentua prania e njëkohshme e dy fenomeneve. Së pari, ecuria e sektorit të jashtëm të ekonomisë vijoi të prodhojë tepriçë të ofertës valutore në ekonomi dhe presione forcuese mbi Lekun. Së dyti, inflacioni ra nën objektivin e Bankës së Shqipërisë gjatë gjysmës së parë të vitit, si rrjedhojë e goditjeve pozitive të ofertës në çmimet e mallrave ushqimorë në tregjet botërore, e cila zgjati përtej parashikimeve fillestare dhe rrezikoi ankorimin e pritjeve inflacioniste në vend. Në këto kushte, forcimi i kursit nominal të këmbimit me ritme të krahasueshme me ato të vitit të kaluar, mund të prodhonte presione shtesë në kahun reduktues mbi inflacionin.


Për këtë arsye, bazuar në mandatin e saj për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë reduktoi normën bazë të interesit dhe rriti praninë e saj në tregun valutore, përtej ndërhyrjeve të planifikuara në fillim të vitit për rritjen e rezervës valutore. Në total, Banka e Shqipërisë tërhoqi nga sistemi financiar rreth 939 milionë euro gjatë vitit 2024*, kundrejt 251 milionë eurove të blera gjatë vitit 2023. Kjo përfaqësoi ndihmë në reduktimin e pasigurive dhe të luhatshmërisë në tregun valutore, si dhe në kontrollin e presioneve të mundshme dizinflacioniste, si rrjedhojë e forcimit të kursit të këmbimit. Në të ardhmen, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të analizojë me kujdes ecurinë e kursit të këmbimit dhe implikimet e tij për inflacionin, me qëllim reagimin e përshtatshëm të saj në funksion të mandatit kryesor, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

* Në këtë shifër përfshihet edhe shuma prej 25.5 milionë eurosh e blerjeve me datë valutë forward 6 janar 2025.

Grafik 31. Ecuria e normës bazë të interesit në Shqipëri dhe në vendet e rajonit



Burimi: Eurostat dhe Banka e Shqipërisë.



Tabelë 4. Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë

| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024* |
|--|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Inflacioni (mesatar) | | | | | | |
| Inflacioni total (në %) | 1.4 | 1.6 | 2.0 | 6.7 | 4.8 | 2.2 |
| Inflacioni bazë (në %) | 0.7 | 1.4 | 1.7 | 6.5 | 5.3 | 2.5 |
| Rritja ekonomike | | | | | | |
| Rritja reale e PBB-së (vjetore në %) | 2.1 | -3.3 | 9.0 | 4.8 | 3.9 | 4.0* |
| Tregu i punës¹ | | | | | | |
| Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës | 69.6 | 69.1 | 69.3 | 73.2 | 75.9 | |
| Norma e papunësisë (15+) | 11.6 | 11.7 | 11.5 | 11.0 | 10.7 | |
| Sektori fiskal | | | | | | |
| Balanca buxhetore (me grantet, % të PBB) | -1.8 | -6.7 | -4.6 | -3.6 | -1.3 | -0.7 |
| Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së) | 27.1 | 26.9 | 25.7 | 27.4 | 26.6 | 28.7 |
| Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së) | 28.7 | 32.4 | 31.9 | 30.3 | 28.5 | 28.0 |
| Borxhi publik (në % të PBB-së)** | 65.0 | 73.9 | 74.1 | 64.1 | 57.5 | 53.8 |
| Sektori i jashtëm | | | | | | |
| Llogaria korrente (përfshijë transferatat zyrtare, në % të PBB-së) | -8.3 | -8.4 | -8.0 | -6.1 | -1.3 | -1.6* |
| Importet në mallra (fob, në % të PBB-së) | 29.1 | 28.2 | 33.4 | 34.3 | 29.1 | 29.0* |
| Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së) | 6.5 | 5.9 | 8.3 | 10.7 | 8.4 | 7.0* |
| Investimet e huaja direkte (% PBB-së) | 7.7 | 7.0 | 6.8 | 7.6 | 6.8 | 6.3* |
| Sektori monetar e financiar | | | | | | |
| Norma e repos (fund periudhe) | 1.00 | 0.50 | 0.50 | 2.75 | 3.25 | 2.75 |
| Agregati M3 (ritje vjetore, fund periudhe) | 4.3 | 10.5 | 8.6 | 5.2 | 6.4 | 7.4 |
| Kredia për sektorin privat (ritje vjetore, fund periudhe) ² | 8.4 | 8.9 | 10.3 | 10.6 | 10.2 | 15.7 |
| Depozita/PBB-së ³ | 69.3 | 77.3 | 75.5 | 69.7 | 66.6 | 66.3 |
| Kredi/PBB-së ³ | 31.1 | 35.0 | 33.7 | 31.4 | 29.9 | 31.5 |
| Yieldi 12-mujor (mesatar) | 1.6 | 1.9 | 1.8 | 3.2 | 3.7 | 3.3 |
| Kursi i këmbimit, lek/usd (mesatar) | 109.9 | 108.7 | 103.5 | 113.0 | 100.7 | 100.7 |
| Kursi i këmbimit, lek/euro (mesatar) | 123.0 | 123.8 | 122.5 | 119.0 | 108.7 | 93.0 |
| Kursi nominal efektiv, NEER | 92.0 | 89.9 | 86.4 | 78.6 | 67.9 | 60.0 |
| Sektori Bankar | | | | | | |
| Raporti i kredive me probleme (%) | 8.4 | 8.1 | 5.6 | 5.0 | 4.7 | 4.17 |

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

- *Të dhënat për rritjen ekonomike dhe për sektorin e jashtëm i përkasin 9-mujorit të parë të vitit 2024.
 1/ "Rezultate të Anketës së Forcave të Punës", publikim i INSTAT-it, mungon për vitin 2024.
 2/ Bazuar në të dhënat e flukseve monetare publikuar nga Departamenti i Statistikave. Të dhënat janë të rregulluar për efektin e kursit të këmbimit dhe të kredive të nxjerra nga bilanci.
 3/ Vlerësim i PBB-së për vitin 2024. Të dhënat në raport me PBB-në janë llogaritur mbi këtë vlerësim, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.



2.2. OPERACIONET MONETARE

Zbatimi i politikës monetare nga Banka e Shqipërisë realizohet nëpërmjet instrumenteve të grupuar në: operacionet e tregut të hapur, lehtësirat e përhershme dhe rezervën e detyruar. Operacioni kryesor i tregut është marrëveshja e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes me maturim 7-ditor, norma e interesit të së cilës përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe referohet si norma bazë e interesit.

OPERACIONET NË TREG TË HAPUR DHE ADMINISTRIMI I NEVOJAVE PËR LIKUIDITET


Në tërësinë e operacioneve të tregut të hapur bëjnë pjesë: operacioni kryesor i rifinancimit, në formën e marrëveshjes së (anasjelltë) të riblerjes me kohëzgjatje 7- ditore; operacione rregulluese me kohëzgjatje 1-ditore nga 8 ditë deri 3 muaj; si dhe operacionet strukturore të shitblerjes me të drejta të plota të titujve në tregun sekondar.

Këto operacione shërbejnë për përmbushjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë: orientimin e normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë dhe minimizimin e luhatjeve të tyre.

Përgjatë vitit 2024, banka pjesëmarrëse në injektimet javore kanë rezultuar mesatarisht 5 - një numër i njëjtë ky me atë të tre viteve të fundit. Vëllimi mesatar i likuiditetit të injektuar ka rezultuar 44 miliardë lekë, me rënie të lehtë nga një vit më parë, por duke mbetur në linjë me trendin rritës së vërejtur gjatë viteve të fundit. Kërkesa për likuiditet ka qenë e përqendruar në masën 74% në injektimet javore dhe 26% në ato me maturim deri në 3 muaj.


Norma mesatare e interesit në injektimet javore është luhatur në një interval vlerash, nga +2.81 në + 6.6 pikë bazë nga norma bazë. Këto vlera janë në rënie krahasuar me vitin e kaluar, duke pasqyruar, ndër të tjera, kujdesin e bankave dhe të Bankës së Shqipërisë në menaxhimin e likuiditetit, duke shmangur luhatjet e paparashikuara në sistem. Diferencat maksimale u shënuan në tremujorin e parë dhe të katërt të vitit.

Grafik 32. Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar*



*Likuiditeti mesatar javor është mesatarja javore e (injektimeve të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjeve ditore + javore + 1-3 mujore + kreditë njëditore) minus (tërheqjet e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë me anë të marrëveshjeve të riblerjes ditore + javore + 1-3 mujore + depozitat).

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Tabelë 5. Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë

| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|----------------------|------|-------|-------|------|------|------|------|------|------|------|
| Instrumenti kryesor | 55% | 80.7% | 61.6% | 54% | 61% | 56% | 59% | 63% | 65% | 74% |
| Injektimet afatgjata | 45% | 19.3% | 39.4% | 46% | 39% | 44% | 41% | 37% | 35% | 26% |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore pranë Bankës së Shqipërisë – i shërbejnë bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin në bazë ditore. Këto lehtësi përcaktojnë një korridor në të cilin luhaten normat e interesit në tregun ndërbankar.

Në vitin 2024, Banka e Shqipërisë uli dy herë normën bazë dhe paralelisht me të uli dhe normën e depozitës dhe kredisë njëditore. Në fund të vitit, norma bazë e interesit dhe interesi i lehtësive njëditore qëndruan përkatësisht në nivelin 2.75%, 1.75% dhe 3.75%.

Korridori ka vijuar të jetë simetrik me gjerësi +/- 100 pikë nga norma bazë e interesit, gjerësi kjo e pandryshuar nga viti i shkuar. Instrumenti i depozitës njëditore ka gjetur përdorim në 549 raste, me vëllim mesatar ditor prej 7.2 miliardë lekë, në rënie nga mesatarja prej 8.86 miliardë lekësh në 2023 dhe 9.1 miliardë lekë në 2022. Kredia njëditore është përdorur në 39 raste, duke rënë nga 54 raste në vitin 2023, me vëllim mesatar 1.83 miliardë lekë.

REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar është instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë synon të rregullojë gjendjen e likuiditetit të sistemit, si dhe të ndihmojë në stabilizimin e normave të interesit në tregun ndërbankar. Përqindja e detyrimeve në Lek dhe valutë që bankat duhet të mbajnë si rezervë të detyruar në Bankën e Shqipërisë, ka mbetur e pandryshuar nga një vit më parë.¹⁹

Përgjatë vitit 2024, bankat kanë përdorur deri në 70% të likuiditetit në llogarinë e rezervës së detyruar në Lek, sipas nevojës, por gjithmonë duke ruajtur nivelin minimal ditor prej 30% të rezervës së detyruar.

Në përputhje me kuadrin rregullativ, bankat tregtare kanë vijuar të remunerohen për rezervën e detyruar në Lek në vlerën 100% të normës bazë, ndërsa për rezervat e detyruara në valutë, bankat janë remuneruar me 0%, si për Dollarin amerikan ashtu edhe për Euron.

¹⁹ Ndryshimi i fundit rregullator ishte në vitin 2018, në kuadër të programit të deeuroizimit, ku norma e rezervës së detyruar u ul në 7.5%, për detyrimet në monedhën vendase, dhe u rrit në 12.5%, për monedhën euro, nga niveli i padiferencuar 10% i aplikuar më parë.



2.3. STABILITETI FINANCIAR DHE POLITIKA MAKROPRUDENCIALE


Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Banka e Shqipërisë ndjek dhe kujdeset për mbarëvajtjen e sistemit bankar në veçanti dhe sistemit financiar në përgjithësi, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Për të arritur këtë objektiv, Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton politikën makroprudenciale, e cila synon të identifikojë, vlerësojë, zbusë dhe parandalojë rreziqet sistemike në sistemin financiar. Objektivat e ndërmjetëm, treguesit e rreziqeve, instrumentet që mund të përdoren për secilin rrezik dhe detaje të tjera mbi instrumentet makroprudenciale, përshkruhen në mënyrë të hollësishme në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale. Së bashku me Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Banka e Shqipërisë është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, një strukturë ndërinstitucionale me natyrë këshillimore, e cila asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në raportet e rregullta dhe analizat e vrojtimit që publikon Banka e Shqipërisë si autoritet makroprudencial, ofrohet informacion mbi zhvillimet kryesore në sistemin financiar dhe sektorin bankar, rreziqet potenciale dhe ato të evidentuara gjatë analizave, instrumentet e zbatuara për të zbutur dhe parandaluar rreziqet, situatën financiare të sektorit të bizneseve dhe familjeve, rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës së sektorit bankar ndaj skenarëve të pafavorshëm makrofinanciarë, si edhe ndikimin e masave makroprudenciale në fuqi. Banka e Shqipërisë publikon gjithashtu edhe rregulloret, vendimet dhe metodologjitë përkatëse në hapësira të posaçme kushtuar funksionit të stabilitetit financiar.

Sektori financiar shqiptar e mbylli vitin 2024 me një rezultat financiar pozitiv, një nivel të lartë të treguesve të kapitalizimit dhe të veprimtarisë, dhe tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë. Rreziqet sistemike në sistemin financiar vlerësohen të jenë të kontrolluara dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar ndaj goditjeve potenciale është e mirë.


2.3.1. ZHVILLIMET KRYESORE NË SISTEMIN FINANCIAR DHE SEKTORIN BANKAR

Gjatë 2024, aktivet e sistemit financiar, të mbizotëruara nga aktivet e sektorit bankar, u zgjeruan me ritme të krahasueshme me ato të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PPB-së). Si rezultat, raporti i aktiveve të subjekteve financiare ndaj PBB-së vjetore (të tremujorit të tretë 2024) ishte rreth 92%, një nivel i krahasueshëm me një vit më parë. Aktivet e përgjithshme të sistemit financiar



vlerësohet se janë zgjeruar me rreth 8%²⁰. Të gjitha segmentet e sistemit financiar kanë zgjeruar aktivet e tyre, por rritja më e shpejtë është regjistruar në aktivet e institucioneve financiare jobanka (18%), shoqërive të sigurimit (16%) dhe fondeve të pensionit dhe të investimeve (rreth 20%). Treguesit e cilësisë së aktiveve dhe të përfitueshmërisë së subjekteve financiare mbeten në nivele të mira dhe ekspozimet neto brenda sistemit financiar dhe midis sistemit financiar dhe sektorëve të tjerë rezidentë dhe jorezidentë janë të ekuilibruara.

Grafik 33. Mjetet (majtas) dhe detyrimet (djathtas) të korporatave financiare sipas instrumenteve



Gjatë vitit 2024, sektori bankar e zgjeroi veprimtarinë, duke ruajtur një cilësi të mirë të aktiveve, përmirësoi rezultatin financiar dhe ruajti nivelet e mira të kapitalizimit të veprimtarisë. Më konkretisht, aktivet e sektorit bankar u rritën me 7%, me kontribut të njëjtë nga aktivitetet e kreditimit dhe të investimit në letra me vlerë, të cilat u rritën me përafërsisht 13%. Kredia bankare në monedhën vendase dhe ajo në valutë në monedhë origjinale u rritën me rreth 15% në terma vjetorë dhe rritja është vënë re në të gjitha segmentet sipas afateve dhe sektorëve. Zgjerimi me ritme të shpejta i kredisë bankare dhe rënia e lehtë e stokut të kredive me probleme rezultuan në përmirësimin e cilësisë së kredisë dhe rënien e raportit të kredive me probleme në 4.17% (nga 4.7% një vit më parë). Në krahun e detyrimeve, zgjerimi i veprimtarisë u mbështet nga rritja vjetore e depozitave me rreth 5%. Në këtë rritje, kontribuuan pozitivisht llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat, kryesisht të individëve, depozitat në Lek dhe depozitat në valutë.

²⁰ Kjo normë përfaqëson vlerën e ponderuar të normave të zgjerimit të veprimtarisë së segmenteve përbërëse të sistemit financiar (shiko Tabelën 6), ku si koeficient ponderimi shërbejnë peshat e tyre në sistemin financiar.



Tabelë 6. Tregues të aktivitetit të sistemit financiar

| | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|
| Tregues të shëndetit financiar (sektori bankar) | | | | | |
| Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik (%) | 19 | 19 | 19 | 19 | 20 |
| Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave (%) | 8.1 | 5.7 | 5.0 | 4.7 | 4.2 |
| Kithimi nga kapitali (bazë vjetore, %) | 10.4 | 12.6 | 11.8 | 16.9 | 18.2 |
| Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (%) | 47 | 46 | 41 | 43 | 42 |
| Depozita/Kredi (%) | 211 | 214 | 212 | 217 | 202 |
| Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (%) | 7.9 | 8.9 | 4.8 | 6.1 | 8.6 |
| Pesha e aktiveve ndaj PBB-së (%)* | | | | | |
| Sektori bankar | 97.8 | 93.9 | 87.8 | 84.5 | 82.4 |
| IFJB dhe ShKK | 4.9 | 4.7 | 4.5 | 4.4 | 4.7 |
| Shoqëri sigurimi | 2.4 | 2.2 | 2.0 | 2.0 | 2.2 |
| Fonde pensioni dhe fonde investimi | 4.4 | 4.3 | 2.2 | 2.3 | 2.5 |
| Sistemi financiar | 109.5 | 105.1 | 96.5 | 93.1 | 91.9 |


Burimi: Banka e Shqipërisë. *Shtator 2024

Fitimi i sektorit bankar rezultoi rreth 37.4 miliardë lekë, duke qenë 17% më i lartë ndaj një viti më parë. Ky rezultat pasqyroi rritjen më të lartë të të ardhurave nga veprimet me klientët, nga interesat e investimit në letrat me vlerë dhe nga investimet në mjete financiare, në krahasim me rritjen e shpenzimeve të bankave për interesat e paguara për depozitat e klientëve dhe rritjen e kostove operacionale. Rritja e lehtë në normat e interesit të depozitave të individëve dhe e madhësisë së tyre është pasqyruar në rritjen e shpenzimeve për interesat e paguara. Ndërkohë, të ardhurat e arkëtuara nga kreditë në Lek dhe në valutë, janë rritur ndjeshëm, kryesisht për shkak të rritjes së bazës së kredisë, ndërsa norma mesatare e interesit të kredive të reja ka shënuar rënie. Shpenzimet për provigjione për kreditë e humbura ishin të krahasueshme me një vit më parë, ndërsa shpenzimet operacionale u rritën lehtë. Në pasqyrim të këtyre zhvillimeve, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar në fund të vitit shënoi 20%.

2.3.2. VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE

VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE

Zbutja dhe parandalimi i përhapjes së rreziqeve sistemike është objektiv kryesor i politikave makroprudenciale dhe kushti thelbësor për ruajtjen e stabilitetit financiar. Për këtë arsye, identifikimi i burimeve të këtyre rreziqeve, vlerësimi i intensitetit dhe i kanaleve të përhapjes së tyre kërkojnë një angazhim të rëndësishëm të kohës dhe burimeve të Bankës së Shqipërisë si autoritet makroprudencial. Harta Makroprudenciale e Rreziqeve Sistemike, analizat mujore të treguesve të shëndetit financiar dhe ato tremujore të qëndrueshmërisë së sektorit bankar, së bashku me ushtrimet e provave të rezistencës, shërbejnë si bazë për diskutimet dhe vendimmarrjen makroprudenciale, ndërsa materialet që publikohen - si Raporti i Stabilitetit Financiar dhe analizat e vrojtimit - mbështesin njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë ndaj publikut dhe sistemit financiar.



Analizat e kryera gjatë vitit 2024 tregojnë se niveli i rreziqeve sistemike në sistemin financiar ka qenë i kontrolluar dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar ndaj goditjeve potenciale makrofinanciare është e mirë. Treguesit e lidhur me rritjen e përgjithshme të kredisë, pozicionin e likuiditetit, luhatjet në tregun valutor, përqendrimin e ekspozimeve dhe të aktivitetit të sistemit financiar pasqyrojnë një situatë të ekuilibruar dhe nivele rreziku të krahasueshme me mesataret historike. Disa tregues të aktivitetit, si kreditë në valutë të pambrojtura nga lëvizjet e kursit të këmbimit dhe hendeku afatshkurtër midis mjeteve dhe detyrimeve të bankave, shfaqën nivele më të larta se kufijtë e përcaktuar. Megjithatë, ato u vlerësuan të jenë të kontrolluara, falë masave rregullative ose prirjes rënëse të vërejtur në periudhat e fundit.

MASAT MAKROPRUDENCIALE

Deri në fund të vitit 2024, bashkësia e masave makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë përfshinin kërkesat për kapital të përcaktuara në rregulloren 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".

Banka e Shqipërisë vlerëson se zbatimi i tyre, i ndërthurur me përmbushjen e kërkesave të reja të lidhura me funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, ka ndihmuar forcimin e qëndrueshmërisë dhe shëndetit të sektorit bankar në vend.

Gjatë vitit 2024, në përputhje me rregulloren, të gjitha bankat vendase ishin subjekt i plotësimit të kërkesës për shtesën konservuese të kapitalit në nivelin maksimal të saj prej 2.5%. Ndërkohë, katër banka me rëndësi sistemike kanë përmbushur një shtesë kapitali midis nivelit 0.5% dhe 1.5%, të njohur si shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike.

Në fund të muajit qershor, Banka e Shqipërisë rriti për herë të parë nivelin e shtesës kundërciklike të kapitalit për Shqipërinë (KUNC) në nivelin 0.25%, dhe në fund të muajit dhjetor e rriti përsëri, në nivelin 0.5%. Sipas përcaktimeve rregullative, këto shtesa do të përmbushen gjatë vitit 2025. Vendimarrja për nivelin e këtij instrumenti mbështetet në ecurinë e treguesit të hendekut të raportit të kredisë ndaj PBB-së, i konsideruar si tregues parësor në metodologjinë përkatëse, në ecurinë e Treguesit të Paralajmërimit të Hershëm Plotësues (TPHP) dhe treguesve të tjerë të rritjes në segmente të caktuara të kredisë. Ndonëse treguesi parësor ka vijuar të qëndrojë nën nivelet që do të kërkonin një nivel pozitiv të KUNC-it, ecuria e TPHP evidenton një cikël financiar pozitiv, të mbështetur nga rritja e shpejtë e kreditimit në tërësi dhe në segmente të veçanta (p.sh. kredia për prona të paluajtshme rezidenciale). Periudha të tilla pozitive të ciklit financiar shoqërohen me performancë të mirë financiare të agjentëve të ekonomisë dhe institucioneve financiare. Nga ana tjetër, ato mund të ndikojnë në rënien e standardeve të kreditimit, rritjen e përqendrimit të kredisë në sektorë të caktuar, rritjen e niveleve të borxhit të bizneseve dhe familjeve, dhe përkeqësimin e cilësisë së kredisë, duke dobësuar qëndrueshmërinë e bankave ndaj goditjeve.



Aktivizimi i shtesës kundërciklike të kapitalit synon zbutjen e ciklit financiar dhe parandalimin e përhapjes të rreziqeve. Gjithashtu, nivelet më të larta të kapitalit rrisin kapacitetin përthithës të bankave ndaj goditjeve dhe ulin luhatshmërinë në aktivitetin kreditues të bankave gjatë fazës rënëse të ciklit financiar.

2.3.3. KUADRI REGULLATIV DHE METODOLOJIK

Gjatë vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka punuar në drejtim të përmirësimit të kuadrit të politikës makroprudenciale, duke u përqendruar në rishikimin e metodologjisë për identifikimin e bankave sistemike dhe asaj për përcaktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit, si edhe në krijimin, për herë të parë, të një baze të detajuar të dhënash për standardet e kredive në sektorin e pasurive të paluajtshme. Në të njëjtën kohë ka vijuar puna për zbatimin e detyrave të përcaktuara në strategjinë e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025". Drejtimet kryesore të punës listohen në vijim.

- Në muajin shkurt, Banka e Shqipërisë publikoi një variant të rishikuar të metodologjisë "Mbi mënyrën e llogaritjes dhe të ndryshimit të rëndësisë sistemike të bankave dhe të shtesës përkatëse makroprudenciale të kapitalit". Rishikimi i Metodologjisë synoi të forcojë kujdesin e Bankës së Shqipërisë në identifikimin e bankave me rëndësi sistemike, veçanërisht kur një bankë ndryshon statusin e saj, duke hyrë ose dalë nga kjo kategori. Gjithashtu, metodologjia adreson ndryshimet strukturore në sektorin bankar, si bashkimet, ndarjet apo zhvillime të tjera që ndikojnë menjëherë në numrin dhe madhësinë e bankave.
- Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me ekspertë të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë ka studiuar mundësinë e vendosjes së një norme pozitive neutrale të shtesës kundërciklike të kapitalit në Shqipëri. Ky projekt, i cili pritet të mbyllet gjatë vitit 2025, synon të hartojë një kuadër konceptual për mundësinë e zbatimit të këtij instrumenti, ta kalibrojë atë për rastin e Shqipërisë, si dhe të realizojë një analizë krahasuese me ekonomi të ngjashme, të cilat zbatojnë një regjim të një norme pozitive neutrale të shtesës kundërciklike të kapitalit.
- Pas miratimit të rregullores 44/2023 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për pasuri të paluajtshme", Banka e Shqipërisë filloi punën për mbledhjen e të dhënave bankare të kërkuara nga kjo rregullore: të dhënat tremujore për kredite e reja dhe të dhënat vjetore për tepricën e kredisë. Të dhënat e përpunuara u paraqitën në një analizë të shpërndarjes së treguesve kryesorë të standardeve të kreditimit si: raporti i kredisë ndaj vlerës së pronës, raporti i borxhit të kredimarrësit ndaj të ardhurave, raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave etj. Të gjithë treguesit u përpunuan në bazë të kategorive të kredimarrësve dhe karakteristikave të kredisë dhe kolateralit, sipas përcaktimeve në format



e raportimit të Rregullores. Ata do të monitorohen dhe analizohen në vazhdimësi si pjesë e analizës së rregullt të rreziqeve sistemike në tregun e pasurive të paluajtshme.

- Banka e Shqipërisë ka punuar për realizimin e disa prej aktiviteteve të parashikuara në strategjinë e saj “Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025”. Një ndër këto aktivitete ishte hartimi i një pyetësori që synon të mbledhë informacion nga kompanitë më të mëdha në vend mbi vlerësimin e tyre për ndikimin e ndryshimeve klimatike, buxhetin dhe burimet për të garantuar qëndrueshmëri, sfidat dhe menaxhimin e rreziqeve fizike. Ky pyetësor pritet të hidhet në terren gjatë vitit 2025. Në kuadër të Strategjisë dhe me mbështetjen teknike të Qendrës Këshillimore për Sektorin Financiar të Bankës Botërore, Banka e Shqipërisë ka punuar për vlerësimin e ndikimit të rreziqeve të klimës në sektorin financiar, nëpërmjet një ushtrimi të posaçëm të provës së rezistencës. Ky ushtrim përqendrohet në ekspozimin e sektorit bankar ndaj rreziqeve të tranzicionit (drejt një pozicioni ku ekspozimet e ndjeshme ndaj klimës janë të identifikuara dhe të menaxhuara) dhe synon të vlerësojë ndikimin e masave për kalimin drejt një ekonomie më rezistente, mbi kreditë joperformuese.

HAPËSIRË INFORMUESE 4

POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMET NDËRSEKTORIALE


Ekspozimet ndërsektoriale që regjistrohen në sistemin e llogarive kombëtare, janë të rëndësishme për të kuptuar pozicionin financiar dhe dinamikën e sektorëve të caktuar, si dhe kontributin e tyre në rezistencën apo dobësitë e ekonomisë në përgjithësi.

Të dhënat e sistemit të llogarive kombëtare për vitin 2023, tregojnë që: (i) mjetet e sistemit financiar u rritën në rreth 2,900 miliardë lekë; (ii) ato mbizotërohen nga letrat me vlerë të borxhit dhe nga huatë; ndërkohë që (iii) rreth 80% e detyrimeve të institucioneve financiare kanë formën e depozitave.

Pozicioni neto i sektorit financiar vijon të jetë i balancuar pasi mjetet dhe detyrimet financiare të këtyre subjekteve kanë vlera të krahasueshme. Në raport me sektorët e tjerë institucionalë, korporatat financiare paraqiten si huamarrës neto ndaj sektorit të individëve dhe si huadhënës neto ndaj jorezidentëve dhe ndaj qeverisë së përgjithshme. Këto pozicione janë zgjeruar lehtë gjatë vitit 2023. Gjatë periudhës 2017 – 2023, korporatat e tjera depozituese ose sektori bankar, së bashku me ndërmjetësit e tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë, kanë regjistruar një pozicion të vogël kreditor (huadhënës neto), ndërkohë që kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit dhe të investimeve kanë pozicione neto debitore.



Grafik 34. Pozicioni neto i korporatave financiare sipas kundërpasive (majtas) dhe sipas segmenteve (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.4. MBIKËQYRJA BANKARE

Funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka si objektiv kryesor identifikimin e hershëm dhe marrjen e masave për reduktimin e rreziqeve të aktivitetit të sektorit bankar: rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut të normës së interesit, rrezikut të kapitalit dhe të përfitueshmërisë, atij të reputacionit dhe të pastrimit të parave etj. Gjithashtu, ky funksion synon dhe vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe të qeverisjes së korporatave, si faktorë të rëndësishëm të zbutjes së rreziqeve në të gjithë sferën e veprimtarisë së bankave në veçanti, por edhe të subjekteve të tjera jobanka, të cilat licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Veprimi në kohën e duhur dhe marrja e masave rregulluese efektive, nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme, dhe zbatueshmëria e tyre, mbeten hallkat më të rëndësishme për të finalizuar me sukses qëllimin fundor: ruajtjen e shëndetit të subjekteve financiare.

Veprimtaria e sektorit bankar, gjatë vitit 2024, u karakterizua nga qëndrueshmëria, e shprehur në nivelin e lartë të kapitalizimit, të likuiditetit dhe të përmirësimit të cilësisë së aktiveve. Banka e Shqipërisë vijoi punën për përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator me acquis të BE-së dhe rishikoi kuadrin rregullator për mbrojtjen e konsumatorëve nga rreziku i pamundësisë për të shlyer detyrimet.

2.4.1. ZHVILLIME KRYESORE

TREGUES KRYESORË TË SHËNDETIT TË SEKTORIT BANKAR

Raporti i mjaftueshmërisë u vlerësua në nivelin 19.82% në dhjetor 2024, nga 19.93% një vit më parë. Treguesi i kredive me probleme arriti në 4.17% në fund të vitit, nga 4.74% një vit më parë. Ky tregues u ndikua pozitivisht si nga rënia e volumit të kredive me probleme me 0.67%, ashtu edhe nga rritja e portofolit të kredisë me 12.8%. Niveli i likuiditetit mbetet i lartë, ku raporti i mbulimit me likuiditet dhe raporti neto i financimit të qëndrueshëm raportohen përkatësisht në 273.4% dhe 182%, kundrejt minimumeve rregullatore prej 100%.

Rezultati financiar i sistemit rezultoi 37.4 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 5.5 miliardë lekësh krahasuar me një vit më parë. Treguesit e përfitueshmërisë ROA dhe ROE paraqiten po ashtu të përmirësuar, përkatësisht në 1.86% dhe 18.21%.

MBROJTJA KONSUMATORE

Një nga zhvillimet e rëndësishme të mbikëqyrjes gjatë vitit 2024 ka qenë rishikimi i kuadrit rregullator me qëllim mbrojtjen e huamarrësve individë ndaj



pamundësisë për të shlyer detyrimet e huave. Këto ndryshime vendosën kritere të reja për analizën financiare të huamarrësve individë nga subjektet financiare jobanka. Qëllimi i kësaj analize nuk është vetëm vlerësimi i aftësisë për të shlyer detyrimet financiare, por edhe garantimi që kredimarrësi mund të përballojë shpenzime të tjera të domosdoshme, pa ndikuar ndjeshëm në gjendjen e tij të përgjithshme financiare.

Këto kërkesa përfshijnë vendosjen e një raporti tavan për shërbimin e borxhit, me qëllim parandalimin e mbiborxhit dhe shmangien e praktikave të papërgjegjshme të huadhënies për konsumatorët. Gjithashtu, janë vendosur kufizime për kontratat e huadhënies, duke përjashtuar individë me karakteristika të caktuara - si personat e regjistruar në lista të krijuara nga institucionet financiare për ata që nuk lejohen të marrin kredi – dhe individët me aftësi të kufizuara apo me mungesë të kapacitetit juridik - në rastet kur kjo i pengon në shlyerjen e kredisë. Po ashtu, ndryshimet rregullatore përcaktojnë fashën orare brenda së cilës mund të lidhen kontratat e kredisë, si dhe kufizojnë numrin e kredive konsumatore që mund të marrë një individ.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË

Në vijim të procesit të nisur për ndryshimin e raportimit financiar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, u evidentuan rregulloret që duhet të pësojnë ndryshimet për t'iu përgjigjur kërkesave të reja. Rregullorja kryesore që do të preket është ajo e administrimit të rrezikut të kredisë. Për këtë qëllim u ngrit një grup pune, i cili do të rishikojë tërësisht kuadrin rregullator ekzistues dhe do ta përshtatë atë me standardet e reja.

Në kuadër të këtij projekti, po vijon puna për ndërtimin e një modeli për përlllogaritjen e probabilitetit të dështimit të subjekteve huamarrëse. Ky model do të ndihmojë në vendosjen e filtrave prudencialë të mbikëqyrjes për mënyrën e klasifikimit dhe provigjonimit të huave, sipas përcaktimeve të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe atyre të institucioneve evropiane.

RISHIKIMI I KUADRIT TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT OPERACIONAL

Kuadri rregullator i administrimit të rrezikut operacional u rishikua me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e pritshmërive mbikëqyrëse nga institucionet subjekt i kësaj rregulloreje, përditësimin me standardet dhe praktikën më të mira të tregut, si dhe forcimin e mbikëqyrjes në distancë. Si rezultat, u hartua dhe u miratua rregullorja e re "Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike", e cila bazohet në standardet e rishikuara të Komitetit të Bazelit mbi administrimin e rrezikut operacional. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, si edhe subjekte të tjera të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas gjykimit mbikëqyrës. Në të njëjtën kohë, u hartuan edhe disa ndryshime në rregulloren ekzistuese për subjektet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit "Për administrimin e rrezikut operacional". Këto ndryshime synojnë të harmonizojnë kërkesat rregullatore me



veprimtarinë financiare të subjekteve të rregullores, duke reflektuar gjithashtu standardet e rishikuara të Komitetit të Bazelit.

Ndryshimet e sipërpërmendura rregullatore shoqërohen edhe me kërkesa të reja raportuese, të cilat përfshijnë treguesit e paralajmërimit të hershëm dhe regjistrin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Për rrjedhojë u hartuan edhe ndryshimet përkatëse në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”.

FINANCA E GJELBËR

Në kuadër të financës së gjelbër dhe strategjisë së hartuar për përfshirjen e saj në proceset mbikëqyrëse, në vitin 2024 është hartuar dhe publikuar për herë të parë udhëzuesi i pritshmërive mbikëqyrëse për përfshirjen e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike në proceset e brendshme të bankave. Ky udhëzues përmban kritere të përgjithshme që lidhen me ndërtimin e proceseve të brendshme të bankave në administrimin e rrezikut, ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për çështjet e klimës dhe përgatitjen e produkteve të posaçme që adresojnë këto dukuri. Udhëzuesi është në formën e orientimeve dhe shërben si hap paraprak për përgatitjen e institucioneve bankare për ndryshimet e ardhshme rregullative. Në vijim të këtij udhëzuesi pritet një vetëvlerësim i bankave mbi nivelin e tyre të përputhshmërisë me pritshmëritë mbikëqyrëse, raportim i cili do të vlerësohet gjatë vitit 2025.

2.4.2. EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2024 janë kryer në total 11 ekzaminime në vend, konkretisht 3 ekzaminime të plota në banka, 5 ekzaminime në institucione financiare jobanka, 2 ekzaminime në institucione të parasë elektronike dhe 1 ekzaminim i plotë në shoqëri kursim-krediti (SHKK).

Tabelë 7. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2024

| Inspektime të kryera në subjekte | Rreziku Strategjik | Rreziku Organizativ | Rreziku i Kredisë | Rreziku i Likuiditetit | Rreziku i Normës së Interesit | Rreziku i Tregut | Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit | Rreziku Operacional | Rreziku Reputacional | Përfundueshmëria | Kapitali |
|----------------------------------|--------------------|---------------------|-------------------|------------------------|-------------------------------|------------------|---|---------------------|----------------------|------------------|----------|
| 2022 | 8 | 9 | 12 | 12 | 8 | 8 | 8 | 8 | 82* | 8 | 12 |
| 2023 | 8 | 8 | 8 | 8 | 4 | 8 | 7 | 7 | 61** | 8 | 8 |
| 2024 | 11 | 10 | 9 | 11 | 3 | 11 | 8 | 8 | 48*** | 11 | 11 |

* Në vitin 2022, janë kryer ekzaminime në 70 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 12 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

** Në vitin 2023, janë kryer ekzaminime në 50 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

*** Në vitin 2024, janë kryer ekzaminime në 37 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.



Gjatë vitit 2024, janë mbuluar me ekzaminime një bankë sistemike dhe dy banka josistemike. Fokusi kryesor i ekzaminimeve ka qenë menaxhimi i rreziqeve, duke konsideruar me prioritet rrezikun e kredisë si rreziku me peshën më të lartë në profilin e bankave. Në këtë kuadër, janë vlerësuar në mënyrë kritike: ndarja e përshtatshme e përgjegjësisë mes linjave të biznesit dhe funksioneve të kontrollit, sigurimi i efektivitetit të punës së tyre, mbikëqyrja rigoroze nga organet e larta drejtuese etj.

Në lidhje me qeverisjen, evidentohet se, krahas përputhshmërisë me kërkesat ligjore e rregullatore, bankat duhet të sigurojnë edhe një kulturë të qëndrueshme për një zbatim cilësor të parimeve “të një qeverisjeje të mirë”. Kjo kulturë nënkupton përfshirjen aktive të anëtarëve të organeve të larta drejtuese në hartimin dhe harmonizimin e dokumenteve për zhvillimin e biznesit dhe të atyre për ruajtjen e niveleve të pranueshme të ekspozimit ndaj rreziqeve, në masën që mund të përballohen nga kapitali i disponueshëm i bankës etj. Një vend të rëndësishëm ka zënë edhe trajtimi i rreziqeve operacionale të lidhura me zhvillimet e shpejta në kuadër të digjitalizimit dhe të ndërthurjes së sistemeve e teknologjive të ndryshme të përdorura gjatë aktivitetit të bankave.

Gjatë vitit 2024, ekzaminimet e subjekteve jobanka dhe SHKK-ve kanë mbuluar kategori të ndryshme të veprimtarisë, ku përfshihen subjekte të parasë elektronike të kredidhënies dhe mikrokredisë. Në fokus ka qenë modeli i biznesit, sistemet e qeverisjes, rreziku i kredisë, rreziqet e tregut dhe ato operacionale, saktësia e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparencë me klientët dhe rreziku i pastrimit të parave. Nga ekzaminimet evidentohet se aktiviteti i këtyre subjekteve gjeneron të ardhura të qëndrueshme, të cilat kanë mbështetur në vazhdimësi kapitalin. Në përgjithësi, kuadri i brendshëm organizativ dhe rregullator përputhet me madhësinë dhe kompleksitetin e subjekteve që kanë pozicion të konsoliduar në treg. Ndërkohë, subjektet më të reja në treg, sidomos ato të parasë elektronike, shfaqin mangësi dhe nevoja për plotësime dhe përmirësime, në përputhje me nivelin aktual të veprimtarisë dhe parimet e një qeverisjeje të kujdesshme, dhe në lidhje me saktësinë e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparencën me klientët dhe parandalimin e pastrimit të parave.

Për shkeljet e evidentuara, Banka e Shqipërisë ka marrë masat përkatëse mbikëqyrëse, konkretisht: revokim licence për 2 subjekte jobanka; pezullim aktiviteti për 2 subjekte jobanka dhe për 2 SHKK; gjobitje dhe dhënie vërejtjeje për administratorët për një bankë; tërheqje vëmendjeje për 1 ZKV; masë administrative (gjobë) për 12 ZKV; dhe revokim licence për 1 ZKV.

Në vijim të revokimit të licencave të dy subjekteve, MCA dhe Final, është bërë një punë voluminoze për adresimin e shqetësimeve të huamarrësve. Në këtë kuadër, është vënë në dispozicion personel i dedikuar për të sqaruar huamarrësit mbi mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve me subjektet, mbi vijimësinë e detyrimeve të huave në kushtet e reja të krijuara, si dhe mbi kalimin e të dy subjekteve pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.



2.4.3. RISHIKIMI I KUADRIT RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2024, vijoi punën për plotësimin e kuadrit rregullator mbikëqyrës, nëpërmjet miratimit të akteve të reja, apo rishikimit të disa prej akteve në fuqi, duke synuar përafrimin e mëtejshëm të këtij kuadri me acquis të BE-së dhe konsideruar zhvillimet apo problematikat e sistemit bankar e financiar në vend.

Disa nga zhvillimet kryesore të kuadrit rregullator dhe metodologjik gjatë vitit, paraqiten në vijim.

I. Në kuadër të rregullimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve të pagesave, Këshilli Mbikëqyrës miratoi:

- udhëzimin "Për raportimin e incidenteve madhore", i cili përcakton kriteret për klasifikimin e incidenteve operacionale ose të sigurisë si incidente madhore, nga ofruesit e shërbimeve të pagesave. Pjesë e këtij raportimi janë edhe format përkatëse të raportimit dhe procedurat që ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të ndjekin për të njoftuar Bankën e Shqipërisë, në rastin e ndodhjes së një incidenti madhor operacional apo të sigurisë;
- disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", që konsistojnë në përfshirjen e disa kërkesave të reja në zbatim të dispozitave të ligjit 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike". Ndryshimet garantojnë zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje në mënyrë të njëjtë si për llogaritë e pagesave edhe për llogarinë e pagesave me shërbime bazike, në lidhje me kërkesat për krahasueshmërinë, transparencën e tarifave dhe transferimin e llogarive, si dhe me parashikimin e metodologjisë së përlllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në këtë lloj llogarie;
- rregulloren "Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve", e cila përcakton rregullat për informacionin e nevojshëm që duhet të shoqërojë transfertat e fondeve në Euro, në kuadër të pjesëmarrjes në SEPA, ku të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshirë në transfertën e fondeve ndodhet në Republikën e Shqipërisë.

II. Në kuadër të rishikimit të kuadrit rregullator për administrimin e rrezikut operacional, gjatë vitit 2024, Këshilli Mbikëqyrës miratoi:

- rregulloren "Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike", e cila përcakton kërkesat dhe rregullat minimale për administrimin e rrezikut operacional gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare e financiare nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike. Hartimi i rregullores u bazua në standardet e rishikuara të Komitetit të Bazelit, në lidhje me administrimin e rrezikut operacional;



- disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut operacional”²¹, të cilat synojnë përshtatjen e kërkesave të rregullores me veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka dhe të shoqërive të kursim-kreditit e unioneve të tyre. Kjo përshtatje është e nevojshme pasi, tashmë, vetëm këto subjekte do të zbatojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, duke qenë se bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, do të jenë subjekte të rregullores së re të miratuar;
- disa ndryshime në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, të cilat konsistojnë në prezantimin e formularëve të rinj me frekuencë tremujore për “Treguesit e paralajmërimit të hershëm” dhe “Regjistrin e ngjarjeve të rrezikut operacional”, në përputhje me kërkesat e reja apo të rishikuara rregullatore, sipas tipologjisë së subjekteve të mbikëqyrura. Ndryshimet në sistemet raportuese të subjekteve përfshijnë edhe shtimin e një formulari të rëndësishëm me frekuencë tremujore, i cili synon të sigurojë informacion mbi strukturën e aksionerëve/ ortakëve në kapitalin e subjekteve raportuese (banka, subjekte financiare jobanka, institucione pagesash dhe të parasë elektronike).

III. Në kuadër të përmirësimit dhe forcimit të kërkesave licencuese, mbikëqyrëse dhe për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka u miratuan:

- disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”²², që synojnë të plotësojnë më tej bazën rregullatore për subjektet financiare jobanka, kryesisht në rastet pas revokimit të licencës, por edhe në rastet që shoqërojnë proceset e likuidimit të portofolave të tyre të kredive;
- disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”, të cilat parashikojnë ndryshimin e formës ligjore të subjekteve financiare jobanka, nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare, si për subjektet të cilat do të licencohen pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, ashtu edhe për ato që operojnë aktualisht në treg. Ndryshimet gjithashtu përfshijnë edhe disa kërkesa rregullatore të shtuara e të përmirësuara, lidhur me aspektet e zmadhimit të kapitalit dhe ndryshimet në strukturën e kapitalit të subjekteve financiare jobanka, si dhe për dokumentacionin e kërkuar për miratimin e kryetarëve të organeve drejtuese të subjekteve;
- disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, që përfshijnë shtimin e kërkesave të reja për vlerësimin e aftësisë paguese të kredimarrësve në kontratat e kredive konsumatore, për subjektet financiare jobanka dhe institucionet

²¹ Nëpërmjet ndryshimeve të miratuara, ka ndryshuar edhe titulli i rregullores në: rregullorja “Për administrimin e rrezikut operacional nga subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”.

²² Nëpërmjet ndryshimeve të miratuara, ka ndryshuar edhe titulli i rregullores në: rregullorja “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”.



financiare të mikrokredisë. Ndryshimet përfshijnë edhe kërkesën – për subjektet financiare jobanka, të cilat blejnë kredi me probleme – që shlyerja e kësteve të kredive të blera, me qëllim klasifikimin e tyre si kredi jo me probleme, nuk duhet të bëhet nëpërmjet një kredie.

2.4.4. KUADRI LICENCUES DHE MIRATIMET

Gjatë vitit 2024, numri i bankave që operojnë në Shqipëri vijon të jetë 11, i pandryshuar në krahasim me një vit më parë. Sektori bankar vazhdoi të mbizotërohet nga prania e filialeve të grupeve të huaja bankare, me origjinë të kapitalit kryesisht nga BE-ja.

Banka e Shqipërisë dha miratimet paraprake përkatësisht për: zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrolluese) të aksioneve të kapitalit të 2 subjekteve financiare jobanka; ndryshimet në statutet e 2 bankave; emetimin e borxhit të varur nga 2 banka; dhe shlyerjen e borxhit të varur nga 1 bankë; si dhe miratimin e emërimit të ekspertëve kontabël të autorizuar (audituesit ligjorë) për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2024 të të gjitha bankave.

Banka e Shqipërisë dha miratimet për 56 administratorë të bankave, të cilët, sipas pozicioneve, renditen përkatësisht: 21 anëtarë të këshillave drejtues; 8 anëtarë të komiteteve të kontrollit; dhe 27 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm të bankave.

Gjatë vitit 2024, rrjeti i bankave u zgjerua me 11 degë të reja, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që bankat kanë sjellë njoftime për mbylljen e 1 dege / agjencie. Në fund të vitit, bankat ushtronin veprimtarinë e tyre nëpërmjet 400 degëve / agjencie bankare.

Tabelë 8. Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave (fund i periudhës)

| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|------|------|------|------|------|----------------|------|------|----------------|
| Bankat në Shqipëri, prej të cilave: | 16 | 16 | 14 | 12 | 12 | 12 | 11 | 11 | 11 |
| I. Me kapital privat me shumicën e pronësisë ¹ të huaj | 13 | 13 | 11 | 8 | 8 | 8 | 6 | 6 | 6 |
| • nga vendet e BE-së | 9 | 9 | 7 | 6 | 6 | 6 | 5 | 5 | 5 ² |
| • nga Turqia | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 ³ |
| • nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite) | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 ⁴ | | | |
| II. Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase | 3 | 3 | 3 | 4 | 4 | 4 | 5 | 5 | 5 ⁵ |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹ "Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë e 50% të votave plus 1 votë.

² Bankat me origjinë të kapitalit nga vendet e BE-së, në fund të vitit 2023, janë nga: Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Hungaria (Banka OTP Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimeve, Albania).

³ Banka Kombëtare Tregtare.

⁴ Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

⁵ Bankat me shumicë kapitali vendas, në fund të vitit 2023, janë: Banka Union, Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Tirana dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.



Mbështetur në aplikimet e paraqitura, Banka e Shqipërisë miratoi ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë (shërbimi i inicimit të pagesës dhe shërbimi i informimit të llogarisë) të 1 institucioni të parasë elektronike.

Përgjatë vitit 2024, u krye përditësimi i licencave dhe anekseve të licencave të 5 institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe i një shoqërie të kursim-kreditit, e cila ushtron edhe veprimtaritë/shërbimet e pagesave. Në fund të vitit, ushtronin veprimtaritë financiare 37 subjekte financiare jobanka (përfshirë dhe institucione financiare të mikrokredisë), institucione të pagesave dhe institucione të parasë elektronike. Për subjektet financiare jobanka dhe institucionet e parasë elektronike, u dhanë gjithashtu miratimet paraprake për 8 administratorë, 4 kryetarë të këshillit mbikëqyrës dhe 1 kryetar të komitetit të kontrollit.


Gjithashtu, u dhanë miratimet për emërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2024 për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, si dhe miratimi i emetimit të borxhit të varur të 1 subjekti financiar jobankë dhe 1 shoqërie të kursim-kreditit.

Gjatë vitit 2024, u licencuan 46 zyra të reja të këmbimit valutor dhe iu revokua licenca 25 zyrave ekzistuese. Në fund të vitit, ushtronin aktivitetin 642 zyra të këmbimit valutor.

Tabelë 9. Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund i periudhës)

| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|--|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Banka | 16 | 16 | 14 | 12 | 12 | 12 | 11 | 11 | 11 |
| Subjekte financiare jobanka | 28 | 31 | 30 | 32 | 30 | 35 | 38 | 39 | 37 |
| Zyra të këmbimit valutor | 428 | 426 | 463 | 503 | 538 | 556 | 583 | 621 | 642 |
| Unione të shoqërive të kursim-kreditit | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Shoqëri të kursim-kreditit | 13 | 13 | 13 | 14 | 14 | 16 | 16 | 16 | 16 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.5. NDËRHRYJA E JASHTËZAKONSHME

Ligji "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë" i jep Bankës së Shqipërisë kompetencën e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vend.

Ky mandat ligjor synon të sigurojë një ndërhyrje të jashtëzakonshme të organizuar tek bankat me paaftësi paguese, duke shmangur ndikimin e tyre negativ në sistemin financiar dhe në ekonominë reale, minimizuar përdorimin e parave të taksapaguesve dhe garantuar mbrojtje të depozitave të siguruara e të aktiveve të klientëve.

Viti 2024 ishte një vit i rëndësishëm për Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pasi në aktivitetin e saj u shënuan një sërë arritjesh. Angazhimi i Bankës së Shqipërisë u orientua nga objektivat e parashikuar në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit, 2022-2024, dhe synoi përafrimin maksimal me standardet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të Bashkimit Evropian.

Arritjet kryesore ishin:

1. fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka;
2. plotësimi i kërkesave rregullatore për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar;
3. plotësimi në vijueshmëri i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme;
4. operacionalizimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Në kuadër të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë mbajti një dialog aktiv dhe të qëndrueshëm me sektorin bankar. Përmes tij u monitorua rregullisht përmbushja e programit vjetor të punës për zhvillimin e kapaciteteve të bankave, si pjesë e rekomandimeve të identifikuara gjatë procesit vjetor të inspektimeve.

Nga vlerësimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme rezulton se bankat kanë bërë progres të rëndësishëm drejt mbështetjes me sukses të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Të gjitha bankat me strategji ndërhyrjen e jashtëzakonshme plotësuan nivelin e ndërmjetëm të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL) për vitin 2024, nëpërmjet emetimeve në tregun e brendshëm të obligacioneve të pranuar për këtë qëllim. Zhvillimi i kapaciteteve të bankave lokale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, veçanërisht për ato që janë pjesë e grupeve bankare ndërkufitare, duhet vendosur në kontekstin e zhvillimeve përkatëse në të gjithë grupin bankar. Për këtë qëllim, mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në vitin 2024, Banka e Shqipërisë mori



pjesë në mbledhjet e Kolegjeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për dy grupe bankare evropiane që operojnë në Shqipëri me filialet e tyre.

Në zbatim të kërkesave të kuadrit ligjor, me kontributin vjetor të bankave, është krijuar dhe po rritet Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Ky fond duhet të arrijë, në vitin 2027, nivelin e barabartë me 0.5% të totalit të detyrimeve të sektorit bankar. Pas pagimit të kontributit vjetor nga të gjitha bankat në shumën 982 milionë lekë, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arriti 5.7 miliardë lekë në fund të vitit 2024, afërsisht sa 0.3% e detyrimeve të sektorit bankar.

Paralelisht me ngritjen e kuadrit rregullator, ka vijuar puna për operacionalizimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë proces ka ndihmuar bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare si Banka Botërore (FinSAC) dhe BERZH, të cilat kanë asistuar Bankën e Shqipërisë në përgatitjen e dokumenteve udhëzuese apo manualeve, në shërbim të rritjes së zbatueshmërisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.


2.5.1. FUQIZIMI I AFTËSISË PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME

PLANET E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në zbatim të kuadrit ligjor e rregullator, Banka e Shqipërisë përditëson çdo vit planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme (PNJ) për të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri. Gjatë ciklit të vitit 2024, Banka e Shqipërisë përditësoi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas informacionit periodik të raportuar nga bankat, si dhe rezultateve dhe informacioneve të përfuara gjatë procesit të inspektimit në vend, të realizuar gjatë muajit maj 2024.

Si pjesë e procesit vjetor të përditësimit të PNJ-ve, gjatë vitit 2024 u realizua identifikimi dhe vlerësimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike dhe vlerësimi i testit të interesit publik për të gjitha bankat. Ky test vlerëson përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat të cilat kryejnë të paktën një funksion kritik. Gjatë ciklit vjetor të PNJ-së, janë vlerësuar gjithashtu masat që duhet të ndërmarrin bankat në drejtim të aftësisë së tyre për zbatimin e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në përfundim të këtij procesi, secilës banke i është komunikuar përmbledhja ekzekutive e PNJ-së, duke u fokusuar në vlerësimin e aftësisë së bankës për të zbatuar në mënyrë eficiente strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Për ciklin e vitit 2024, bankat kanë shënuar përparime në drejtim të objektivit për qeverisjen, si dhe për rritjen e kapaciteteve për përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizim të tyre. Gjithashtu, ato kanë shënuar zhvillime pozitive në përgatitjen për sigurimin e vazhdimësisë operationale dhe ruajtjen e aksesit në tregun financiar, në rast se i nënshtrohen ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në përmbushje të prioriteteve për ciklin e planeve të vitit 2024, bankat kanë dorëzuar pranë Bankës së Shqipërisë metodologjinë e tyre për identifikimin dhe mobilizimin e kolateraleve dhe planin e komunikimit në ndërhyrje të



jashtëzakonshme. Gjithashtu, në përbushje të prioriteteve të cikleve të mëparshme dhe në vijim të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë, bankat kanë përfunduar metodologjinë për matjen dhe raportimin e likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë ka përcaktuar dhe u ka komunikuar bankave prioritetet për vitin 2025, të cilat lidhen me hartimin e manualit operacional për rikapitalizimin nga brenda dhe përgatitjen e të dhënave të nevojshme për realizimin e vlerësimit në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Prioritetet vjetore të vendosura në kuadër të cikleve të përditësimit të PNJ-ve do të jenë objekt rishikimi, deri në përbushjen e plotë të aftësisë për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, brenda afatit përfundimtar të vitit 2027.

INSPEKTIMET NË BANKA

Në kuadër të vlerësimit mbi aftësinë e bankave për ndërhyrje të jashtëzakonshme, gjatë muajit maj 2024, u realizuan inspektimet e planifikuara pranë bankave që ofrojnë funksione kritike për ekonominë. Këto inspektime u fokusuan në vlerësimin e përbushjes së rekomandimeve të komunikuar gjatë ciklit të vitit 2023 dhe prioriteteve për ciklin e planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme të vitit 2024.

Në krahasim me vitin 2023, inspektimet evidentuan progres në drejtim të masave të ndërmarra nga bankat për rritjen e aftësisë së tyre për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Më konkretisht, u evidentuan: ngritja e strukturave dhe e proceseve të qeverisjes në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe angazhimin e njësisë së kontrollit të brendshëm; hartimi i planeve vjetore me fokus te prioritetet e komunikuar nga Banka e Shqipërisë; përmirësimi i cilësisë së informacionit që kërkohet në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe krijimi i burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, nëpërmjet përbushjes së nivelit vjetor të ndërmjetëm të kërkesës për MREL.

Në vijim të këtij cikli ekzaminimi, Banka e Shqipërisë përgatiti raportet individuale për secilën bankë, me vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse. Nëpërmjet një plani të caktuar komunikimi, bankat informojnë Bankën e Shqipërisë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

2.5.2. KËRKESA MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA (MREL)

MREL-ja përbën një nga elementët kryesorë për përgatitjen financiare të bankave, lidhur me aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Nëpërmjet përbushjes së kërkesës për MREL-në, sektori bankar vijon të ngrejë në mënyrë graduale kapacitetet financiare për të përthithur humbjet dhe për t'u rikapitalizuar përmes burimeve të brendshme, në rast se i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme.




Në zbatim të kuadrit rregullator, niveli i plotë i MREL-së duhet të arrihet brenda vitit 2027, por, gjatë periudhës tranzitore, Banka e Shqipërisë iu komunikon bankave nivelin vjetor të ndërmjetëm që duhet plotësuar.

Gjatë vitit 2024, sektori bankar përmbushi nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL, duke përdorur instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar.

Në dhjetor 2024, kapaciteti i MREL-së në nivel të agreguar arriti në nivelin 22.9% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kundrejt objektivit vjetor të ndërmjetëm prej 18.2%, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për ato banka që i nënshtrohen kërkesës për MREL.

Gjithashtu, në fund të vitit, bankave iu komunikua vendimi për nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL që duhet të plotësohet për vitin 2025. Përmbushja në vijimësi e objektivit të ndërmjetëm, përbën një hap të rëndësishëm drejt objektivit përfundimtar për financimin e plotë të kësaj kërkesë rregullatore. Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë periodike aftësinë e sektorit bankar për të përmbushur kërkesën për MREL, si pjesë e procesit vjetor të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Grafik 35. Kapaciteti MREL, për periudhën 2022-2024, në përqindje të aktiveve të ponderuara me rrezik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 5

BURIMET E FINANCIMIT TË KËRKESËS MREL, GJATË VITIT 2024


Përmbushja e nivelit të ndërmjetëm të MREL-së u mbështet nga aftësia e bankave për të gjetur financim në tregun vendas të kapitalit. Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses emetimi nga sektori bankar i obligacioneve “të pagarrantuara”, të pranuar për qëllime të MREL-së, në Lek, në Euro dhe në USD. Në total, emetimet e reja shënuan rreth 6.3 miliardë lekë ose rreth 3 miliardë lekë më shumë se në vitin 2023. Diversifikimi i burimeve të financimit të MREL-së me instrumente të ndryshme nga instrumentet e kapitalit rregullator u mundësua në vitin 2023. Stoku i “detyrimeve të pranuar” në bilancin e sektorit bankar arriti në 16,7 miliardë lekë në fund të vitit 2024, nga 10.5 miliardë lekë që shënonte në vitin e mëparshëm. Në vijim të forcimit të vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit rregullator përmes rritjes së kapitalit bazë të nivelit të parë dhe emetimeve të reja të borxhit të varur për qëllime të kapitalit të nivelit të dytë, sektori bankar kontribuoi për një përmirësim të ndjeshëm në financimin e kërkesës për MREL.

Në reflektim të këtyre zhvillimeve, struktura e MREL-së përbëhej nga rreth 90.4% instrumente të kapitalit rregullator dhe 9.6% detyrime të pranuar në fund të vitit 2024, krahasuar me përkatësisht 92.5% dhe 7.5% në vitin 2023, dhe përkatësisht 97.8% dhe 2.3% në vitin 2022.



Këto zhvillime reflektojnë përmbushje në vijimësi të kërkesave rregullative të sektorit bankar dhe qëndrueshmëri në diversifikimin e burimeve të financimit të aktivitetit të bankave. Realizimi i këtyre kritereve rrit qëndrueshmërinë financiare dhe forcon bilancin e bankave.

Grafik 36. Burimet e financimit të MREL në miliardë lekë për grupin e bankave që i nënshtrohen kësaj kërkesë (majtas) dhe struktura e MREL në dhjetor 2024 dhe në dhjetor 2022 (djathtas).



2.5.3. PLOTËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE METODOLOGJIK PËR NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME

Zhvillimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik në funksion të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfaqëson një objektivi të rëndësishëm të punës së Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2024 u punua për plotësimin e kuadrit rregullator dhe metodologjik për operacionalizimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe zhvillimin e kapaciteteve të bankave për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Më konkretisht u punua në këto drejtime:

- në fillim të vitit, u nënshkrua Marrëveshja me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave "Për përdorimin e mbështetjes financiare publike për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe kompensimin e depozitave për ruajtjen e stabilitetit financiar". Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e koordinimit të veprimeve mes institucioneve, në rastin e përdorimit të mbështetjes financiare publike;
- në mbështetje të kuadrit ligjor e rregullator, Banka e Shqipërisë realizoi procesin e përzgjedhjes së vlerësuesit të pavarur dhe nënshkroi marrëveshjen kuadër trevjeçare për ofrimin e shërbimit të vlerësimit në ndërhyrje të jashtëzakonshme;



- c. në zbatim të rregullores nr.78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe në përputhje me ciklin vjetor të konsultimit, Banka e Shqipërisë dërgoi pranë bankave dokumentin “Mbi metodologjinë, politikat dhe mënyrën e përmbushjes së kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, për ciklin vjetor të vitit 2024. Në vijim të dialogut të përvitshëm me bankat, metodologjia për llogaritjen e kërkesës për MREL nuk pësoi ndryshime për vitin 2024;
- d. u hartua metodologjia për matjen dhe raportimin e likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme, e cila parashikon kërkesat për raportimin e të dhënave të likuiditetit nga ana e bankave që i nënshtrohen strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- e. në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe donacionin e Mbretërisë së Luksemburgut, u realizua manuali për operacionalizimin e instrumentit të shitjes së biznesit dhe kontratat përkatëse për shitjen e aksioneve dhe shitjen e aktivitetit tregtar;
- f. gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me BERZH-in, Banka e Shqipërisë u përfshi në projektin rajonal për analizën e hendekut rregullator të kuadrit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri, me fokus të veçantë në kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar.


Për vitin 2025, Banka e Shqipërisë ka parashikuar hartimin e një sërë manualesh dhe dokumentesh metodologjike që do të ndihmojnë bankat në përmbushjen e prioriteteve vjetore dhe në përmirësimin e zbatueshmërisë së strategjisë dhe të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përcaktuar në PNJ.

2.5.4. OPERACIONALIZIMI I FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME


Sektori bankar kontribuon çdo vit për përmbushjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (FNJ), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Sipas këtij kuadri, niveli i synuar i FNJ që duhet të arrihet deri në vitin 2027, është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar.

Në bazë të përlogaritjeve në vitin 2024, që përkon me vitin e shtatë të kontributeve të sektorit bankar në FNJ, niveli i synuar i fondit vlerësohet 8.5 miliardë lekë. Me pagesën e kontributit vjetor të bankave në muajin prill të vitit 2024, në nivelin 982 milionë lekë, FNJ-ja arriti në 5.7 miliardë lekë në fund të vitit. Ky nivel përbën rreth 67.6% të nivelit të synuar për vitin 2027.


Grafik 37. Fondi* për ndërhyrjen e jashtëzakonshme i plotësuar në vite dhe niveli i synuar në vitin 2027 (mln Lekë)



*Të dhënat paraprake për vlerën e FNJ në fund të vitit 2024.
Burimi: Banka e Shqipërisë.



Banka e Shqipërisë ka monitoruar rregullisht ecurinë e aktiveve financiare të FNJ-së, bazuar në raportimet periodike të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, e cila vepron si Administrator i FNJ-së, mbështetur në politikën e investimit të miratuar nga Banka e Shqipërisë.



2.6. EMETIMI I MONEDHËS


Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes dhe të qarkullimit të monedhës kombëtare "Lek". Ajo përcakton format, peshat, masat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor brenda vendit.

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është plotësimi i nevojave të ekonomisë me para të gatshme dhe garantimi në vazhdimësi i besimit të publikut në monedhën tonë kombëtare, Lekun. Kjo arrihet nëpërmjet emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave që ofrojnë siguri, besueshmëri dhe qëndrueshmëri, duke shërbyer si një instrument pagese modern dhe cilësor.

Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe përgatitja dhe hedhja në qarkullim e serisë së re të kartëmonedhave me prerje 200 dhe 5000 Lekë, e cila në vitin 2024 shënoi 5 vjet nga emetimi i parë.

KARTËMONEDHA DHE MONEDHA NË QARKULLIM²³ DHE VLERA E TYRE

Monedha kombëtare në qarkullim, gjatë vitit 2024, arriti në 440 miliardë lekë, me një rritje prej 32 miliardë lekësh krahasuar me fundin e vitit 2023 (+8%). Në këtë sasi, rezultuan rreth 161 milionë copë kartëmonedha me vlerë rreth 433 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2023, numri i kartëmonedhave në qarkullim është rritur me rreth 4 milionë copë (+2.5%). Rritja e numrit dhe e vlerës së kartëmonedhave në qarkullim pasqyrojnë zhvendosjen e strukturës



²³ Është numri dhe vlera e kartëmonedhave dhe monedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.




së tyre drejt prerjeve të mëdha, kryesisht 10.000 dhe 5000 Lekë. Si rezultat, vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2024 arriti 2.689 lekë, kundrejt 2,566 lekësh në 2023.

Për sa i takon monedhave metalike, numri i tyre në qarkullim arriti në 291 milionë copë, kundrejt 273 milionë në fund të vitit 2023, me një rritje prej rreth 18 milionë copë në qarkullim (+6.6%). Vlera mesatare e një monedhe metalike në qarkullim, në fund të vitit 2024, arriti në 25 lekë për monedhë.

RICIKLIMI I PARASË FIZIKE, CILËSIA E KARTËMONEDHËS DHE QARKULLIMI I SAJ

Gjatë vitit 2024, pasi u kontrolluan për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim, u përpunuan rreth 94.2 milionë copë kartëmonedha, kundrejt 104.5 milionë copë në vitin 2023. Norma e papërshtatshmërisë²⁴ rezultoi 21.5%, kundrejt 19.3% në vitin 2023. Gjatë vitit, kartëmonedhat e papërshtatshme për qarkullim janë zëvendësuar rast-pas-rasti me kartëmonedha të reja të përshtatshme për qarkullim.



Koeficienti²⁵ i qarkullimit të kartëmonedhës për vitin 2024 rezultoi në vlerën 0.6, që do të thotë se një kartëmonedhë kthehet mesatarisht më pak se një herë në vit në sportelet e Bankës së Shqipërisë. Ky koeficient është më i lartë për prerjet 500 Lekë, 1000 Lekë (mbi 1 herë), dhe më i vogël për prerjen 5,000 dhe 10,000 Lekë.

²⁴ Është raporti i numrit të kartëmonedhave të papërshtatshme mbi numrin total të kartëmonedhave të përpunuara gjatë një viti.

²⁵ Është raporti i numrit të kartëmonedhave të arketuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave në qarkullim.




MBROJTJA E KARTËMONEDHËS DHE MONEDHËS METALIKE NGA FALSIFIKIMI

Në vitin 2024 janë sekuestruar 156 copë kartëmonedha kombëtare të falsifikuara në qarkullim, kundrejt 195 copëve në vitin 2023, si dhe 50 copë monedha metalike. Koeficienti i kartëmonedhave të falsifikuara për 1 milion kartëmonedha në qarkullim vijon të ulët ndjeshëm, duke zbritur në 1 për vitin 2024, nga 1.3 në vitin 2023. Ky tregues preku nivelin më të ulët historik në vitin 2024, duke dëshmuar cilësinë e lartë të kartëmonedhës sonë, e veçanërisht të serisë së re.


Sa i përket shpërndarjes të kartëmonedhave të falsifikuara sipas prerjeve, peshën kryesore e mbajnë prerjet 1000 Lekë dhe 2000 Lekë, të ndjekura nga prerja 5000 Lekë. Monedha metalike me prerje 50 lekë vijon të jetë e vetmja monedhë e falsifikuar, por në sasi të ulët dhe të papërfillshme. Numri më i madh i kartëmonedhave false i takon serisë së vjetër me 133 copë, të cilat zinin 85% të totalit, në dallim nga seria e re, e cila ka një cilësi të lartë dhe elemente të forta sigurie.

Në këndvështrimin teknik dhe/ose teknologjik të fenomenit të falsifikimit të kartëmonedhave, ato janë riprodhime të thjeshta me pajisje digjitale komerciale, pothuajse vetëm me tekniken ink-jet me ngjyra, të shoqëruara me aplikim të teknikave artizanale teknologjike për imitimim të elementeve të sigurisë, ndërsa elementet e sigurisë të lexueshme prej makinave/pajisjeve autentifikuese nuk ndeshen në asnjë rast.

Grafik 40. Ecuria e treguesit të falsifikimit të kartëmonedhave në qarkullim



Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.7. SISTEMET E PAGESAVE

Operimi, mbikëqyrja dhe reformimi i sistemeve të pagesave janë disa nga funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet ushtrimit të tyre, garantohet siguria, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i infrastrukturës bazë të pagesave. Ky është një parakusht i domosdoshëm për përçimin e politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Në përmbushje të këtyre funksioneve, përtej operimit të qëndrueshëm të sistemeve të pagesave, Banka i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit mbikëqyrës dhe katalizator në përmbushje të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël.

Viti 2024 shënoi një ngjarje historike jo vetëm për Bankën e Shqipërisë, por dhe për qytetarët shqiptarë. Në 21 nëntor, Këshilli Evropian i Pagesave (EPC) vendosi të përfshijë Shqipërinë në zonën gjeografike të Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA).

Kjo arritje përmbush edhe një nga objektivat e vendosur në Planin e Ri të Rritjes 2024-2027, të miratuar nga Komisioni Evropian për Shqipërinë dhe vendet e rajonit të Ballkanit (New Growth Plan). Për vendet në rrugën e anëtarësimit në BE, anëtarësimi në SEPA përbën një instrument drejt integritimit evropian, përpara anëtarësimit zyrtar. Ky integrim sjell një sërë përfitimesh në ekonomi të tona, në terma të zgjerimit të tregut, rritjes së formalizmit dhe të uljes së kostove për kryerjen e transaksioneve ndërkufitare²⁶.

2.7.1. ECURIA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Banka e Shqipërisë luan rol thelbësor në funksionimin normal të sistemeve të pagesave, nëpërmjet operimit dhe administrimit të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe 1 infrastrukturë për shlyerjen e titujve. Sistemi AIPS është infrastruktura e vetme për shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlerë të madhe në Lek. Nëpërmjet kësaj infrastrukturë mundësohen edhe shlyerjet e segmenteve të ndryshëm në tregun e brendshëm financiar. Sistemi AECH mundëson klerimin e transaksioneve ndërbankare me vlerë më të vogël se 1.5 milionë lekë, të individëve dhe bizneseve. Sistemi AIPS EURO bën të mundur shlyerjen bruto, në kohë reale të transaksioneve të klientëve të bankave për pagesat në Euro, brenda territorit të Shqipërisë.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë operon sistemin qendror të shlyerjes dhe të regjistrimit të transaksioneve me titujt e qeverisë - AFISaR. Të gjitha sistemet

²⁶ Për një trajtim më të zgjeruar të përfitimeve nga anëtarësimi në SEPA, referojuni Hapësirës Informuese 7 "Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA" në Raportin Vjetor 2023 të Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë, për më shumë informacion mbi procesin e anëtarësimit dhe roli e BSH-së, referojuni Hapësirës Informuese 6, në vijim.




kanë ofruar disponueshmëri maksimale, duke funksionuar normalisht dhe në përputhje me rregullat dhe oraret e operimit.

SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE (AIPS)

Sistemi i pagesave me vlerë të madhe është instrumental në ruajtjen e stabilitetit financiar, pasi siguron qarkullimin normal të likuiditetit në sistemin financiar. Pjesëmarrëse të sistemit AIPS janë të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave (si pjesëmarrës i tërthortë). Vlera totale e likuiditetit të qarkulluar në sistem ishte 13,343 miliardë lekë, gjatë vitit 2024. Në terma të PBB-së, kjo vlerë është rreth 5.3 herë më e lartë²⁷.


Funksionimi i sistemit ka treguar eficiencë të lartë, ku fondet kanë qarkulluar rrjedhshëm, duke bërë të mundur shlyerjen e veprimeve në kohë reale. Një nga treguesit e likuiditetit në sistem është edhe kredia brenda ditës. Ky është një instrument i sistemit AIPS, të cilin Banka e Shqipërisë ua ofron bankave pjesëmarrëse për administrimin e likuiditetit brenda ditës, me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit ndërbankar të pagesave. Vlerat e ulëta të këtij instrumenti në raport me totalin e pagesave të shlyera në sistemin AIPS janë tregues i ekspozimit të ulët të rrezikut të sistemit ndaj administrimit të likuiditetit të pjesëmarrësve.



SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NË EURO BRENDË VENDIT (AIPS EURO)


Sistemi AIPS EURO filloi funksionimin në 24 janar të vitit 2022. Qëllimi kryesor i krijimit të sistemit AIPS Euro ishte kryerja e pagesave në Euro brenda vendit me kosto më të ulët, dhe me një afat kohor shumë më të shkurtër. Më parë, procesi kryhej nëpërmjet bankave korrespondente. Aktiviteti i këtij sistemi ka njohur

²⁷ PBB-ja për vitin 2024 është vlerësim i Bankës së Shqipërisë.



rritje progresive. Të dhënat tregojnë se ai po përdoret gjithnjë e më shumë për pagesa me vlerë të ulët, duke sugjeruar familjarizimin më të madh të individëve me përdorimin e sistemit.

Grafik 42. Volumi dhe vlera e transaksioneve të procesuara ne sistemin AIPS EURO




Zgjerimi i përdorimit të tij ndihmon nxitjen e përfshirjes financiare dhe promovimin e pagesave elektronike në vend. Gjithashtu, duke përdorur këtë sistem, pagesat në Euro brenda vendit rregullohen në tërësinë e tyre nga kuadri ligjor e rregullator prudencial, në kuadër të mbrojtjes konsumatore në vend, duke shmangur marrëdhëniet me bankat korrespondente.

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)

Sistemi AECH mundëson klerimin e transaksioneve ndërbankare me vlerë të vogël, ndërsa rezultatet e klerimit shlyhen në sistemin AIPS. Përdorimi i këtij sistemi reflekton kryesisht përdorimin e transfertave bankare në jetën e përditshme të individëve dhe bizneseve, kryesisht të mesme dhe të vogla.

Grafik 43. Volumi dhe vlera e transaksioneve të kleruar në AECH



Aktiviteti i këtij sistemi ka pasqyruar rritje të vazhdueshme përgjatë viteve, si në terma nominalë edhe në raport me popullsinë, ndërsa rënia e vlerës mesatare për transaksion tregon përdorimin e pagesave elektronike për transaksione me vlerë të ulët, të nevojshme në përditshmëri. Kjo prirje është mbështetur edhe nga heqja e komisioneve për transaksione deri në 20,000 lekë. Pësia e këtyre transaksioneve zë 37% të totalit të transaksioneve në AECH, nga 27% në vitin 2020. Gjithashtu, komisionet janë diferencuar në favor të kryerjes së pagesave me vlerë të vogël në formë elektronike²⁸.

SISTEMI I SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)

Sistemi AFISaR, i cili funksionon prej viti 2015, është sistemi qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të transaksioneve me titujt e qeverisë. Ky sistem operohet nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e agjentit fiskal. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit AFISaR, i ofron Ministrisë së Financave (emetuesit) dhe tregut, organizimin e ankandëve të emetimit të titujve të Shtetit Shqiptar në tregun e brendshëm, në monedhën kombëtare dhe në monedhën evropiane, si dhe shlyerjen dhe regjistrimin e transaksioneve me këto titujt në tregun sekondar. Në këtë sistem, kolateral janë titujt e Shtetit Shqiptar dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes me objekt këta tituj. Përveç sa më sipër, ofrohen edhe shërbimet e mbledhjes së taksave në burim për të ardhurat nga titujt, ngjarjet e pagesave të interesit dhe informimi i mbajtësve të llogarive në këtë sistem, mbi gjendjen dhe lëvizjet në këto llogari.


Në fund të vitit 2024, sistemi AFISaR regjistron 14 institucione financiare pjesëmarrëse të drejtpërdrejta, nga të cilat: 1 emetues (Ministria e Financave) dhe 1 bankë qendrore (Banka e Shqipërisë), 6 institucione financiare pjesëmarrëse të tërthorta me llogari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, dhe lidhje me një 1 Bursë private të tregtimit të titujve. Në fund të vitit 2024, numri i llogarive të individëve në sistemin AFISaR të hapura nëpërmjet Bankës së Shqipërisë ishte 19,840.

Vlera nominale totale e emetimeve të titujve të Shtetit Shqiptar në monedhën kombëtare në sistemin AFISaR, në fund të vitit 2024, ishte 788.51 miliardë lekë, duke u rritur me 7.68% nga fundi i 2023. Në fund të vitit 2024, nuk ka pasur titujt të emetuar në monedhën Euro në sistemin AFISaR.

²⁸ Ndryshimi rregullativ i vitit 2020 i Bankës së Shqipërisë, i cili parashikon eliminimin e komisioneve për pagesat me vlerë të vogël të iniciuara në mënyrë elektronike (home-banking) deri në shumën 20,000 lekë, si dhe diferencimin e tarifave për pjesën tjetër të pagesave të iniciuara elektronikisht deri në 50% të atyre të iniciuara në formë letër.



Grafik 44. Ecuria e transaksioneve të procesuara në sistemin AFISaR (majtas) dhe në përqindje ndaj PPB-së (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.7.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE

Viti 2024 ka konfirmuar priirjen rritëse të pagesave në formë elektronike. Numri i pagesave elektronike të kryera nëpërmjet bankave arriti në 42.3 milionë, me një vlerë totale prej 2,802 miliardë lekësh. Ato kanë shënuar një rritje prej 24.4% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vlera e tyre, një rritje prej 17.8%.

Zhvillimet pozitive në fushën e pagesave elektronike kanë sjellë rritje të treguesit të përdorimit të tyre, duke arritur në 23 pagesa për frymë. Treguesi i "pagesave për frymë" u vendos si një objektiv (prej 10 pagesash për frymë) për t'u arritur në vitin 2023, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, objektiv i cili u arrit që në vitin 2021. Ai shërben si tregues i përmirësimit të aksesit në pagesa elektronike dhe i pranimit të instrumenteve moderne të pagesave. Ky progres reflekton tendencat në rritje të digjitalizimit të

Grafik 45. Numri i instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër në vite (majtas) numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.




shërbimeve financiare dhe lehtësimit të transaksioneve elektronike për individët dhe bizneset.

PAGESA OFRUAR NGA SISTEMI BANKAR

Institucionet bankare luajnë rolin kryesor në ofrimin e shërbimeve të pagesave. Ato janë treguar aktive në vitet e fundit për promovimin e instrumenteve digjitale të pagesave, në përputhje me preferencat e klientëve për një qasje më të shpejtë, më të sigurt dhe më të lehtë ndaj shërbimeve financiare. Kështu, aplikacionet “home banking” janë tashmë të disponueshme nga të gjitha bankat dhe po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar. Përveç funksioneve bazë, si informimi mbi gjendjen e llogarisë, ato po përdoren për kryerjen e pagesave online. Pesha e numrit të transfertave të kreditit në distancë është rritur në 61% të totalit të transfertave.

Grafik 46. Peshja e instrumenteve të pagesave sipas numrit të transaksioneve (majtas) dhe përdoruesit sipas tipologjisë së instrumenteve të pagesave, gjatë vitit 2024 (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2024, numri i pagesave dhe vlera e transaksioneve të realizuara përmes “home banking” janë rritur përkatësisht me 22.1% dhe 19%. Prirja në rritje e transfertave online është nxitur edhe nga masat e marra nga Banka e Shqipërisë për uljen e komisioneve për këtë tipologji transaksionesh²⁹, zhvillimi i infrastrukturës, zgjerimi i aksesit në internet dhe rritja e njohurive të klientëve mbi përdorimin e tij.

Numri i llogarive të aksesueshme në distancë është rritur me 23.2% në vitin 2024, duke zënë 39.1% të totalit të gjithë llogarive të klientëve në banka. Me inovacionet e vazhdueshme dhe automatizimin e shërbimeve, Home Banking pritet të vazhdojë të rritet, duke ofruar një përvojë gjithnjë e më efikase dhe të personalizuar për klientët.

²⁹ Referuar diferencimit të komisioneve midis pagesave online dhe ato me prani fizike pranë degëve të bankave.




Pagesat me para elektronike kanë shënuar një rritje prej 18.6% në numrin e transaksioneve dhe 11.8% në vlerë krahasuar me vitin e kaluar, duke reflektuar tendencën në rritje të digjitalizimit të pagesave. Këto pagesa, të cilat realizohen me para elektronike ose parapagim, përdoren ekskluzivisht nga individët.

KARTAT BANKARE DHE INFRASTRUKTURA (ATM DHE POS-E) PËR PËRDORIMIN E TYRE

Rreth 64% e numrit total të pagesave nëpërmjet bankave janë kryer duke përdorur karta debiti dhe krediti. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i pagesave me kartë është rritur me 26.3%. Përdorimin më të lartë të kartave e shfaqin individët (në 93.5% të numrit të pagesave me kartë).

Të 11 bankat që operojnë në treg janë të licencuara si emetuese kartash, ndërkohë që 9 prej tyre janë të licencuara edhe si pranuese kartash. Në fund të vitit 2024, numri i kartave aktive në qarkullim është 1,510,606, me një rritje prej 5.4% nga viti i kaluar. Pothuajse të gjitha kartat kanë edhe funksion pagese, krahas funksionit të tërheqjes apo depozitimit të parasë fizike. Në përdorimin e kartave mbizotërojnë kartat me funksion debiti, rreth 87.7%, me një vlerë mesatare për transaksion prej 6,746 lekësh. Pjesën tjetër të pagesave me karta e zënë kartat e kreditit, të cilat zakonisht shënojnë një vlerë mesatare më të lartë për transaksion.

Përdorimi i kartave për blerje në терминаlet POS në vend ka shënuar rritje të vazhdueshme, si efekt i disa faktorëve të kombinuar, ku mund të përmendim rritjen e numrit të terminaleve POS ndër vite, rritjen e numrit të kartave të emetuara dhe së fundmi, edhe një rritje e edukimit financiar të popullsisë³⁰ në përdorimin e kartave në këto terminale.



³⁰ Në janar 2024, nga Banka e Shqipërisë është miratuar Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, 2024-2026, e cila promovon edukimin financiar si një e mirë publike, nxit më tej përfshirjen financiare, mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e mirëqenies financiare të individëve dhe të qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi.




Infrastruktura e POS-eve të ofruara nga bankat tregtare ka rezultuar në rritje të konsiderueshme, çka tregon një familjarizim të bizneseve me ofrimin e shërbimit të POS-ve, dhe një reagim pozitiv ndaj kërkesave të klientëve për pagesa me kartë. Numri i tyre është rritur me 27.61% krahasuar me 2023. Gjatë vitit është shtuar dhe numri i POS-eve virtuale, si tregues i zgjerimit të e-commerce në vend.

Numri i ATM-ve është rritur me 9.3% gjatë vitit. Rritja e këtyre të fundit erdhi edhe si rrjedhojë e rritjes së turizmit, duke u ofruar turistëve shërbime në distance. Pavarësisht se ATM-të përdoren kryesisht për tërheqje të parasë fizike, gjatë vitit 2024 është parë zgjerimi i ATM-ve që mundësojnë shërbime të tjera. Numri i ATM-ve me funksion depozitim paraje fizike është rritur me 26 terminale, ndërsa ai i ATM-ve që ofrojnë funksionin e urdhër-transfertave është rritur me 144 terminale. Ofrimi i këtyre funksioneve mundëson njohjen e përdoruesve me mënyra alternative të administrimit të kursimeve dhe të kryerjes së pagesave.


TRANSAKSIONET ME PARA FIZIKE

Depozitimet me para fizike në sportelet e bankave kanë shënuar rritje si në numër (me 7.1%), ashtu dhe në vlerë (me 10.1%), në vitin 2024. Në të kundërt, transaksionet për tërheqjet në para fizike vijojnë të tregojnë një trend zbritës ndërvite. Përdorimi i parasë fizike në ekonominë shqiptare mbetet një fenomen mbizotërues, me kosto të larta në ekonomi.



2.7.3. INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Produktet e parasë elektronike ofrohen dhe nga institucionet financiare jobanka të licencuara si Institucione të Parasë Elektronike. Në tregun shqiptar operojnë 10 institucione të parasë elektronike, të cilat ofrojnë zgjidhje të larmishme në treg, për grupe të ndryshme konsumatorësh. Përdorimi i parasë elektronike sjell



lehtësira, kryesisht për atë pjesë të popullsisë shqiptare që nuk zotëron një llogari bankare. Avantazhet për këtë pjesë të popullsisë konsistojnë në rritjen e fleksibilitetit për kryerjen e pagesave, duke pasur parasysh shtrirjen e këtyre institucioneve në vend, nëpërmjet agjentëve, dhe koston më të ulët për pagesat me vlerë të vogël, si pagesat e gjobave, faturave mujore utilitare etj.

Gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2024³¹, këto institucione, së bashku, kanë procesuar një volum prej afërsisht 11.7 milionë pagesa me para elektronike, ose 12.5% më shumë se një vit më parë.

2.7.4. MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE ROLI REFORMATOR

Përtej operimit të sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje mbikëqyrjes së tyre dhe përdorimit të instrumenteve të pagesave. Për këtë qëllim, ajo ndërmer masa për përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullator dhe të infrastrukturës së pagesave, në përputhje me standardet evropiane.

Aktiviteti i shërbimeve të pagesave mbulohet kryesisht nga ligji “Për Shërbimet e Pagesave” dhe kuadri rregullator i tij, i cili ka transpozuar Direktivën e BE-së për Shërbimet e Pagesave (PSD2). Ai ka hapur tregun e pagesave për një sërë shërbimesh dhe institucionesh, në favor të rritjes së konkurrencës, uljes së kostove dhe rritjes së transparencës për konsumatorin.

Në fund të vitit 2023, u miratua ligji “Për Llogarinë e pagesave me shërbime bazike” i cili hyri në fuqi në muajin prill 2024. Objekti i tij është përcaktimi i rregullave dhe kushteve për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike për konsumatorët dhe individët, duke përfshirë veçanërisht ata të cilët janë të pa mbuluar me shërbime bankare, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit apo historikut të aftësisë paguese brenda Republikës së Shqipërisë. Ai pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e përdorimit të shërbimit të pagesave, si dhe në zgjerimin e përqindjes së popullsisë që zotëron një llogari pagese dhe kryen veprime me të. Deri në fund të vitit 2024, pranë bankave janë hapur 1,007 llogari sipas përcaktimeve të ligjit, mbajtës të të cilave janë pensionistet, përfituesit e ndihmave ekonomike/invaliditetit, studentët etj.

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

Me qëllim zhvillimin e infrastrukturës, Banka e Shqipërisë ka punuar intensivisht gjatë vitit 2024 për:

- projektin “Up-grade i sistemeve AIPS, AIPS Euro dhe AECH”, i cili ka si qëllim implementimin e standardeve ndërkombëtare të procesimit të mesazheve (SEPA/ISO 20022). Këto standarde rrisin sigurinë e transaksioneve, si dhe sigurojnë uniformitet në shkëmbimin e të dhënave në nivel global. Ky projekt parashikohet të përfundojë brenda vitit

³¹ Të dhënat për paranë elektronike janë të disponueshme deri në muajin shtator 2024. Të dhënat vjetore do të gjenerohen pas muajit mars 2025.




2025;

- projektin për zhvillimin e infrastrukturës për pagesat e shpejta (instant payment). "Pagesat e shpejta" janë shlyerje elektronike e pagesave me vlerë të vogël të disponueshme 24/7/365, çka nënkupton shlyerjen e menjëhershme ose pothuajse të menjëhershme ndërbankare të transaksionit. Duke siguruar lëvizjen e fondeve në kohë reale, pagesat e shpejta rrisin sigurinë dhe disponibilitetin e fondeve për përdoruesit dhe mbështesin eficiencën e sistemit financiar. Pagesat e shpejta vlerësohet se, përveç të tjerave, ndihmojnë në zgjerimin e përdorimit të pagesave elektronike dhe në atë të përfshirjes financiare të popullsisë.

Projekti për zhvillimin e infrastrukturës për pagesat e shpejta ka marrë rëndësi të shtuar gjatë vitit të fundit për zhvillimin e ndërveprimit ekonomik midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integrimin e Shqipërisë në tregjet evropiane. Banka e Italisë (Bdl) është angazhuar për krijimin e një sistemi pagesash të shpejta identik me sistemin TIPS të Bankës Qendrore Evropiane (BQE-së) për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkanit (sistemi referohet si TIPS Clone). Kjo do të mundësojë zhvillimin e pagesave të shpejta në nivel kombëtar dhe më tej në nivel ndërkufitar mes shteteve të rajonit. Në 10 janar 2025, Banka e Shqipërisë, së bashku me banka të tjera të rajonit, nënshkroi letrën e interesit për këtë sistem pagesash, në një ceremoni zyrtare në ambientet e Bankës së Italisë.

KOMITETI KOMBËTAR I SISTEMIT TË PAGESAVE

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së tregjeve të pagesave dhe infrastrukturave përkatëse, Banka e Shqipërisë luan rolin e katalizatorit në fushën e pagesave. Ajo shfrytëzon ekspertizën e saj dhe e ndan atë me aktorët e tregut, nëpërmjet konsultimeve të rregullta dhe takimeve të koordinuara me përfaqësues të sektorit privat dhe publik. Në këtë rol, ajo kryeson Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave. Në 5 dhjetor 2024, u zhvillua mbledhja vjetore e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), e cila këtë vit përkoi me 10-vjetorin e krijimit të këtij Komiteti. Gjatë mbledhjes u diskutuan projektet prioritare në fushën e pagesave si: bankingu i hapur, anëtarësimi i ofruesve të shërbimeve të pagesave në SEPA dhe zhvillimi i sistemit për pagesat e shpejta (Instant Payment) në vend. Në takim u prezantuan eksperiencat e vendeve të tjera dhe shërbime të lidhura me transaksionet në sistemet e pagesave të shpejta. Një vëmendje e veçantë iu kushtua dhe edukimit financiar, ku Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol kyç në organizimin e aktiviteteve edukuese për përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave dhe promovimin e pagesave ndërkufitare më të lira dhe më efektive me skemat SEPA.



HAPËSIRË INFORMUESE 6

PROCESI I ANËTARËSIMIT NË SEPA DHE ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË

SEPA – Tregu Unik i Pagesave në Euro – synon të harmonizojë mënyrën e kryerjes së pagesave në Euro në formë elektronike (cashless) ndërmjet vendeve anëtare³². Ai përbën një hap më tej në realizimin e integritit të tregut ekonomik e financiar brenda Bashkimit Evropian dhe ka mbështetjen e industrisë evropiane të pagesave, qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian, Eurosistemit dhe autoriteteve të tjera publike. Duke patur parasysh parimin e një tregu të vetëm, standardizimi i pagesave në euro synon të rrisë eficiencën e tyre nëpërmjet kostove të ulëta dhe shpejtësisë së realizimit të transaksioneve.

Në 12 qershor, Banka e Shqipërisë, në emër të komunitetit financiar shqiptar, paraqiti kërkesën zyrtare për t’iu bashkuar zonës SEPA, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm drejt integritit të sistemit financiar shqiptar në tregun evropian. Shqipëria u bë vendi i parë në rajonin e Ballkanit që aplikoi për anëtarësim në SEPA. Ndonëse përgatitja e aplikimit u udhëhoq nga Banka e Shqipërisë, ai ishte rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe veprimit sinergjik të saj me autoritetet e tjera shtetërore.

Puna për realizimin e aplikimit të anëtarësimin në SEPA është disavjeçare. Banka e Shqipërisë ka marrë një sërë masash për përafrimin e legjislativës kombëtar me *acquis communautaire* të BE-së në fushën e shërbimeve të sistemit të pagesave, për të plotësuar kriteret rregullatore të domosdoshme për anëtarësim. Këto kriteret synojnë të vlerësojnë përafrimin me standardet evropiane, sa i përket: mbikëqyrjes së shërbimeve të pagesave, mbikëqyrjes së sistemit financiar, mbikëqyrjes së aktiviteteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, garantimin e parimeve të konkurrencës, të mbrojtjes së të dhënave personale, të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe së fundmi, dhe bashkërendimin e politikës së jashtme evropiane me atë të vendit.

Banka e Shqipërisë ka punuar ngushtë me Bankën Botërore për realizimin e ndryshimeve ligjore në kohë dhe ka marrë vlerësime pozitive për gatishmërinë e vendit për të qenë anëtare e SEPA-s. Transpozimi i Direktivës Evropiane të Shërbimeve të Pagesave 2, si dhe nxjerrja jashtë listës gri, ishin thelbësorë në plotësimin e kriterëve. Megjithatë, puna për plotësimin e kriterëve tashmë të identifikuar si të paplotësuar, vijoi edhe gjatë vitit 2024. Në 3 prill u miratua rregullorja 21/2024 “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro”. Miratimi i kësaj rregulloreje përbushoi një nga detyrimet ligjore të pjesëmarrjes në SEPA.

Një pikë tjetër për plotësimin e kërkesave lidhej me forcimin e disa aspekteve ligjore të lidhura me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, u përgatit rregullorja “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”, e cila adresoi disa nga mangësitë kryesore, për të qenë në përputhje me kriteret e anëtarësimin në SEPA.

Vendimi për pranimin e shteteve në SEPA merret nga Këshilli Evropian i Pagesave (EPC), një organ me qendër në Bruksel, përgjegjës për standardizimin dhe

³² Zona gjeografike SEPA përfshin 36 vende, ku krahas vendeve të Bashkimit Evropian, anëtare të tjera janë: Mbretëria e Bashkuar, Islanda, Norvegjia, Lihtenshtein, Zvicra, Monako, San Marino, Andorra, Shteti i Shenjtë i Vatikanit dhe, që prej nëntorit, edhe Shqipëria dhe Mali i Zi.



përmirësimin e sistemit të pagesave në Evropë. Në mbledhjen e datës 21 nëntor, EPC-ja mori vendimin për të pranuar Shqipërinë në zonën gjeografike SEPA. Në po të njëjtën mbledhje, ajo miratoi dhe anëtarësimin e Malit të Zi, i cili kishte aplikuar pak kohë pas Shqipërisë.

Pas miratimit të përfshirjes së Shqipërisë në zonën gjeografike SEPA, secili institucion që ofron shërbime pagesash në Shqipëri, duhet të aplikojë individualisht për të qenë anëtar i skemave që administrojnë EPC-ja. Kjo nënkupton dhe krijimin e disa kushteve teknike nga ana e institucioneve tona për të përshtatur infrastrukturën e tyre për operazionalizimin e skemave të pagesave SEPA.

Institucionet shqiptare mund të nisin aplikimin për t'u anëtarësuar në këto skema duke filluar nga muaji prill 2025. Banka e Shqipërisë po bashkëpunon me Bankën Botërore dhe me EPC-në për t'i orientuar këto subjekte në realizimin e aplikimit dhe aderimin në skema.




2.8. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Banka e Shqipërisë është autoriteti kombëtar përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore të Shqipërisë. Ajo përdor mundësitë e saj më të mira për të arritur dhe ruajtur një nivel të caktuar të rezervës valutore, e cila mbështet qëndrueshmërinë financiare të vendit dhe është në përputhje me politikën monetare.

Gjatë vitit 2024, stoku i rezervës valutore bruto u rrit në 6,268.01 milionë euro, nga 5,846.06 milionë euro një vit më parë. Rritja e rezervave valutore mundëson përmirësimin e aftësisë paguese të vendit.

Rregullorja “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, bën një përcaktim të qartë të objektivave parësorë të procesit të administrimit të rezervës, të cilët janë likuiditeti dhe siguria. Sigurimi i të ardhurave nga administrimi i rezervës përfaqëson objektivin e tretë, për sa kohë nuk cenohen objektivat parësorë. Këshilli Mbikëqyrës miraton gjithashtu parimet dhe kriteret cilësore për zhvillimin e aktivitetit të administrimit të rezervës valutore.



Në zbatim të këtyre kriterëve, Komiteti i Investimit miraton emrat e lejuar në të cilët investohet rezerva valutore dhe treguesit sasiorë, si dhe ndjek, përmes raportimeve periodike, vënien në zbatim të politikës së investimit. Emrat e lejuar në të cilët investohet rezerva valutore përfshijnë qeveritë e SHBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe Eurozonës, të cilat përgjithësisht janë të renditura të paktën A- (për qeveritë e Eurozonës renditja minimale e pranuar është BBB³³). Në emrat e lejuar për investim përfshihen dhe agjenci apo institucione të lidhura me qeveritë, institucione shumëpalëshe apo të tjera subjekte të renditura të paktën AA- (për banka/institucione të tjera financiare renditja minimale e pranuar A-).

Në fund të dhjetorit 2024, stoku i rezervës valutore bruto prej 6,268.01 milionë eurosh përfshin edhe arin monetar prej 108.59 mijë onz ose 3.38 ton.

³³ Emrat/instrumentet e renditura deri në BBB- përfshihen në kategorinë “Për investim” (investment grade).




PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS MONEDHAVE

Në fund të vitit 2024, përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto është: Usd 19.5%, Eur 63.8%, Gbp 2.5%, Jpy 2.2%, Rmb 2.8%, Aud 0.8%, Sdr 4.2% dhe Ar monetar 4.4%. Në funksion të mbajtjes si referencë për një pjesë të rezervës përbërjen e shportës së Sdr-së, pesha e monedhës Rmb shpërndahet në dy monedha, Rmb dhe Aud, sipas një raporti që miratohet në vijimësi nga Komiteti i Investimit.

Grafiku i mëposhtëm tregon ecurinë e përbërjes sipas monedhave të rezervës valutore bruto, ku monedha Eur në vazhdimësi ka peshën kryesore në portofol.


Grafik 50. Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto



PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Rezerva valutore e administruar nga Banka e Shqipërisë është e investuar në aktive likuide, kryesisht me afat maturimi 1-3 vjet. Pësha e investuar në instrumente të borxhit me afat mbi 5 vjet rezulton me një rritje të lehtë gjatë këtij viti, duke përfaqësuar rreth 4.4% të portofolit të rezervës të investuar në tituj në mbyllje të vitit. Kohëzgjatja e investimit për një pjesë të rezervës u rrit në pasqyrim të pritjeve për rënie të normave të interesit. Rritja e ekspozimit në investime me afat maturimi deri në 3 muaj pasqyron rritjen e depozitave të vendosura kryesisht me banka qendrore. Në kushtet e rritjes të stokut të rezervës edhe pjesa e portofolit e investuar në instrumente të borxhit është rritur krahasuar me vitin paraardhës. Portofoli i administruar nga administratori i jashtëm (Banka Botërore) vijon të investohet kundrejt një portofoli referencë 1-3 vjet, kryesisht në instrumente borxhi të emetuara nga qeveri dhe agjenci qeveritare.

Grafik 51. Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të instrumenteve*, **




*Në grafik janë pasqyruar edhe depozitat e vendosura me bankat qendrore të cilat në fund të vitit nuk rezultojnë të shlyera. Në grafik nuk pasqyohen fondet e mbajtura në llogari rrjedhëse si dhe pjesa e rezervës në ar monetar dhe Sdr. Gjendja e llogarive rrjedhëse në fund të vitit është rreth 0.92 miliardë Eur.
**Në grafik nuk pasqyohen fondet e mbajtura në llogari rrjedhëse. Gjendja e llogarive rrjedhëse në fund të vitit është rreth 700 milionë Eur.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS RENDITJES DHE LLOJIT TË EMETUESVE/KUNDËRPALËVE


Në fund të vitit 2024, rreth 90% e portofolit të rezervës valutore rezulton e investuar me emra me renditje të cilësisë së lartë (klasa AAA dhe AA, duke përfshirë edhe ekspozimet në llogari rrjedhëse dhe Sdr)³⁴. Ekspozimet sipas llojit të emetuesit/kundërpalës përfaqësohen nga qeveri/banka qendrore (72%), ndjekur nga institucione shumëpalëshe (10.6%), banka/institucione të

³⁴ Ari monetar nuk përfshihet në këtë shpërndarje, pasi mbahet në ruajtje pranë Bankës së Anglisë.




tjera financiare (8.4%), agjenci (6.7%), institucione të garantuara nga qeveritë (1.6%) dhe autoritete qeveritare/organe publike (0.7%).

Grafik 52. Përbërja e portfolit të rezervës sipas vlerësimit (majtas) dhe kundërpalës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Kthimi i rezervës valutore



*Në llogaritjen e kthimit të rezervës nuk merret parasysh efekti i kursit të këmbimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

KTHIMI NGA INVESTIMI I PORTFOLIT TË REZERVËS


Kthimi absolut i rezervës në total për vitin 2024, përfshirë dhe fondin e administruar nga Banka Botërore, ka rezultuar pozitiv prej 2.91%. Kthimi i krijuar nga administrimi aktiv i portfolit të rezervës ka qenë pozitiv. Për efekt krahasimi, në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet ecuria e kthimit të portfolit të rezervës kundrejt kthimit të tregut.³⁵

Kthimi pozitiv i portfolit të rezervës ka qenë rezultat i niveleve të larta të normave të interesit në tregun ndërkombëtar gjatë vitit 2024. Megjithatë bankat qendrore kryesore filluan të ulin gradualisht normat bazë të interesit pas gjashtëmujorit të parë, niveli i përgjithshëm i tyre mbeti më i lartë në krahasim me dy vitet e mëparshme.

³⁵ Kthimi i tregut pasqyron ecurinë e agreguar të performancës së tregjeve në vendet e zhvilluara, sipas peshës që monedhat kryesore - Eur, Usd, Gbp, Jpy, Rmb dhe Aud - kanë në portfolin e rezervës valutore.



Grafik 54. Normat 2-vjecare të interesit për emetimet e qeverive me peshë të rëndësishme në portofolin e rezervës.



Burimi: Bloomberg.

ZHVILLIME TË TJERA NË KUADËR TË FUNKSIONIT TË ADMINISTRIMIT TË REZERVËS VALUTORE

Gjatë vitit 2024, ka vijuar bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore, në kuadër të marrëveshjes “Për Administrim dhe Konsulencë në Investimin e Rezervës Valutore” (RAMP). Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara. Këto kualifikime kanë synuar rritjen e shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore, të stafit që mbështet ose monitoron ecurinë e këtij procesi, si dhe të stafit të Bankës në përgjithësi.

Gjithashtu, është realizuar rinovimi apo shtyrja e afatit për disa marrëveshje që i shërbejnë Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e disponueshmërisë së likuiditetit të nevojshëm, me synim ruajtjen dhe mbështetjen e stabilitetit financiar të vendit. Kështu, afati i marrëveshjes ekzistuese për linjën e kreditit të kolateralizuar në shumën 400 milionë euro, nënshkruar me Bankën Qendrore Evropiane, është dakorduar për t’u shtyrë deri në janar 2027, ndërsa marrëveshja e bazuar në Repo me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, për shumën 500 milionë euro, u rinovua. Në mbështetje të nevojave për likuiditet është dhe marrëveshja në Swap me Bankën Popullore të Kinës, për shumën 2 miliardë Rmb.

Sa i takon infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, gjatë vitit 2024, u finalizua procesi për hartimin e termave të referencës (kërkesat dhe dokumentet shoqëruese) për marrjen e një sistemi të ri. Ky sistem do të mbështesë aktivitetet që kryhen nga Departamenti i Operacioneve Monetare – për qëllime të administrimit të rezervës valutore, zbatimit të politikës monetare – dhe nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës - për qëllime të shërbimit të pagesave dhe transfertave. Për hartimin dhe vlerësimin e kërkesave nga sistemi i ri në funksion të administrimit të rezervës valutore, Banka e Shqipërisë mbështetet në asistencën teknike të Bankës Botërore. Ndërkohë,



për adresimin e kërkesave të sistemit të ri për zbatimin e politikës monetare dhe shërbimin e pagesave dhe transfertave, u mundësua marrja e asistencës teknike nga Banka e Italisë, në kuadër të Programit Rajonal për Forcimin e Aftësive të Bankave Qendrore të Ballkanit Perëndimor.

HAPËSIRË INFORMUESE 7

FLUKSET QË NDIKUAN REZERVËN VALUTORE, GJATË VITIT 2024


Gjatë vitit 2024, rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën Euro, është rritur me 421 milionë euro, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 6,267.05 milionë euro. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën valutore bruto paraqiten të grupuara si më poshtë:

- **Veprimet e Ministrisë së Financave kanë pasur ndikim negativ në shumën 373.93 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm¹:**
 - hyrje nga grante dhe lëvrimi i huave të dhëna 265.35 milionë euro,
 - hyrje neto nga blerja e valutës nga Banka e Shqipërisë dhe interesa të fituara 108.13 milionë euro,
 - transfertat për shërbimin e borxhit dhe të tjera 747.41 milionë euro;
- **Veprimet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera kanë pasur ndikim negativ në shumën 327.71 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:**
 - derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyrueshme, administrimin e ekspozimeve në bilanc etj. në shumën 3,338.94 milionë euro,
 - transfertat nga bankat e nivelit të dytë, në shumën 3,669.62 milionë euro,
 - hyrje neto për llogari të subjekteve të tjera (ASD etj.), në shumën 2.97 milionë euro;
- **Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 896.55 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:**
 - blerje të valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera, në shumën 916.55 milionë euro:
 - o nga bankat e nivelit të dytë, në shumën 913.80 milionë euro²,
 - o nga institucione të tjera, në shumën 2.75 milionë euro,
 - shitje neto të valutës Ministrisë së Financave, në shumën 102.74 milionë euro,
 - hyrje nga interesa, kuponë etj. (të llogaritura në bazë paraje fizike) të krijuara nga investimi i rezervës valutore, në shumën 93.45 milionë euro,
 - transfertat në shumën 10.71 milionë euro;
- **Faktorët e tregut kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 226.09 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:**
 - luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar në mënyrë pozitive vlerën e rezervës bruto të raportuar në Euro, me 157.08 milionë euro,



- **efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit, llogaritet në një vlerë pozitive, rreth 69.01 milionë euro³.**

1. Vëllimi total i veprimeve swap të realizuara me Ministrinë e Financave për vitin 2024 është 480 milionë euro, ndërsa efekti neto i veprimeve është neutral.
2. Këtu nuk përfshihet efekti neto i blerjeve forward për vitin në shumën 19 milionë Eur.
3. Kjo vlerë ka në përmbajtje dhe efektin e krijuar nga derdhja e kuponëve të titujve dhe është e korigjuar për veprimet e blerjes/shitjes/maturimit të titujve në baza paraje fizike.



2.9. STATISTIKAT

Në përputhje me përcaktimet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Programin Zyrtar të Statistikave, si dhe Ligjin për Statistikat Zyrtare, funksioni statistikor në Bankën e Shqipërisë synon nxjerrjen e statistikave të paanshme, objektive dhe të besueshme, në shërbim dhe në përmbushje të objektivave ligjorë të Bankës, si bankë qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe si agjenci statistikore brenda Sistemit Kombëtar Statistikor.

Gjatë vitit 2024, funksioni statistikor i Bankës së Shqipërisë është formësuar në kontekstin e integritimit evropian dhe adaptimit të Standardeve Ndërkombëtare.

Statistikat e prodhuara nga Banka e Shqipërisë – statistikave monetare dhe financiare, dhe ato të sektorit të jashtëm të ekonomisë³⁶ – shërbejnë për të monitoruar dhe analizuar zhvillimet ekonomike dhe financiare, duke ofruar një informacion të besueshëm për hartimin e politikave monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Ato ndihmojnë institucionet vendimmarrëse, tregjet financiare dhe publikun e gjerë të marrin vendime të informuara, si dhe sigurojnë transparencë dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka vijuar përpjekjet për të rritur cilësinë, granularitetin dhe përputhshmërinë e të dhënave me standardet më të larta ndërkombëtare.

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka sjellë një sërë sfidash dhe detyrimesh për përafrimin e sistemit tonë statistikor me atë evropian, përfshirë Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Banka e Shqipërisë luan një rol kyç në këtë proces, përmes prodhimit të statistikave financiare dhe makroekonomike thelbësore për përmbushjen e detyrimeve ndaj Eurostat dhe SEBQ-së, si dhe përmes zhvillimit të një infrastrukture moderne të teknologjisë së informacionit. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar bashkëpunimin me Bankën e Italisë (Bdl) për modernizimin e infrastrukturës për përpunimin e statistikave, analizën dhe raportimin konform standardeve teknike që ndjek çdo bankë qendrore në vendet anëtare. Njëkohësisht, janë nisur një sërë projektsh të reja të fokusuara në plotësimin e boshllëqeve statistikore, forcimin e kapaciteteve analitike dhe aplikimin e metodologjive të avancuara për përpunimin dhe interpretimin e statistikave financiare.

Gjatë vitit 2024, institucionet ndërkombëtare si FMN-ja dhe Kombet e Bashkuara, kanë nisur procesin e rishikimit të dy manualeve metodologjike kryesore: Sistemi i Llogarive Kombëtare dhe Manuali i Bilancit të Pagesave (BPM7), në përgjigje të sfidave të digjitalizimit, ndryshimeve klimaterike dhe

³⁶ Tërësia e statistikave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë, shoqëruar edhe me metodologjinë përkatëse, gjenden në faqen zyrtare të internetit të bankës, në seksionin Statistikat



zhvillimit të Fintech. Përshtatja me këto ndryshime metodologjike është një prioritet për Bankën e Shqipërisë. Ajo ka marrë pjesë aktive në konsultimet ndërkombëtare për FMN/BPM7 dhe ka përgatitur një plan veprimi për zbatimin e tij, duke synuar harmonizimin e plotë të statistikave të bilancit të pagesave dhe të pozitës ndërkombëtare të investimeve.

Angazhimi i Bankës së Shqipërisë mbetet i palëkundur: prodhimi i statistikave cilësore, të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, që mbështesin vendimmarrjen e informuar dhe lehtësojnë integrimin e Shqipërisë në sistemin evropian të statistikave. Përmes investimeve të vazhdueshme në metodologji të avancuara, transformim digjital dhe bashkëpunim ndërkombëtar, synojmë jo vetëm të përmbushim kërkesat aktuale, por edhe të ndërtojmë një sistem statistikor fleksibël dhe të përshtatshëm ndaj sfidave të së ardhmes.

Gjatë vitit 2024, në funksion të përafrimit metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas acquis communautaire, janë realizuar:

1. Raportimi pranë Eurostat për raportet e cilësisë për statistikave të bilancit të pagesave/statistikave të pozicionit ndërkombëtar të investimeve, treguesve financiarë dhe monetarë, si dhe llogarive financiare

Implementimi i kërkesave për cilësinë e të dhënave vjen në përputhje me angazhimin publik për harmonizimin me standardet e cilësisë dhe strukturën e Statistikave Evropiane nga SEBQ-ja, konform përmbajtjes së sugjeruar dhe standardit të BQE/EUROSTAT. Gjatë vitit 2024, është rritur ndjeshëm detajimi i të dhënave të transmetuara në Eurostat për statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve dhe për raportimin e llogarive financiare në drejtim të raportimit të transaksioneve ndërsektoriale. Këto të fundit, mundësojnë analiza më të thelluara të ndërveprimeve financiare midis sektorëve të ndryshëm ekonomikë.

Eurostat-i i ka vlerësuar statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve në nivel të plotë përafrimi teknik me acquis të BE-së, ndërkohë statistikave të investimeve të huaja direkte vazhdojnë të vlerësohen në nivel të lartë përafrimi.

2. Automatizimi i raportimit të statistikave të sektorit të jashtëm ka vijuar me integrimin e sistemeve të validimit automatik të Eurostat-it (STRUVAL dhe CONVAL), duke reduktuar ngarkesën manuale dhe duke rritur efikasitetin e transmetimit të të dhënave përmes platformës EDAMIS

Implementimi i këtyre metodave të avancuara të kontrollit të cilësisë është një kontribut drejt përfshirjes së plotë të Shqipërisë në sistemin statistikor të BE-së, në mënyrë të qëndrueshme dhe pa pengesa metodologjike ose teknike.

3. Projekti IPA2022 mbi statistikave të Investimeve të Huaja Direkte



Gjatë vitit 2024 u iniciua një projekt i ri i mbështetur nga IPA2022, me synimin për përafrimin e plotë me acquis të të gjithë gamës së raportimit të investimeve të huaja sipas rregullores së Komisionit Evropian³⁷.

4. Përmirësimi i statistikave të financave të qeverisë dhe mbikëqyrjes fiskale ka qenë një tjetër objektivi kryesor gjatë vitit 2024

Në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Ministrinë e Financave, Banka e Shqipërisë ka vijuar përpjekjet për të forcuar prodhimin dhe raportimin e të dhënave në kuadër të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP), i cili është një element thelbësor për qeverisjen fiskale në BE. Po ashtu, është zgjeruar mbulimi i llogarive financiare tremujore për sektorin e qeverisë – duke siguruar përputhshmëri të plotë me ESA 2010 – dhe janë vendosur mekanizma të rinj për sigurimin e cilësisë së të dhënave.

5. Banka e Shqipërisë ka forcuar përpjekjet për harmonizimin e llogarive financiare tremujore për sektorin e qeverisë dhe sektorët institucionalë me kërkesat e Eurostat-it, duke rritur përputhshmërinë me standardet e ESA 2010

Ky proces është duke u zhvilluar në bashkëpunim me SECO dhe Graduate Institute of Geneva, dhe synon forcimin e kapaciteteve metodologjike dhe përmirësimin e konsistencës së të dhënave.

6. Në cilësinë e anëtarit të Komitetit për të Dhënat Statistikore në Turizëm, Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në forcimin e bazës analitike dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave mbi turizmin

Banka e Shqipërisë mbështet Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në angazhimin dhe vizionin për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit. Ky dokument përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë së sektorit të turizmit, duke krijuar një qasje të mirëstrukturuar për rritjen ekonomike dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik konkurrues.

7. Funkzioni statistikor i BSH-së do të përshtatet gjithashtu me kërkesat e BE-së për financat e gjelbra dhe matjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike në sektorin financiar

Një zhvillim kyç ka qenë integrimi i regjestrave të stabilitetit financiar në statistikat monetare, me një theks të veçantë në vlerësimin e rreziqeve financiare të lidhura me ndryshimet klimatike dhe financat e gjelbra. Për herë të parë, u zhvilluar një kornizë analitike për të vlerësuar ekspozimin e sektorit financiar shqiptar ndaj rreziqeve mjedisore, duke përmbushur objektivat ndërkombëtare për transparencën e financave të qëndrueshme.

³⁷ Rregullore e Komisionit (KE) Nr. 555/2012, e ndryshuar, kërkon që shtetet anëtare të BE-së të raportojnë në EUROSTAT të dhëna mbi Investimeve të Huaja një herë në vit.



8. Hartimi dhe raportimi i të dhënave të Pyetësorit mbi Aksesin dhe Përdorimin e Shërbimeve Financiare

Projekti FAS pilot (Financial Access Survey) synon të përmirësojë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave rreth aksesit të shërbimeve financiare. Një nga qëllimet kryesore të këtij projekti është zgjerimi i gamës së informacionit me të dhëna më të detajuara dhe të strukturuar – për individët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme – që ndihmojnë në hartimin e një analize më të thellë të përdorimit të shërbimeve financiare. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të identifikuar grupet e nevojshme për mbështetje dhe për të ushtruar politika më efektive për përmirësimin e aksesit në financë dhe të përdorimit të shërbimeve financiare.

9. Plotësimi i kuadrit të Treguesve të Shëndetit Financiar dhe implementimi i ndryshimeve që parashikon Guida e re e FSI (FMN, 2019), duke rritur fokusin në stabilitetin e sistemit financiar


Zbatimi i kërkesave të reja ka sjellë hartimin dhe raportimin e treguesve të rinj që plotësojnë kuadrin e vlerësimit të shëndetit të sektorit financiar, veçanërisht për institucionet e tjera financiare, korporatat jofinanciare, individët dhe tregjet e pasurive të paluajtshme.

10. Harmonizimi me standardet ndërkombëtare të raportimit rregullator për mbikëqyrjen bankare

Në funksion të përshtatjes me kërkesat rregullatore të BE-së për mbikëqyrjen bankare, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për zbatimin e paketës së raportimit të Autoritetit Bankar Evropian (EBA), duke siguruar harmonizimin e kuadrit rregullator të Shqipërisë me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS). Një hap kyç në këtë proces ka qenë zhvillimi i tabelave urë, të cilat shërbejnë si instrument për të lidhur kornizën aktuale të raportimit me kërkesat e raportimit të standardizuar financiar të bankave (FINREP), sipas standardit të EBA-së.

Përtej përshtatjes metodologjike, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një konsultim të strukturuar me sektorin bankar për të identifikuar boshllëqet dhe për të vlerësuar gatishmërinë e bankave për zbatimin e raportimit të ri. Përmes këtij procesi, janë mbledhur të dhëna të rëndësishme mbi kapacitetet teknologjike të bankave, nevojën për përmirësime në sistemet e tyre dhe sfidat që ato hasin në përshtatjen me standardet e reja të raportimit.

Banka e Shqipërisë ka caktuar një afat të qartë për transmetimin e parë të të dhënave FINREP, duke u dhënë bankave kohë për përshtatjen e sistemeve të tyre. Njëkohësisht, janë forcuar kapacitetet e brendshme për administrimin e këtyre raporteve, përmes bashkëpunimit me banka homologe në BE dhe investimit në një platformë të avancuar për përpunimin e të dhënave sipas kërkesave të EBA-së dhe BQE-së.



2.10. PUNA KËRKIMORE

Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin e saj vendimmarrës në themele të forta dijesh dhe njohurish mbi ekonominë shqiptare. Investimi në krijimin e kapaciteteve të shëndosha kërkimore ndihmon në rritjen cilësore të punës, të reputacionit dhe të besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë, si një institucion që zotëron metodologjitë përkatëse dhe njohuritë e nevojshme për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Për këto arsye, zhvillimi aktiv i kërkimit shkencor zë një vend parësor në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

Hulumtimi shkencor në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2024 është orientuar përgjithësisht drejt analizave të fenomeneve ekonomike e financiare, në funksion të politikës monetare e të stabilitetit financiar. Përpyekjet e tjera kërkimore u përqendruan drejt çështjeve të rëndësishme siç janë: financa e gjelbër dhe sfidat e sistemit bankar në përballimin e rreziqeve të papritura natyrore; përmirësimi i edukimit dhe i përfshirjes financiare në vend; si dhe çështjet mbi ekonomiksën ndërkombëtare dhe të zhvillimit.

Në përputhje me strategjinë afatmesme të kërkimit shkencor, hulumtimi shkencor në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2024, mbështeti procesin vendimmarrës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të statistikave të nevojshme dhe pasurimit të portofolit të modeleve ekonometrike, duke shfrytëzuar mjetet dhe teknikat e reja kompjuterike që ofron inteligjenca artificiale.

Projektet në funksion të vendimmarrjes së politikës monetare dhe të stabilitetit financiar kanë vazhduar t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë analizave mbi sfidat ekonomike që sjellin ndryshimet klimatike. Studimet janë përqendruar në ndikimin makro-financiar të këtyre ndryshimeve në Shqipëri, me fokus në vendosjen e taksave të karbonit dhe efektet e tyre socio-ekonomike. Në këtë kuadër, janë vlerësuar skenarët e tranzicionit klimatik, duke krahasuar një qasje graduale me një zbatim të papritur të këtyre politikave.

Banka e Shqipërisë ka intensifikuar bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e strategjisë së gjelbër, duke publikuar Progres-Raportin Vjetor mbi arritjet dhe sfidat e menaxhimit të rreziqeve klimatike dhe Raportin e Vlerësimit të Ekspozimit të Sektorit Bankar ndaj Rreziqeve Klimatike (2024). Ky i fundit është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë së sektorit financiar dhe përafrimit të tij me standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.



Projektet kërkimore në kuadër të politikës monetare u përqendruan në ndikimin e strukturës së parasë bazë dhe reagimin e çmimeve, si dhe në rolin e rezervës valutore në stabilizimin e kursit të këmbimit. Një material studimor i fokusuar tek ecuria e kursit të këmbimit në vendet e Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore gjen se niveli i rezervave ndërkombëtare mund të luajë një rol kyç në stabilizimin e kursit të këmbimit, veçanërisht në vendet me sisteme financiare më pak të zhvilluara.

Në vazhdimësi, Banka e Shqipërisë i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të komunikimit me publikun dhe sfidave që sjellin edukimi dhe përfshirja financiare e individëve për eficiencën e transmetimit të politikës monetare. Në këtë kontekst, është realizuar një studim me synim vlerësimin e "sentimentit" në raportet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Ai është analizuar përmes metodës "Web scrapping", duke u fokusuar në termat "shtrëngues" dhe "lehtësues", për të krijuar një indeks që tregon periudhat kur njëra nga këto terminologji mbizotëron.


Përpjekjet kërkimore për stabilitetin financiar u përqendruan në ndikimin e çmimeve të banesave në qëndrueshmërinë ekonomike dhe në ndikimin e inteligjencës artificiale (IA) në bankat tregtare. Zhvillimet e shpejta në IA kërkojnë që bankat të përshtatin strategjitë e menaxhimit dhe autoritetet të ndërmarrin masa rregullatore për të balancuar inovacionin dhe sigurinë në sektorin financiar. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë hartoi një pyetësor me synim mbledhjen e informacionit mbi përfitimet dhe sfidat potenciale nga adoptimi i inovacioneve teknologjike.

Projektet e tjera kërkimore kanë pasur në fokus ekonomiksin ndërkombëtar dhe zhvillimin. Në këtë drejtim janë realizuara dy analiza empirike për vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat tregojnë se globalizimi i tregtisë dhe shkëmbimi i mallrave dhe teknologjive me ndikim mjedisor mundësojnë rritje ekonomike dhe produktivitet, pavarësisht rreziqeve nga ndryshimet klimatike. Ato gjithashtu theksojnë se goditjet negative si kriza financiare, COVID-19, dhe tensionet gjeopolitike, kanë shtyrë Ballkanin Perëndimor të thellojë shkëmbimet tregtare me partnerët e tjerë, veçanërisht në sektorët që ndikojnë në klimë. Hulumtimi mbi reformën monetare të vitit 1965 zbulon se implementimi i saj ka ndodhur në një periudhë të rëndësishme për ekonominë. Studimi sugjeron se reforma monetare në Shqipëri mund të jetë nxitur nga faktorë të jashtëm, përveç atyre të brendshëm, dhe kjo mund të ketë kontribuar në keqkuptimin e saj nga popullata.

Këto dhe studime të tjera kanë qenë objekt diskutimi në aktivitetet dhe konferencat e organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë organizoi "Takimin e 18të Rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore", në datat 19-20 nëntor 2024. Ky aktivitet kërkimor shkencor shërben si një forum diskutimi për punimet kërkimore mbi çështjet aktuale ekonomike dhe financiare, dhe nxit shkëmbimin e pikëpamjeve midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë, bankierëve qendrorë, komunitetit akademik, në rajon dhe më gjerë.



Në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, nën kategorinë “Botime/Botime kërkimore” gjendet informacion më i detajuar dhe i plotë mbi të gjitha punët kërkimore të Bankës së Shqipërisë. Punë të tjera kërkimore publikohen në formën e artikujve në Revistën Ekonomike të Bankës së Shqipërisë. Revista me frekuencë gjashtë mujore “Të rehat shkencore në Bankën e Shqipërisë” ka për qëllim informimin në lidhje me materialet studimore të sapo përfunduara apo ato në proces, materialet e prezantuara në aktivitetin “Seminaret e së Premtes” apo në aktivitete të tjera të organizuara nga Banka e Shqipërisë.



2.11. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Banka e Shqipërisë ka vijuar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga hapja e procesit të negociatave për anëtarësim në BE, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raport-Progreset e Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo është kryesuese në dy Grupet Ndërinstitucionale të Punës të Integritimit Evropian për 2 kapituj të acquis dhe ka një kontribut të qenësishëm në 6 kapituj të tjerë.

Banka e Shqipërisë ka mbështetur në vazhdimësi procesin e integritimit evropian, duke përfshirë angazhimet dhe pjesëmarrjet aktive në grupet ndërinstitucionale dhe në hartimin e dokumenteve strategjike që mbështesin procesin e përafrimit të legjislacionit dhe politikave.

Gjatë vitit 2024, puna në këtë drejtim u fokusua në përgatitjen e pozicioneve negociuese, si një hap që pasoi publikimin e Raporteve Screening nga pala evropiane për çdo kapitull. Banka e Shqipërisë si institucion lider për kapitullin 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit dhe kapitullin 17 – Politikat Ekonomike dhe Monetare, ka qenë maksimalisht e angazhuar në përgatitjen me sukses të pozicioneve negociuese për këta kapituj. Ajo ka pasur rol lideri në koordinimin e punës me institucionet kontribuuese në këta kapituj, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve ndërinstitucionale të punës së integritimit evropian dhe nëpërmjet bashkëpunimit me Zyrën e Kryenegociatorit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka kontribuar në përgatitjen e pozicioneve negociuese për kapitujt e tjerë si Kapitulli 9 – Shërbimet Financiare, Kapitulli i Kriterit Ekonomik, Kapitulli 32 – Kontrolli Financiar dhe Kapitulli 18 – Statistikat, Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit. Në pozicionet negociuese shprehet qartë angazhimi i institucioneve shqiptare në drejtim të përfundimit të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe arritjen e standardeve evropiane në çdo fushë të përfshirë brenda vitit 2027, si ambicie për mbylljen e negociatave të anëtarësimit në tërësi.

Banka e Shqipërisë u përfaqësua në takimet vjetore të nivelit të lartë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, përkatësisht në takimet e dy Nënkomiteteve: 1) Tregu i brendshëm dhe Konkurrenca, dhe 2) Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat; si dhe në Dialogun Ekonomik dhe Financiar midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Në takimet e mësipërme u diskutua në nivel politik dhe teknik mbi çështje si: zbatimi i politikës monetare, stabiliteti financiar, treguesit dhe zhvillimet e sektorit bankar, përfshirja financiare e popullatës etj.

Në tetor 2024, Komisioni Evropian dorëzoi pranë autoriteteve shqiptare Raportin e Progresit 2024, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria



gjatë vitit. Në Kapitullin 4, Shqipëria vlerësohet mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Në të njëjtën kohë, vlerësohet të jetë bërë progres në përafrimin me acquis të BE-së për pagesat dhe në veprimet e ndërmarra që mundësuan heqjen e Shqipërisë nga "lista gri" e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Në Kapitullin 17, Shqipëria ndodhet midis një niveli të moderuar dhe të mirë përgatitjeje në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, duke bërë progres falë ruajtjes së stabilitetit të çmimeve nga Banka e Shqipërisë dhe respektimit të rregullit fiskal.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E HUAJA

Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e huaja në kuadër të angazhimeve institucionale, duke shkëmbyer analiza dhe opinione, të cilat kanë përmirësuar bashkërendimin e politikave makroekonomike dhe ekspertizën profesionale.

MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Marrëdhëniet e Shqipërisë me FMN-në vijojnë të përqendrohen nën konsultimet e Artikullit IV. Më 17 janar 2025, Bordi Ekzekutiv i FMN-së përbylli konsultimet për Artikullin IV me Shqipërinë, në përfundim të të cilit publikoi vlerësimet pozitive mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare dhe politikat ekonomike publike të ndjekura, si dhe bëri rekomandimet përkatëse.

Republika e Shqipërisë vazhdon të qëndrojë në kuotën e 139.3 milionë SDR (0.03 % e totalit) dhe zotëron 2.858 vota ose 0.06% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së. Ajo ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon. Blerjet dhe huatë e papaguara në 31 dhjetor 2024 qëndrojnë në 96.18 milionë SDR.³⁸

MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Grupi i Bankës Botërore ka filluar punën në Shqipëri në vitin 1991 dhe ka mbështetur një sërë projektesh, duke synuar zbutjen e varfërisë dhe sigurimin e mjeteve të qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë të vendit. Shqipëria bën pjesë në konstituencën e përbërë nga Greqia, Italia, Portugalia, Malta dhe Timori Lindor.

Totali i kredive të ofruar nga Grupi i Bankës Botërore është 520 milionë USD, kurse ai i granteve 1.6 milionë USD³⁹.

Bashkëpunimi me Bankën Botërore është intensifikuar në fushën e pagesave, mbikëqyrjes financiare, ndërhyrjes së jashtëzakonshme, statistikave, sigurisë kibernetike, edukimit dhe përfshirjes financiare etj.

³⁸ Informacion i përftuar nga faqja zyrtare e internetit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë.

³⁹ Informacion i përftuar nga faqja zyrtare e internetit të Grupit të Bankës Botërore për Shqipërinë, përditësuar në tetor 2024.



BASHKËPUNIMI TEKNIK


Gjatë vitit 2024 ka vazhduar zbatimi i fazës së dytë të programit “Forcimi i kapaciteteve të bankave qendrore të vendeve kandidatë dhe kandidatëve të mundshëm për anëtarë të BE-së nga Ballkani Perëndimor” të financuar nga BE-ja.

Ky program mbështet bankat qendrore dhe agjencitë e mbikëqyrjes bankare në vendet kandidatë të BE-së dhe kandidatët potencialë të Ballkanit Perëndimor. Ai synon forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve përfituese, kryesisht përmes përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të tyre analitike dhe politike, si dhe nëpërmjet përvetësimit të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në praktikat kombëtare. Programi mbështetet nga Bashkimi Evropian (BE) nëpërmjet Instrumentit të tij për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III).

Gjatë vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Bankat Qendrore Evropiane, si dhe ka përfituar nga ekspertiza e ekspertëve në fushat e: politikës monetare; stabilitetit financiar; mbrojtjes së konsumatorit; përfshirjes financiare dhe edukimit financiar; sistemeve të pagesave; statistikave; integritetit evropian dhe aspekteve ligjore; dhe kontabilitetit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Rumanisë, në kuadër të zbatimit të masave dypalëshe në fushat e kontabilitetit, menaxhimit të rezervës dhe burimeve njerëzore.


AKTIVITETE TË TJERA DHE PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 2024

- Në datat 16-17 janar, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në punimet e Forumit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) – një aktivitet i përvitshëm i “Euromoney” që mbledh së bashku figura të njohura të fushës akademike, ekonomike e financiare nga vendet e EQL-së – për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit ekonomike, kryesisht në rajonin lindor dhe juglindor të kontinentit.
- Në datën 16 shkurt, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u organizua për herë të parë në Shqipëri Mbledhja e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe BB-së. Ky takim, i organizuar nën kujdesin e Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, mbledhi së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të kësaj konstituence.
- Në datën 13 mars, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, kreu një vizitë zyrtare pranë Bankës së Italisë, në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy bankave qendrore dhe zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit teknik në fusha të ndryshme. Gjatë vizitës, Guvernatori Sejko u prit nga Guvernatori i Bankës së Italisë, z. Fabio Panetta, si dhe zhvilloi takime të rëndësishme me drejtues të tjerë të këtij institucioni.
- Në datat 18-21 prill, u zhvilluan Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB),



në Uashington, ku mori pjesë dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Në këto mbledhje marrin pjesë ministrat e financave të vendeve anëtare, guvernatorë të bankave qendrore, drejtues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të botës akademike, biznesit dhe shoqërisë civile.

- Në datën 1 tetor, Guvernatori Sejko mori pjesë në Konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut dhe Komiteti Bretton Woods, me temë “Bankat qendrore dhe bankingu qendror në një botë shumë komplekse: Demonstrimi i përkushtimit dhe ruajtja e besueshmërisë”, të organizuar në Shkup, Maqedoni e Veriut.
- Në datat 24-27 tetor, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), të zhvilluara në Uashington DC, SHBA.
- Në datën 15 nëntor, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë me temë “Kapërcimi i kufijve, ndërtimi i së ardhmes: Integrimi në SEPA rrit përfshirjen financiare, duke mundësuar rritje ekonomike të qëndrueshme”, të organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me rastin e 25-vjetorit të themelimit të saj. Në këtë konferencë morën pjesë guvernatorë të bankave qendrore e drejtues të lartë të autoriteteve mbikëqyrëse të rajonit, si edhe përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare.



2.12. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si në përbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes, ashtu dhe në funksion të rritjes së efektivitetit të saj, nëpërmjet forcimit të besueshmërisë së institucionit në publik. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e vlerëson komunikimin ndëreveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinionin publik, sa më drejt dhe kuptueshëm, aktivitetet e saj.

NJË BANKË QENDRORE E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Përtej detyrimeve ligjore, Banka e Shqipërisë i komunikon publikut një informacion të shumëllojshëm lidhur me rolin dhe veprimtarinë e saj, nga vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës deri tek aktiviteti operacional i përditshëm. Ky komunikim transparent, i cili kalon përmes një sërë kanalesh komunikimi, ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikave të ndjekura nga Banka e Shqipërisë, duke bërë që publiku të kuptojë drejt vendimet e marra prej saj.

Gjatë vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka vazhduar publikimin e rregullt të raporteve periodike, vrojtimeve, analizave, vlerësimeve dhe opinioneve mbi gjendjen makroekonomike të vendit e të sistemit financiar, si dhe rolin e Bankës në mbështetje të këtyre të fundit. Në këtë kuadër, 8 vendimmarrjet e politikës monetare janë shoqëruar me konferenca për shtyp të Guvernatorit, të cilat i kanë shpjeguar publikut arsyet pas vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës. Çdo konferencë është pasuar nga publikimi i fjalimit të Guvernatorit dhe zbardhja e pyetje-përgjigjeve përkatëse.

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës janë publikuar përmbledhje me vendimet kryesore. Të gjitha vendimet publike të Këshillit Mbikëqyrës, urdhrat dhe aktet e administratorëve, të zbatueshme nga subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë u botuan të plota në Buletinin Zyrtar, në 9 numra të këtij botimi.

Komunikimi i drejtpërdrejtë i Bankës së Shqipërisë me median ka vijuar edhe gjatë vitit 2024, përmes konferencave për shtyp, fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave në aktivitete të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo nga institucione të tjera, të intervistave të dedikuara, të pjesëmarrjes në emisione televizive, të shprehjes së qëndrimeve me interes për publikun apo të aktiviteteve të tjera të Guvernatorit dhe të përfaqësuesve të tjerë të Bankës. Këto formate komunikimi numërojnë 134 fjalime, njoftime e deklarata për shtyp, 111 intervista dhe pjesëmarrje në emisione televizive, si dhe 7 prezantime "off the record" të raporteve periodike.



Në një botë ku informacioni qarkullon me shpejtësi dhe platformat digjitale po kthehen në burime kryesore të komunikimit, Banka e Shqipërisë ka rritur ndërveprimin me publikun nëpërmjet pranisë së saj në LinkedIn, X, Facebook, YouTube, Flickr dhe së fundmi në Instagram.

HAPËSIRË INFORMUESE 8

AKTIVITETE BRENDA VENDIT, TË ORGANIZUARA GJATË VITIT 2024

- Në datat 8-9 shkurt, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore organizuan Workshop-in "Modernizimi i sistemeve të pagesave në Shqipëri", me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare. Zëvendësguvernatorja e Parë, zj. Minxhozi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë dhe prioritetet e BSH-së, për zbatimin e ligjit "Për shërbimet e pagesave" (PSD2), integrimin në SEPA dhe zhvillimin e pagesave të shpejta.
- Në datën 16 shkurt, Banka e Shqipërisë organizoi për herë të parë në Shqipëri, Mbledhjen e Konstituencës së FMN-së dhe BB-së që mbledh së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të saj. Mbledhja u fokusua në sfidat ekonomike dhe përjasjet e koordinuara për zhvillim.
- Në datën 28 shkurt, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, organizoi Ministerialin "Ballkani Perëndimor drejt Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA)". Në Ministerial u mbledhën Ministrat e Financave dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe morën pjesë përfaqësues të Komisionit Evropian, Bankës Botërore dhe BERZH-it. Guvernatori Sejko theksoi rëndësinë e integritimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor me BE-në, veçanërisht përmes sistemeve të pagesave dhe anëtarësimit në SEPA.
- Në datën 28 mars, Guvernatori Sejko mirëpriti në një vizitë zyrtare Guvernatorin e Bankës Kombëtare të Kroacisë (BKK), z. Boris Vujčić. Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe midis dy bankave qendrore.
- Më 14 qershor, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizoi Workshop-in "Rrugëtimi i Shqipërisë drejt integritimit në SEPA, përfshirjes dhe edukimit financiar". Ky aktivitet pati në fokus progresin e integritimit të Shqipërisë në SEPA, përfitimet e tij dhe rëndësinë e përfshirjes dhe edukimit financiar në zhvillimin e tregut dhe mirëqenien shoqërore.
- Më 11 korrik, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën mbi Ekspertizën e Tranzicionit Ekonomik në LSE organizuan Workshopin "Navigimi i Rreziqeve të Ndërlidhura: Ndikimet e Degradimit Mjedisor dhe Ndryshimeve Klimatike". Ky aktivitet mbledhi në një tryezë të përbashkët përfaqësues nga institucione kyçe publike dhe private në Shqipëri, ekspertë të shquar kombëtarë dhe ndërkombëtarë, politikëbërës dhe ekonomistë, me qëllim kryesor përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në një dialog mbi sfidat që paraqiten nga ndryshimi i klimës dhe implikimet e saj në ekonomi dhe financa.
- Më 7 tetor, Guvernatori Sejko mirëpriti në një vizitë zyrtare Guvernatorin e Bankës Kombëtare të Austrisë, z. Robert Holzmann. Kjo vizitë shënoi një hap përpara për forcimin e bashkëpunimit dypalësh midis dy bankave qendrore.
- Në datën 13 nëntor, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën



Shqiptare të Bankave organizuan konferencën vjetore me temë: “Roli i bankës qendrore dhe sistemit bankar në rrugën drejt BE-së”. Në veçanti, në “Panelin e Guvernatorëve” u diskutuan strategjitë institucionale dhe perspektivat e bankave të rajonit në lidhje me stabilitetin e çmimeve, vështirësitë e hasura nga bankat qendrore dhe sistemi bankar, si dhe mundësitë e sfidat që paraqet procesi i konvergencës me BE-në.

- Në datat 19-20 nëntor, Banka e Shqipërisë organizoi Workshop-in e 18-të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Në këtë Workshop u prezantuan 25 materiale studimore nga autorë të Bankës së Shqipërisë, kërkues nga banka qendrore dhe universitete ndërkombëtare si ato të Austrisë, Italisë dhe Turqisë.
- Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave zhvilloi mbledhjen e tij të dhjetë në datën 5 dhjetor, nën drejtimin e Kryetares së tij, zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë. Aktiviteti u hap me fjalën përshëndetëse të Guvernatorit Sejko, i cili u shpreh se dhjetëvjeçari i fundit ka shënuar një revolucion në fushën e pagesave për tregun shqiptar, duke e transformuar rrënjësisht atë në çdo aspekt. Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë e ka udhëhequr këtë transformim, duke u treguar proaktive ndaj ndryshimeve teknologjike në ambientin ndërkombëtar të pagesave dhe duke e drejtuar tregun drejt adoptimit të kontrolluar të këtyre ndryshimeve.
- Në datën 16 dhjetor, me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë, analistë të politikës dhe të ekonomisë, gazetarë të shtypit të shkruar e medias elektronike. Gjatë këtij aktiviteti, u ndanë dhe tre çmimet e konkursit të përvitshëm “Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë për vitin 2024”.

NJË BANKË QENDRORE E PËRGJEGJSHME DHE LLOGARIDHËNËSE

Si një institucion i pavarur, BSH-ja synon të informojë qytetarët dhe në veçanti Kuvendin e Shqipërisë mbi gjithë veprimtarinë e saj.

Marrëdhëniet institucionale me Kuvendin e Shqipërisë zhvillohen në disa drejtime, ku vendin më të rëndësishëm e zënë seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave (KEF) dhe në seancat plenare të Kuvendit. Në muajin maj 2024, Guvernatori prezantoi Raportin Vjetor të BSH-së për vitin 2023 në KEF dhe më pas në muajin korrik, në Kuvendin e Shqipërisë, duke iu përgjigjur sipas rastit edhe interesit të deputetëve për çështje të veçanta të lidhura me të. Si çdo vit, Banka e Shqipërisë ka prezantuar në muajin nëntor 2024 në një seancë dëgjimore të dedikuar të KEF-it edhe opinionin e BSH-së për pikat kryesore të projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës 2025.

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar dhe 3 seanca dëgjimore në Komisione të ndryshme Parlamentare, ku Guvernatori Sejko ka prezantuar opinionin e Bankës së Shqipërisë lidhur me çështje të tilla si subjektet financiare jobanka (maj), përgatitjen e institucioneve shqiptare lidhur me Tregun Unik të Pagesave në Euro – SEPA (korrik), dezinformimin dhe ndikimin në sistemin financiar (tetor).



Qytetarët mund të gjejnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe zhvillimet kryesore makroekonomike të vendit, si dhe rolin e kontributin e BSH-së në këtë drejtim, në faqen zyrtare të internetit: www.bankofalbania.org. Gjatë vitit 2024, BSH-ja vijoi me përditësimin e rregullt të faqes së internetit, e cila pati rreth 2.2 milionë vizitorë, të cilët shfletuan rreth 8.4 milionë faqe.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2024 – si periodike dhe joperiodike – numërojnë rreth 3000 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Seti i raporteve periodike edhe gjatë këtij viti ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor (vjetor), Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmujor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes (vjetor). Përveç raporteve periodike, kjo gamë pasurohet më tej me Buletinin Zyrtar, Revistën “Bankingu Qendror” (gjashtëmujore), Revistën Ekonomike (gjashtëmujore), Revistën “Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë” (gjashtëmujore), si dhe materialet e ndryshme studimore dhe edukative.

Në funksion të informimit të publikut, Banka i përgjigjet edhe kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve në formë të shkruar ose në formë elektronike, në varësi të përzgjedhjes që kanë bërë ata vetë. Gjatë vitit 2024, i janë kthyer përgjigje 74 kërkesave zyrtare drejtuar koordinatorit për të drejtën e informimit. Gjithashtu janë trajtuar rreth 2400 korrespondenca mes departamenteve brenda Bankës së Shqipërisë dhe publikut të gjerë mbi marrje informacioni, ankimime dhe pyetje në lidhje me sistemin bankar, të mbërritura pranë adresës zyrtare të kontaktit të Bankës, në email-in public@bankofalbania.org.



2.13. EDUKIMI FINANCIAR

Edukimi financiar i publikut është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Ai realizohet përmes aktiviteteve dhe programeve edukative, vizitave në Muze, ekspozitave, si dhe botimeve të veçanta. Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, ka dy objektiva kryesorë: prezantimin e rolit dhe funksioneve të bankës qendrore tek publiku dhe kultivimin e përforcimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare.

STRATEGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR EDUKIMIN DHE PËRFSHIRJEN FINANCIARE

Në fillim të vitit 2024, u miratua Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, si një dokument i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë.

Në këtë vit të parë të zbatimit të strategjisë u synua jo vetëm shtimi i aktiviteteve edukuese dhe pasurimi i tyre, por edhe përfshirja e një numri sa më të lartë individësh - me një fokus të veçantë te grupet vulnerabël – si dhe përshtatja e materialeve dhe programeve edukuese me nevojat reale të këtyre grupeve, të identifikuar përmes punës kërkimore. Kështu, fokusi u zgjerua për të përfshirë përveç fëmijëve, edhe të rriturit, të ndarë sipas specifikave të tyre, duke iu qasur në momentet e përshtatshme sipas fazave të ciklit të jetës. Pjesë e aktiviteteve tona edukative janë bërë rreth 10.000 pjesëmarrës të të gjitha moshave.

STRATEGJIA KOMBËTARE E EDUKIMIT DHE PËRFSHIRJES FINANCIARE

Gjatë vitit 2024, vijoi puna për hartimin e një Strategjie Kombëtare të Edukimit dhe Përfshirjes Financiare (SKEPF) me punën e strukturave ndërinstitucionale, përkatësisht Komiteti Drejtues dhe Komiteti Teknik. Detyra e tyre është të përcaktojnë dhe koordinojnë objektivat, instrumentet, planveprimin dhe programet e edukimit financiar në vend, në zbatim të SKEPF-së.

BOTIMET EDUKATIVE

Gjatë vitit 2024, u hartua një fletëpalosje e re edukative “Çfarë ofrojnë bankat?”, ku shpjegohen me gjuhë të thjeshtë produktet dhe shërbimet kryesore bankare që ofron tregu shqiptar.

Po ashtu, ka vijuar shpërndarja e teksteve mësimore “Financat personale në duart tuaja” për shkollat e mesme, që kanë zgjedhur ta zhvillojnë lëndën, si dhe shpërndarja e broshurave dhe materialeve edukative të përgatitura në vitet paraardhëse kryesisht për vizitorët e Muzeut.



ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE EDUKATIVE

- Java Globale e Parasë 2024, nën sloganin “Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde!”, 18-24 mars. Ky aktivitet iu dedikua ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e sigurisë kibernetike dhe shpërndau mesazhe dhe këshilla praktike e të qarta për fëmijët dhe të rriturit, mbi njohjen dhe shmangien e rreziqeve me të cilat mund të përballen gjatë lundrimit në internet, rëndësinë e mbajtjes së informacionit personal të sigurt, shmangien e mesazheve dhe faqeve të dyshimta, si dhe mbrojtjen e informacioneve financiare nga mashtrimet dhe rreziqet e tjera online. Në kuadër të këtij eventi u organizuan aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuere që angazhuan në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth 4750 nxënës dhe studentë, nga më shumë se 165 shkolla të të gjitha niveleve, nga i gjithë vendi.
- Ekspozita edukative “MONEY smART – Edukim financiar për të gjithë”, qershor-nëntor 2024. Kjo ekspozitë ishte fryt i punës së përbashkët të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, me mbështetjen financiare të SECO, si pjesë e Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare. Ajo u çel për herë të parë në Tiranë më 13 qershor 2024 dhe synoi të njihte publikun e gjerë me një informacion të larmishëm mbi çështje financiare të prekshme për konsumatorin bankar, të prezantuara thjesht dhe në mënyrë tërheqëse. Në muajt në vijim, ekspozita udhëtoi edhe drejt Korçës (17-18 tetor 2024), Shkodrës (31 tetor – 1 nëntor 2024) dhe Durrësit (7-8 nëntor 2024).
- Workshop-i “Rrugëtimi i Shqipërisë drejt integritimit në SEPA, përfshirjes dhe edukimit financiar”, 14 qershor 2024. Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore zhvilluan këtë workshop, me qëllim diskutimin mbi statusin e integritimit të Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA) dhe përfitimet për vendin, si dhe mbi rëndësinë e përfshirjes dhe edukimit financiar për zhvillimin e tregut dhe mirëqenien shoqërore.
- Shkolla Rinore për Edukimin Financiar, 5-6 tetor 2024, e organizuar në ambientet e Bankës së Shqipërisë, me pjesëmarrjen e rreth 60 të rinjve gjimnazistë nga qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Aktiviteti u organizua në kuadër të nismës së Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e edukimit financiar në arsimin parauniversitar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Bankën e Shqipërisë dhe aktorë të tjerë. Programi edukues synoi t’i ndihmojë të rinjtë të përvetësojnë aftësi të qëndrueshme financiare. Bazuar në impaktin dhe suksesin e tij, ky program pilot i edukimit financiar për të rinjtë, në të ardhmen, mund të shtrihet në shkallë kombëtare dhe të përfshihet në kurrikulat e shkollave parauniversitare.

MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË

Edhe këtë vit, Muzeu i Bankës së Shqipërisë ka vijuar me misionin e tij si një ambient, i cili prezanton historinë e monedhës kombëtare dhe të bankës qendrore, si dhe promovon edukimin financiar të publikut. Përgjatë vitit 2024, Muzeu ka pritur rreth 5200 vizitorë, ose rreth 13% vizitorë më shumë se në vitin paraardhës (4600 vizitorë). Vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë është



kthyer tashmë në pjesë të kurrikulës mësimore apo orëve të lira për nxënësit e shkollave 9-vjeçare e të mesme, dhe për studentë të universiteteve.

Gjatë vitit, Muzeu i Bankës së Shqipërisë ka organizuar një sërë aktivitete, ku përfshihen:

- Ekspozita “Berati në shek. XVIII-XX: Zhvillimi ekonomik dhe tregtar; koleksione të veçanta të kartëmonedhave lokale dhe monedhave që pasqyrojnë trashëgiminë monumentale dhe kulturore të Beratit” e organizuar, në 18-19 prill 2024, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Muzeve Berat;
- Dita Ndërkombëtare e Muzeve me temë “Muzetë për edukim dhe kërkim” (18 maj 2024), gjatë të cilës Muzeu i Bankës së Shqipërisë qëndroi i hapur për publikun në orare të zgjatura dhe pa kufizim në numër vizitorësh. Me këtë rast, u përgatitën: ekspozita me dokumente historike; filma të animuar; punime artistike nga nxënës e studentë;
- Cikli i leksioneve “Netët e Muzeut”, të mbajtura nga personalitete të shquara në fusha të ndryshme, që trajtojnë historinë e parasë dhe bankës, ekonominë, financën dhe edukimin financiar, numizmatikën, si dhe disiplina si filatelia, arti dhe arkitektura. Kështu, gjatë muajit tetor, u mbajtën 2 leksione: “Inflacioni dhe ndikimi në koston e jetesës,” nga eksperti i ekonomisë, Prof. Assoc. Dr. Selami Xhepa; dhe “Psikologjia e parasë dhe rritja personale”, nga Prof. Assoc. Dr. Niko Pano;
- Ekspozita e përbashkët me Qendrën Muzeore Durrës, organizuar më 7-8 nëntor 2024, në ambientin e Torres Veneciane të Durrësit, ku u paraqitën foto dhe informacione mbi traditën monetare të Dyrrahut antik dhe mesjetar, si dhe thesaret e zbuluara në këtë qytet.

